RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI
"AUDITIMIN FINANCIAR"

Tiranë, shtator 2026

PËRMBAJTJA 2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
I.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 4
I.2 Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve. 5
I.3 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit. 10
II. HYRJA 11
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA 11
II.1 Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit. 11
II.2 Identifikimi i Çështjes. 11
II.3 Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese. 11
II.4 Përgjegjësitë e Audituesve. 12
II.5 Kriteret e Vlerësimit 13
II.6 Standardet e Auditimit. 13
II.7 Metoda e Auditimit. 13
II.8 Dokumentimi i Auditimit. 15
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT 15
III.1 Informacion i përgjithshëm 15
III.2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit 16
III.2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik” 16
III.2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. 30
III.2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025. 54
III.2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm 67
IV. REKOMANDIME 81
A. MASA ORGANIZATIVE 81
B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA. 95
C. MASA DISIPLINORE 96

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AAGJM	Aktive Afatgjata Materiale
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
AAGJM	Aktive Afatgjata Materiale
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN

a. Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimi.

Bashkia Belsh është njësi e vetëqeverisjes vendore e krijuar dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar. Pas reformës administrativo-territoriale, Ajo bën pjesë në Qarkun Elbasan dhe përbëhet nga njësitë administrative Belsh, Fierzë, Grekan, Kajan dhe Rrasë, me qendër në qytetin e Belshit. Bashkia kufizohet në veri me Bashkinë Cërrik, në lindje me Bashkinë Kuçovë, në jug me Bashkinë Dimal dhe në perëndim me Bashkinë Peqin. Ajo ushtron funksionet dhe kompetencat e saj në fushën e infrastrukturës publike, shërbimeve komunitare, zhvillimit ekonomik vendor, arsimit parashkollor, kulturës, mbrojtjes sociale, administrimit të aseteve publike dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët.
Veprimtaria financiare e Bashkisë Belsh financohet nga të ardhurat e veta vendore, transfertat nga buxheti i shtetit, grantet dhe burime të tjera financimi të lejuara nga legjislacioni në fuqi. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, bashkia ka përgjegjësi për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, administrimin e fondeve publike, menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve, si dhe hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me standardet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Auditimi financiar është kryer me qëllim vlerësimin e rregullshmërisë, ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare të Bashkisë Belsh, si dhe verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare me kuadrin ligjor e rregullator. Në kuadër të auditimit janë shqyrtuar sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, proceset e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, administrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, menaxhimi i aktiveve dhe detyrimeve, si dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e fondeve publike sipas parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit.
Buxheti i Bashkisë Belsh për vitin 2025 së bashku me njësitë shpenzuese të saj është planifikuar në shumën 748,545 mijë lekë. Nga këto, shpenzime faktike për vitin 2025 janë realizuar 654,444 mijë lekë ose në masën 87%. Të ardhurat e veta janë planifikuar në masën 101,000 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 80,814 mijë lekë ose në masën 80 %. Sa i përket investimeve ato janë planifikuar në shumën 117,008 mijë lekë dhe realizuar në masën 59 % ose 69,167 mijë lekë.
Misioni i Bashkisë Belsh është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.
Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.
Buxheti i Bashkisë Belsh si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 *"Për financat e qeverisjes vendore"* nenit 50 *"Auditi i jashtëm"* pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *"1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë"*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Belsh si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar në Bashkinë Belsh për periudhën e aktivitetit nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së Bashkisë.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazohet në risk dhe materialitet nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarive, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si; Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve; Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët.

I.2 Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 12 gjetje dhe ka dhënë 24 rekomandime, nga të cilat 18 masa organizative dhe 2 masa 3-E të ardhura të munguara si dhe 4 masa disiplinore.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Belsh nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha drejtoritë; Bashkia Belsh nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni dhe për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës; Për vitin 2025 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Belsh si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me ndikim të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre si dhe nuk ka hartuar plan-veprime për menaxhimin e riskut;

Mungojnë trajnimet e stafit të Bashkisë Belsh si dhe programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës. Titullari i Bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë; Nuk është plotësuar struktura për 6 vende pune; Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë; Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës çka sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive; Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

- Nga auditimi u konstatua se nuk është përgatitur dhe miratuar kalendari i PBA 2025-2027, duke mos respektuar afatin e përcaktuar për përgatitjen e tij. Nga auditimi u konstatua se hartimi i fazës së parë të PBA 2025-2027 është kryer dhe dërguar në Këshill për miratim jashtë afatit 15 mars 2024.

Nga auditimi u konstatua se projekti i parë i PBA 2025-2027 nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025 - 2026 dhe buxhetit vjetor, rezulton se mungojnë, kërkesat shkresore nga drejtorët e drejtorive të Bashkisë Belsh në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse dhe kërkesat e sektorëve të ndryshëm që mbulojnë këto programe, dokumentacioni që evidenton punën e kryer nga Grupi Menaxhimit Strategjik dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, si dhe dëgjesa t publike nuk janë dokumentuar me procesverbalet apo relacionet e zhvillimit të takimeve për këtë qëllim U konstatua se buxheti i vitit 2025 është miratuar datë 27.12.2024 jashtë afateve te përcaktuara; Nga auditimi i planifikimit te investimeve u konstatua se gjatë hartimit të fazave të parë të dytë dhe të tretë të PBA 2025-2027 është kryer planifikim i pa saktë i investimeve pasi planifikimi ne PBA faza e parë është për shumën 94,591 mijë lekë janë parashikuar 5 projekte investimesh. Në fazën përfundimtare të PBA planifikimi i investimeve ka përfshirë 7 objekte investimesh me vlerë 78,072 mijë lekë nga te cilat tre objekte investimesh me vlerë 36,000 mijë që kanë qenë planifikuar në PBA e fazës së parë dhe fazës së dytë nuk janë në planin përfundimtar vjetor të buxhetit të ndryshuar si dhe nuk janë realizuar gjatë vitit 2025. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk u paraqiten dokumentacion për dëgjesa publike në lidhje me vendimmarrjen për ndryshimin e prioriteteve në planifikimin e investimeve dhe ndryshimin e investimeve gjatë procesit të hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor. Veprime në mos përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pika 18. Në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar Kreu 3. pika 54,55,56,57,77,88,130. Në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3 , datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"* pika 6,pika11, pika 46, pikat 67,71,72,83,85.

- Nga auditimi i dhënave të thesarit sipas printimit të llogarive ekonomike nga thesari për Bashkinë Belsh pa njësi vartësie u konstatua se ne total realizimi Acrual dhe Cash nuk përputhen me njëra tjetrën pasi realizimi sipas Acrual për vitin 2025 është 527,699,880 lekë dhe realizimi Cash 527,089,980 lekë me një ndryshim vjetor prej 609,900 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të situacionit buxhetor të thesarit dhe ditarit të shpenzimeve u konstatua se ndryshimet midis të dhënave Acrual dhe Cash vijnë si pasojë e raportimeve të urdhër shpenzimeve të muajit dhjetor 2025 të cilat janë raportuar nga Bashkia Belsh të kryera për vitin 2025 ndërsa pagesa reale sipas thesarit është kryer në vitin në vazhdim 2026. U konstatua se urdhër shpenzimet e fundit të vitit 2024 janë paraqitur nga Bashkia Belsh në Acrual 2024 dhe Cash sipas thesarit në janar 2025; U konstatua se llogaria 230-231 sipas Acrual është 69,167,670 lekë ndërsa sipas Cash është

91,714,000 lekë ose 22,546,330 lekë më shumë Cash se Acrual për vitin 2025; Llogaria 602 *"Mallra dhe shërbime"* sipas Acrual është 63,351,720 lekë dhe sipas Cash 64,807,930 lekë me një ndryshim vjetor për vlerën 1,456,210 lekë më shumë Cash se Acrual për vitin 2025; Llogaria 604 *"Transferime"* sipas Acrual është 15,574,410 lekë dhe sipas Cash 15,250,520 lekë me një ndryshim vjetor për vlerën 323,890 lekë me shumë Acrual se Cash për vitin 2025. Vlera 323,890 lekë është pasqyruar Cash në janar 2026. Llogaria 606 *"Transferta për buxhete familjare dhe individë"* sipas Acrual është 264,879,020 lekë dhe sipas Cash 240,590,470 me një ndryshim vjetor për vlerën 24,288,550 lekë me shumë Acrual se Cash për vitin 2025 vlera 24,288,550 lekë është pasqyruar Cash në janar 2026. Nga auditimi u konstatua se nuk është respektuar disiplina buxhetore në lidhje me pasqyrimin buxhetor të Urdhër shpenzimeve në kohë për ekzekutim nga ana e thesarit. Veprime në mospërputhje me ligjin me Ligjin nr. 9936, datë 26. 6. 2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 52 *"Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar pika 26. Neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues Neni 12 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues Udhëzim Nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik (I azhurnuar me Udhëzimin nr. 20 data 17.11.2014, Udhëzimin nr. 1 datë 06.05.2016 dhe Udhëzimin nr. 24 datë 07.12.2016) pika 34 germa a) "germa. b) Neni 36. pika 18.*

- Nga auditimi u konstatua se planifikimi i të ardhurave nuk është kryer në mënyrë te detajuar për taksat dhe tarifat vendore sipas llojit të tyre si dhe realizimi i të ardhurave është në masën 80% të planifikimit duke ndikuar negativisht në procesin e realizimit të treguesve buxhetor të shpenzimeve të planifikuara të buxhetit 2025. Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Belsh në fillim të vitit buxhetor planifikon angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1. 3, germa *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse

-Nga auditimi i llogarisë nr. 520 *"Disponibilitete në Thesar"*, u konstatua mosrakordim në shumën 18,597,635 lekë mes tepricës në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 116,172,398 lekë dhe akt rakordimit me degën e thesarit të pasqyruar në shumën 97,574,763 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 37, 50

-Nga auditimi i llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* mbyllur me tepricë në shumën 49,755,029 lekë përfaqëson vetëm detyrimet e lëna nga auditimet e KLSH dhe nga APP. Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Tatim Taksave deri në datën 31.12.2025 u konstatuan detyrime në shumën 120,190,921. 94 lekë të pakontabilizuara në pasqyrat financiare të Bashkisë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar

- Nga auditimi i llogarisë 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"* përfaqëson detyrime të Bashkisë për investime në shumën 40,130,013 lekë. Këto detyrime datojnë që nga viti 2012 detyrime në shumën 5,625,187 lekë, detyrime të vitit 2019 në shumën 1,088,930 lekë, detyrime të vitit 2020 në shumën 8,546,160 lekë, detyrime të vitit 2023 në shumën 100,000 lekë si dhe detyrime të vitit 2025 në shumën 24,769,736 lekë. U konstatua se transaksionet e kontabilizuara në këtë llogari në shumën 40,130,013 lekë janë keq klasifikuar. Keq klasifikimi i transaksioneve për investime në shumën 40,130,013 lekë sipas periudhave kontabël nuk i janë shtuar llogarisë së aktiveve afatgjata duke i përjashtuar nga amortizimi dhe duke mos paraqitur vlerën e saktë të aktiveve afatgjata gjatë periudhave kontabël. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se totali i fondit të konsoliduar nuk është përcaktuar saktë pasqyruar më pak në shumën 2,710,435 lekë. Diferencë e konstatuar çelja e fondit të konsoliduar në datën 31.12.2024 shtuar me totalin e shtesave të aktiveve, pakësuar me kreditimet e klasës 2. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar.
- Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se të ardhurat vjetore nuk janë kontabilizuar saktë, Të ardhurat e realizuara dhe të rakorduara me degën e thesarit sipas pasqyrës së transfertave buxhetore së bashku me të ardhurat e veta janë në shumën 695,533,438 ndërsa sipas pasqyrës së performancës duke përjashtuar financimin e pritshëm nga buxheti janë në shumën 649,090,865 lekë shtuar këto me akordimet nga fondet buxhetore për investime në shumën 40,877,411 lekë, u konstatua diferencë në shumën 5,565,162 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 21.02.2021 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar.
- Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se nuk janë konstatuar saktë shpenzimet për mallra dhe shërbime, tepricë e cila ndikon rezultatin e periudhës kontabël, konkretisht nuk janë konstatuar shpenzime në shumën 17,576,589 lekë përllogaritur nga shpenzimet faktike nga totali i urdhër shpenzimeve për këtë kategori pakësuar me tepricën në çelje të periudhës kontabël të detyrimeve afatshkurtra, shtuar me tepricën në mbyllje të detyrimeve afatshkurtra. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Aneksi 1, "Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8).
- Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se në *"Shpenzime të tjera"* në operacionet e korrigjimit të rezultatit në teprica e llogarisë 831 *"Caktim të ardhura të funksionit për investime"* është kontabilizuar shuma 1,660,192 lekë. Në llogarinë 831 *"Caktim të ardhura të funksionit për investime"* për efekt të korrigjimit të rezultatit kontabilizohen vetëm pjesa e investimeve e financuar nga të ardhurat e veta që në rastin e subjektit është në shumën 8,253,774 lekë e rakorduar me degën e thesarit. U konstatua se diferenca në shumën 6,593,582 lekë që nuk është pasqyruar ndikon rezultatin e periudhës kontabël veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Aneksi 1, "Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8).
- Nga auditimi i pasqyrës së flukseve monetare u konstatuan mosrakordime si më poshtë: Nga auditimi i pjesës së parë *"Veprimtaritë e shfrytëzimit"* fondet buxhetore për shpenzime korrente pasqyrohen në shumën 584,429,250 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve totali i fondeve për shpenzime të shfrytëzimit pasqyrohen në shumën 553,805,198 lekë, u konstatua një mosrakordim në shumën 30,624,053 lekë. Arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor pasqyrohen në shumën 71,115,627 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve pasqyrohen në shumën 80,814,343 lekë, u konstatua mosrakordim në shumën 9,029,060 lekë.

Nga auditimi i Veprimtarive të investimeve u konstatua se *"Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)"* pasqyrohen në shumën 40,877,411 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve totali i fondeve të akorduara për shpenzime kapitale është 60,913,897 lekë, u konstatua mosrakordim në shumën 20,036,486 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1. Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të fluksit monetar të subjektit.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Kryetari i Bashkisë, grupi i menaxhimit strategjik si dhe Drejtoria Burimeve Njerëzore të marrë masa për: - Plotësimin me staf të strukturës organizative të Bashkisë Belsh. - Të rishikohet rregullorja e brendshme e Bashkisë Belsh, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës në përshtatje me ristrukturimin, riorganizimin apo ndryshime strukturore apo menaxheriale që ka pësuar institucioni. - Drejtoria e Burimeve njerëzore të përgatisë një plan vjetor për trajnimin e stafit të Bashkisë. - Bashkia Belsh dhe strukturat përgjegjëse të hartojnë strategjinë dhe regjistrin e risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Belsh si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me ndikim të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre si dhe nuk ka hartuar plan-veprime për menaxhimin e riskut. - Të hartojnë dhe miratojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës çka sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. - Bashkia Belsh të hartojë gjurmët e auditimit të miratuara për proceset kryesore të punës.
- Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa për miratimin në kohë të kalendarit të PBA –së 2028-2030 në vazhdim si dhe të marrë masa për miratimin në kohë të vlerësimit dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave si dhe të marrë masa për dërgimin në kohë në Këshill të programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor. Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa për publikimin në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh të programit buxhetor afatmesëm 2028-3030 dhe buxhetit vjetor.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa të dërgoje në kohë urdhër shpenzimet së bashku me dokumentacionin justifikues në thesar si dhe të marrë masa që shpenzimet buxhetore sipas të dhënave të situacionit buxhetor të thesarit të kenë përputhje midis të dhënave Acrual dhe Cash.
-Drejtoria e Financës së Bashkisë Belsh të marrë masa të hartojë paketën fiskale të pagesave të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me llojet e taksave dhe tarifave vendore për të cilat realizon të ardhura që paguhen nëpërmjet kodeve përkatëse të të ardhurave që paguhen në degën e thesarit, si dhe të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.
- Drejtoria e Financës menjëherë të bëjë rakordimin me degën e thesarit lidhur me likuiditetin dhe të marrë masa të menjëhershme që të saktësohen veprimet kontabël prej të cilave ka rrjedhur ky mosrakordim. Sistemi i veprimeve kontabël të bëhet në fillim të periudhës kontabël.
-Drejtoria e Financës të marrë masa menjëherë të kontabilizojë vlerën 133,906,877 lekë të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* me qëllim pasqyrimin e saktë të të drejtave në pasqyrën e pozicionit financiar
- Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e saktë të transaksioneve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave dhe teknikave kontabël me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar dhe pasqyrës së rezultatit.
- Drejtoria e Financës të marrë masat për evidentimin e diferencës së konstatuar dhe kontabilizimin e saj në shtesë të fondit të konsoliduar. Në vijim të bëhet kontabilizimi i saktë i transaksioneve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave dhe teknikave kontabël me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar dhe pasqyrës së rezultatit.
- Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e saktë të transaksioneve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave dhe teknikave kontabël me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të të ardhurave në pasqyrën e performancës për përcaktimin e saktë të rezultatit të periudhës.
- Drejtoria e Financës të marrë masat për konstatimin dhe kontabilizimin e saktë të të gjitha transaksioneve të cilat kanë të bëjnë me të shpenzimet, duke i rakorduar ato përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.
- Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve të cilat kanë ndikim apo rregullojnë rezultatin e periudhës përpara mbylljes së transaksioneve vjetore me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar
- Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve që lidhen më mjetet monetare në mënyrë të saktë, duke i rakorduar ato me pasqyrat e tjera pjesë të setit të pasqyrave financiare vjetore, si dhe me raportet nga dega e thesarit përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së fluksit monetar, pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.

I.3 KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

Opinioni për auditimin e pasqyrave financiare[1]:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Belsh për vitin ushtrimor 2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Belsh nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "*Baza për Opinionin e Kualifikuar*", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar[2]***, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë **opinion të kualifikuar**, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 13,099 mijë lekë.

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Belsh, sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

Nga auditimi i llogarisë nr. 520 *"Disponibilitete në Thesar",* u konstatua mos rakordim në shumën 18,597,635 lekë mes tepricës në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 116,172,398 lekë dhe akt rakordimit me degën e thesarit të pasqyruar në shumën 97,574,763 lekë.

Nga auditimi i llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* u konstatuan detyrime në shumën 120,190,921 lekë të pa kontabilizuara në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se të ardhurat vjetore nuk janë kontabilizuar saktë, kontabilizuar më tepër në shumën 14,554,991 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se nuk janë konstatuar saktë shpenzimet për mallra dhe shërbime në shumën 17,576,589 lekë. Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se në *"Shpenzime të tjera"* në operacionet e korrigjimit të rezultatit fondet e veta në shumën 6,593,582 lekë nuk janë marrë në konsideratë në përllogaritjen e rezultatit të periudhës kontabël.

[1] - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

[2]- Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 paragrafi 4.2 faqe 54. "Opinion i Modifikuar, jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ...".

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 377/1 prot., datë 09.04.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.04.2026 deri në datën 29.05.2026, në subjektin Bashkia Belsh u krye *"Auditimi Financiar"* për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. C., Përgjegjës Grupi;
2. L. Gj.;
3. A. V.;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

II.1 Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të Bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Projekt Raporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Belsh.

II.2 Identifikimi i Çështjes.

Auditimi synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Belsh, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Belsh.

II.3 Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Belsh, Kryetari i Bashkisë në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në

sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të plotë dhe të saktë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Belsh, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1. 3.

Nëpunësi Autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e Bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve. [3]

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

II.4 Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për pasqyrat financiare të Bashkisë Belsh lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: etika dhe pavarësia, kontrolli i cilësisë menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, alokimi i fondeve dhe transaksionet financiare. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Belsh është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese, e cila përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keq raportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në

[3] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 15

ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *"Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*, paragrafi 44-51.

II.5 Kriteret e Vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Belsh është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Belsh. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*;
- Ligji nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*;
- Ligji nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, etj*. ";
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore ";*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"* i ndryshuar;
- Udhëzimet standarde vjetore të Ministrisë së Financave për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit, etj.
- Rregullore e Brendshme *"Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së"*, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e brendshme *"Mbi Procedurat e auditimit në KLSH"*, miratuar me vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë.

II.6 Standardet e Auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200,400 etj. ;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të II1-t, INTOSA1 "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar;
- Manuali i zbatimi te rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

II.7 Metoda e Auditimit.

Si metodë auditimi gjatë procesit të auditimit është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve

të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.
Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[4]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Përcakton nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales"*, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.
- *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e

[4] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat, shpenzimet për kontribute të sigurimeve, shpenzimet operative, transferimet korrente si dhe investimet. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[5].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mire informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

II.8 Dokumentimi i Auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 *"Dokumentimi i Auditimit"*, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.
Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua ky Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

III.1 Informacion i përgjithshëm

Auditimi në Bashkinë Belsh u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të menaxhimit financiar dhe raportimit financiar.
Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.
Bashkia Belsh përballet me një sërë sfidash që ndikojnë në realizimin e objektivave të saj dhe në ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve. Ndër sfidat kryesore evidentohet tkurrja e popullsisë dhe emigracioni, të cilat ndikojnë në uljen e bazës tatimore dhe të ardhurave vendore. Njëkohësisht,

[5] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

shtrirja e gjerë territoriale dhe karakteri kryesisht rural i Bashkisë rrisin kostot e mirëmbajtjes dhe ofrimit të shërbimeve publike.
Sfidë e rëndësishme mbetet sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve publike dhe përmirësimin e infrastrukturës vendore, veçanërisht në njësitë administrative më të largëta. Gjithashtu, bashkia përballet me nevojën për rritjen e efiçencës në mbledhjen e të ardhurave vendore, administrimin e aseteve publike dhe forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Në kuadër të zhvillimit ekonomik vendor, sfidë mbetet krijimi i kushteve për nxitjen e investimeve, zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor, mbështetjen e aktiviteteve bujqësore e blegtorale dhe krijimin e mundësive të reja të punësimit. Përballimi i këtyre sfidave kërkon planifikim të qëndrueshëm financiar, përdorim efektiv të fondeve publike dhe forcim të kapaciteteve administrative e institucionale.
Rëndësia e këtij auditimi është sepse auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

III.2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të drejtimeve kryesore të auditimit drejtimit 1. *"Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik"*, drejtimit nr. 2 *"Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit"*, drejtimi nr. 3 *"Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025"* si dhe drejtimit nr. 4 *"Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm"* të programit të auditimit janë shqyrtuar dokumentacionet sipas pikave më poshtë:

III.2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik"

Në zbatim të pikës 1. të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:
Në zbatim të pikës së programit të auditimit me nr. 377/1, datë 09.04.2026 referuar kuadrit ligjor të veprimtarisë së Bashkisë Belsh si më poshtë:
-Ligji nr. 10 296/2010 *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar;
-Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*;
-Ligji nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil" i ndryshuar*;
-Ligji nr. 7961 /1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar;
-Ligji nr. 68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"*;
-Ligji *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH"*;
-VKM nr. 243/2015 *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"* i ndryshuar me VKM nr. 746/2018;
-VKM nr. 833 datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*;
-Udhëzimi nr. 15, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*;
- Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016.
Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Belsh, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

III.2.1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem i rëndësishëm politikash i cili, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:
a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:
1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Belsh, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:

Komponenti I "Mjedisi i kontrollit"

Mjedisi i kontrollit i jep ka shumë rëndësi për njësinë, pasi influencon në vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.
Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike;

Parimi 2 - Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;
Parimi 3 - Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;
Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;
Parimi 5 - Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3. 1 përcaktohet se *"Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje"*. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion të grupit të auditimit është konstatuar se Bashkia Belsh nuk ka miratuar Kodin e Etikës për vitin 2025, veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*, Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.
- Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Belsh vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar në vitin 2016 *"Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Belsh dhe Njësive Administrative"*.

Është konstatuar se për periudhës 2016-2025 nuk janë bërë ndryshime në këtë dokument dhe si rrjedhojë nuk janë pasqyruar ndryshimet e shumta strukturore si në Aparatin e Bashkisë Belsh, pra rezulton të mos jetë rishikuar rregullorja e brendshme e Bashkisë Belsh që nga momenti i miratimit të kësaj rregullore, viti 2016.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se struktura e Bashkisë Belsh është miratuar me VKB nr. 58, datë 30.12.2024, *"Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative"* si dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhër nr. 121, datë 09.01.2025.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 61, datë 30.12.2024, *"Mbi miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit, shërbimit, kulturës dhe sportit, punonjësit mbështetës dhe punonjësve me kontratë pranë Bashkisë Belsh"*.

Këto VKB janë konfirmuar nga prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1413/1 prot., datë 06.01.2025.

Struktura Bashkisë Belsh paraqitet si më poshtë vijon

- 8 pozicione pune me statusin i zgjedhur dhe funksionarë kabineti;
- 42 pozicione pune me status të nëpunësit civil; nga të cilët 27 janë me status.
- 175 pozicione pune janë punonjës administrativë dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar.
- 10 pozicione pune me kontratë të përkohshme.
- 1 pozicione pune me kohë të pjesshme.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se;

- Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e Rregullores.
- Nuk është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Belsh në përputhje me Ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit"* e cila është miratuar nga titullari i Bashkisë me Urdhër nr. 27, datë 27.01.2025 *"Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në Institucionin e Bashkisë"*.

Gjatë vitit 2025 nuk janë dhënë masa disiplinore për punonjësit.
- Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, nuk funksionon sektori i çështjeve të anti korrupsionit, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar.
- Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.
- Procesi i vlerësimit për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil nuk është kryer sipas formularit tip një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit).
- Po ashtu nuk ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstron dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar, përcaktohet se *"Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave"*. Për sa më sipër rezulton se Bashkia Belsh nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.
-Për vitin 2025, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Evidentohet se ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si por nuk janë kryer Raportet e monitorimit katër mujore të buxhetit të vitit 2025 në MFE.

Titullari i Bashkisë mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm por një problematikë e konstatuar është mungesa e njësisë së Auditit të Brendshëm.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.
Me Vendimin nr. 07, datë 31.01.2024, *"Për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Programit të Punës për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, është ngritur* Grupi Menaxhimit Strategjik *dhe Programin e Punës për projekt buxhetin 2025-2027.*
Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e Grupi Menaxhimit Strategjik në sistemin e MFK, përcaktohet se *"*Grupi Menaxhimit Strategjik *duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike"*.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për vitin 2025, rezulton vetëm një mbledhje e kryer nga Grupi Menaxhimit Strategjik, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e* Grupi Menaxhimit Strategjik *në sistemin e MFK, përcaktohet se "*Grupi Menaxhimit Strategjik *duhet*

të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike"
Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar, përcaktohet se *"Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës".*
Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm..

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.
Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
- Bashkia Belsh ka rregullore të brendshme të miratuar dhe publikuar nga titullari për veprimtarinë e institucionit, përfshirë të gjitha autoritetet, përgjegjësitë menaxheriale dhe operacionale, linjat e raportimit sipas strukturës organizative si dhe bazën ligjore për të gjithë veprimtarinë e Bashkisë.
- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.
-Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2025 *"Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Belsh"* për vitin 2025, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga 300 (treqind) punonjës,
Kjo strukturë ka ndryshuar me vendimin nr. 01/3, datë 22.08.2024, e përbërë nga 303 punonjës.
- Përgjatë vitit 2025 janë rekrutuar 23 punonjës të rinj dhe janë larguar 11 punonjës. Referuar strukturës së miratuar rezultojnë 6 vende vakante, si: 1 specialistë në Sektorin e Burimeve Njerëzore, 1 specialist në Sektorin Juridik, 1 Specialist në Sektorin e Arkivës, 1 Specialist në Sektorin e Bujqësisë, 1 Specialist në Sektorin e Projekteve dhe BE dhe 1 Specialist në Sektorin e ndihmës Ekonomike dhe 1 përgjegjës në NJAB.

Tabela nr. 1: Struktura e Bashkisë Belsh për vitin 2025

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	236	Nëpunës Civilë	42
		Punonjës me Kod Pune	175
		Të zgjedhur	8
		Me kontratë të përkohshme	10
		Me kohë të pjesshme	1

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore Belsh, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda Bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.
- Bashkia Belsh nuk ka evidenca të analizës së riskut.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku Bashkia Belsh përdor fare pak procedurat për delegimin e detyrave, kryesisht atë të delegimit në mungesë.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave
Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.
- Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Nga Sektori i Burimeve Njerëzore është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe të Përshkrimeve të Punës më shkresën nr. 3286. prot, datë 15.10.2024 me Urdhër nr. 455/1, datë 15.10.2024 Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar periodikisht edhe pse bashkia ka ndryshuar strukturën e saj. Për vitin 2025 janë kryer vlerësimet periodike të punonjësve nga menaxherët në lidhje me arritjen e objektivave dhe ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*. Nga auditimi i dosjeve të personelit nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e dokumentacionit përbërës si: raporte mjekësore, certifikata familjare, kualifikimin, trajnimet, dokumentacioni i arsimimit, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, etj.
- Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2025 janë rekrutuar 23 punonjës të rinj dhe janë larguar 11 punonjës.
- Bashkia Belsh nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Gjithashtu është konstatuar mungesa e trajnimit të stafit për ngritje profesionale.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.
Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjikë në dokumentin e rregullores së brendshme.
- Gjithashtu, evidentohet se Bashkia Belsh, nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, është miratuar me VKB nr. 7 prot, datë 30.01.2024 *"Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2025-2027, Bashkia Belsh"*.
Grupi Menaxhimit Strategjik luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.
Për vitin 2025 është përcjellë në MFE *"Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Belsh dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm"* me shkresën nr. 438. prot, datë 13.02.2026.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 20.
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*, Kreu II. "Dosja e Personelit";
-*"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3. 1, Kapitulli IV *"Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit"*, Kapitulli V, Anekset

Komponenti II "Menaxhimi i Riskut"
Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6 - Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.
Parimi 7 - Identifikimi dhe analiza e risqeve.
Parimi 8 - Mundësia e riskut të mashtrimeve.
Parimi 9 - Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Parimi 6 - Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të Ky risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.
Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.
Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.
Nga analiza e të dhënave, duke marrë në konsideratë se Bashkia Belsh duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Bashkia Belsh nuk ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Parimi 7 - Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se bashkia nuk ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.
-Nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Belsh si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me ndikim të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.
-Titullari i Bashkisë ka ngritur Urdhër nr. 3/1, datë 16.01.2025 për *"Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Belsh"* për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet.
- Nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut. Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar, përcaktohet se *"Për t'i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit"*. Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Belsh nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.
Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar ku përcaktohet se *"Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë'.*
Bashkia Belsh nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Bashkia Belsh nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale..

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.
Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Belsh nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.
Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel jo të mirë sa i takon plotësimit të strukturës me auditues.
-Bashkia Belsh ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Kreu II, neni 8, pika a, b, c ,ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 3 *"Përgjegjësitë dhe detyrat e KR"*, pika 3. 2. 1 *"Titullari i njësisë publike"* pika 4 *"Hapat për ngritjen e sistemit të MR"*
-*"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3. 2, Kapitulli V, Anekset.

Komponenti III "Aktivitetet e Kontrollit"
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 10 - Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.
Parimi 11 - Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.
Parimi 12 - Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Belsh, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësive.
Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase..

Parimi 10 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.
Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
-Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.
Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.
-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
-Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve rezulton se ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.
- Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, bashkia ndjek procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj..
-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 *"Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP"* është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.
-Bashkia Belsh ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.
-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Nuk ka asnjë procedurë të miratuar nga titullari dhe gjurmë auditi për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike"* i ndryshuar.

Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.
Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar përcaktohet se *"Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi"*. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Belsh për vitin 2025 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.
Në Drejtorinë e Financës janë përcaktuar dhe ndarë detyrat për çdo specialist, dhe miratohen konform ligjit nga përgjegjësi i sektorit dhe n/zbatues në vijim nga nëpunësi autorizues.
Specialisti i buxhetit kryen gjithë procedurën për regjistrimin e çeljeve të fondeve dhe pakësimit të tyre në Microsoft Access. Specialisti i kontabilitetit kryen gjithë regjistrimet e aktiveve në sistemin Acces, shtesat pakësimet, amortizimet, etj. , janë të regjistruara në këtë sistem. Specialisti i pagave mban liste pagesat për çdo sektor kontabilizimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP, harton dhe nënshkruan gjithë urdhërpagesat që kryhen nga ky sektor. Në vijim çdo dokument kontrollohet dhe miratohet pastaj regjistrohet në sistem konform Udhëzimit të MF Nr. 24, datë 29.08.2019 *"Për Përdorimin e Arkivës Elektronike në Procesin e ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme'',* të ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.
Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
- Bashkia Belsh ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra sisteme qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).
- Nga auditimi rezulton se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Parimi 12 - Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe Parimi procedurave.
Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
- Bashkia Belsh nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka procedura të shkruara operative për vlerësimin, përzgjedhjen, konstatimin dhe monitorimin e investimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 5. 2. 7 *"Monitorimi dhe Raportimi"*;
-*"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3. 3, Kapitulli V, Anekset.

Komponenti IV "Informimi dhe komunikimi"
Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të të detyrave të ngarkuara.
Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 13 - Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.
Parimi 14 - Komunikimi i brendshëm
Parimi 15 - Komunikimi i jashtëm

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Belsh ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, u konstatua se në faqen web Bashkia Belsh ka programin e transparencës, në zbatim me *ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku në nenin 4 përcaktohet se 'Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës*, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Gjithashtu, Bashkia Belsh ka edhe regjistrin me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në zbatim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se *"Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër"*..

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit dhe ky sistem jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
- Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
- Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
- Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, në përputhje me udhëzimet dhe ligjin e kontabilitetit të pasqyrave financiare.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.
Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Për sa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e Bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.
- Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.

- Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh..

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Bashkia Belsh siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.
- Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
Për vitin 2025 janë zhvilluar disa dëgjesa publike në Bashkinë Belsh. Dëgjesa Publike janë zhvilluar në lidhje me konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, miratimin e Buxhetit të Bashkisë Belsh, Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Miratimi i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Belsh për vitin 2025 për vitin 2025 dhe Plani i Përmirësimit të Arsimit Parashkollor etj.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 23, *"Informacioni dhe Komunikimi"* pika 2;
-*"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3. 3, Kapitulli V, Anekset.

Komponenti V "Monitorimi"
Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta
Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herë pas hershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
- Nga auditimi i kryer, u konstatua se Bashkia Belsh nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
- Bashkia Belsh, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.
Për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Belsh ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit i cila i është dërguar Ministrisë së Financave (DHMFK) me shkresën nr. 438 prot, datë 13.02.2026. Për vitin 2025 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Belsh ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë, në zbatim me nenin 18, të ligjit për MFK-në.
Bashkia Belsh nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
Për vitin 2025 nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Belsh nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve veprime këto jo në përputhje me *Ligjin nr. 10296 datë 8. 07. 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* dhe *"Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë
Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
- Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por ecuria e zbatimit të tyre është e ngadaltë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, *"Monitorimi"* pika 1;
- *"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3. 5, Kapitulli V, Anekset.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Komponenti *"Mjedisi i kontrollit"*
- Nga auditimi u konstatua se nuk është rishikuar Rregullorja e Brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë drejtoritë, sektorët apo njësitë, nuk kanë përgjegjësi dhe detyra të mirë përcaktuara;
- Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës;
- Nuk është hartuar dhe as miratuar dokumenti i *"Kodit të Etikës"*
- Titullari i Bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.
- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor;

Komponenti *"Menaxhimi i Riskut"*
- Për vitin 2025 nuk është hartuar strategjia e riskut dhe nuk as regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Belsh si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me ndikim të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;
-Nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut.

Komponenti: *"Aktivitetet e Kontrollit"*
-Bashkia Belsh nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës;
-Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive;
- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Komponenti: *"Informimi dhe komunikimi"*
-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.
-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

Komponenti: *"Monitorimi"*

- Njësia e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Belsh, për periudhën objekt auditimi, nuk ka funksionuar, veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, etj. Nga auditimi nuk u konstatua asnjë procedurë për krijimin e kësaj njësie apo për rekrutimin e punonjësve për këtë strukturë.
-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Belsh nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha drejtoritë.
- Për vitin 2025 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Belsh si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me ndikim të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre si dhe nuk ka hartuar plan-veprime për menaxhimin e riskut.
- Mungojnë trajnimet e stafit të Bashkisë Belsh si dhe programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës. Titullari i Bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.
- Nuk është plotësuar struktura për 6 vende pune.
- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.
- Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës çka sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.
- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; -Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2. 2. 1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK"* a, b, c, d, pika 2. 3. 1; -VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*, Kreu III. *"Dosja e Personelit"; -"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III *"Komponentët e MFK"* pika 3. 1, Kapitulli IV *"Plani i veprimit të menaxhimit financiar"*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. A. N., Ish Drejtor në Drejtorinë e Financave, znj. Sh. K., përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore Bashkia Belsh.

III.2.1.2 Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:
- Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Belsh;

- Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve për vitin 2025;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
-Vlerësimi i auditimeve.

Auditimi u krye referuar akteve ligjore e nënligjore si më poshtë:
- Ligji Nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9154, datë 6. 11. 2003 *"Për Arkivat"*;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*;
- Manuali i *"Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"* miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016;
-VKM nr. 160, datë 02.03.2016 *"Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike"* i ndryshuar;

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se
- Njësia e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Belsh, për periudhën objekt auditimi, nuk ka funksionuar, veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, etj. Nga auditimi nuk u konstatua asnjë procedurë për krijimin e kësaj njësie apo për rekrutimin e punonjësve për këtë strukturë.

Për sa më sipër, në lidhje me Auditimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pas njohjes me Projekt Raportin e Auditimit, nga ana e subjektit të audituar Bashkia Belsh nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit.

III.2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Në zbatim të programit të auditimit u auditua planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2025, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit sipas çështjeve të mëposhtme:
- Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;
- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:
PBA 2025-2027;
Projekt-buxheti i miratuar për vitin 2025;
Vendimet e KB *"Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Belsh"* për vitin 2025;
Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
Situacioni i shpenzimeve për vitin 2025 i rakorduar me Degën e Thesarit;
Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Belsh;

Informacion shkresor-elektronik i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:
Ligji nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*;
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar;
Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore";*
Ligji nr. 9936, datë 26. 6. 2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"*, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 7. 12. 2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
Ligj Nr. 9869, datë 4. 2. 2008 *"Për huamarrjen e qeverisjes vendore"* (ndryshuar me Ligjin 68/2017, datë 27. 4. 2017)
Ligj Nr. 115/2024 "*Për buxhetin e vitit 2025*";
Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
Ligj Nr. 48/2014 *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"*
Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022.
Udhëzimi nr. 3. , datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"*
Udhëzim nr. 127 datë 19.12.2025 *"Për Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*
Udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar.
Udhëzimi nr. 23 datë 29.12.2023 *"Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore"*
Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"*.
Udhëzim plotësues nr. 2. , datë 24.01.2025 *"Për zbatimin e buxhetit për vitin 2025"*
Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 05.07.2024 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*.
Udhëzimi nr. 35 datë 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive Financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes vendore"*
Udhëzim nr. 10 datë 12.07.2024 *"Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve te huaja ne kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare"*

III.2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Në zbatim të Programit të Auditimit u auditua planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2025, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumenti i hartimit të PBA 2025 - 2027 dhe miratimi i tij dhe gjithë korrespondenca me Ministrinë e Financave.
2. Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2025 të miratuara me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, dhe transferta e kushtëzuar nga MFE dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore.
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Belsh shpenzimet dhe të ardhurat.
4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të pa likuiduara dhe vendime gjyqësore.
5. Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2024

6. Të tjera dokumente mbështetëse (databazë të ndryshme në programet *"excel"* si: për vendimet gjyqësore, për investimet, ditarët, shpenzimet të ardhurat etj.).

I. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025 - 2027 u konstatua se:

Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (Grupi Menaxhimit Strategjik) për PBA 2025 - 2027 me Urdhrin nr. 15, datë 22.01.2024 me nr. 273. prot., datë 22.01.2024. Sipas urdhrit nr. 15. , datë 22.01.2024 Kryetar i Grupi Menaxhimit Strategjik Altin T. Kryetari i Bashkisë , Koordinator i Grupi Menaxhimit Strategjik M. Ç. dhe Sekretar i Grupi Menaxhimit Strategjik A. N. Me Vendim te Këshillit bashkiak nr. 7 datë 30.01.2024 është miratuar Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe programet e punës për përgatitjen e Programit Buxhetor afatmesëm 2025-2027 protokolluar me nr. 450. Prot., datë 31.01.2024. Miratimi i Strukturave për vitin 2025 janë miratuar me Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 58 datë 27.12.2024 për miratimin e strukturës organizative dhe konfirmimi i Prefektit nr. 1413/1 datë 06.01.2025 ,ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

Nuk është përgatitur dhe miratuar kalendari i PBA 2025-2027, duke mos respektuar afatin e përcaktuar, në mos përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pika 18 i cili përcakton: *"Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore miraton kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor jo më vonë se data 31 dhjetor. "*

Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* Kreu *3.* Procedurat për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm

Hapi I. Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i buxhetit vjetor

54. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në fund të çdo viti buxhetor përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të buxhetit vjetor. 55. Kalendari miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 31 dhjetor dhe hyn në fuqi në ditën e parë të çdo viti buxhetor. 56. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore shpërndan kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të buxhetit vjetor te të gjitha njësitë shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore. 57. Kalendari i miratuar përmban datat kryesore, për: a) Vlerësimin e të ardhurave dhe përgatitjen për tavanet e shpenzimeve sipas programeve për tri vitet e ardhshme; b) Përgatitjen e kërkesave buxhetore (përgatitore dhe ato përfundimtare); c) Dërgimin për miratim të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor në Këshill.

Me shkresën nr. 2612/1. prot., datë 05.03.2024 Ministria e Financave ka dërguar Udhëzimin nr. 03 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027"*

Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet e shpenzimeve për PBA 2025 - 2027 me VKB nr. 17,datë 28.03.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresar nr. 406/1. prot., datë 02.04.2024

Janë miratuar për PBA 2025 - 2027 me VKB nr. 19, datë 28.03.2024 *"Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025 - 2027 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 408/1 prot., datë 02.04.2024.*

Nga auditimi u konstatua se hartimi i fazës së parë të PBA 2025-2027 është kryer dhe dërguar në Këshill për miratim jashtë afatit 15 mars 2024 në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"* pika 6 *"Bazuar në vlerësimet*

dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi brenda datës 15 mars 2024".

-Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Koordinatori i Grupi Menaxhimit Strategjik, brenda muajit Prill 2024. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet të cilat nuk janë parashikuar në PBA 2025-2027. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022 *pika 130. "Të gjitha parashikimet e detajuara të shpenzimeve të Programit sipas udhëzimeve, si edhe kërkesat e detajuara shtesë dërgohen te koordinatori i* Grupi Menaxhimit Strategjik-*së brenda muajit prill. Plani i detajuar brenda tavanit dhe kërkesat e detajuara shtesë pasi janë dakordësuar nga* Ekipi i Menaxhimit të Programeve-*ja firmosen nga drejtuesi i menaxhimit të Programit"*. Në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"*

Është përgatitur faza e parë e PBA 2025 - 2027 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1278/1 prot., datë 31.05.2024. Me shkresën nr. 8592. prot., datë 19.06.2024 ka dërguar pranë Bashkisë Belsh sugjerimet dhe rekomandimet për përmirësimet që duhen bërë në lidhje me hartimin e PBA 2025-2027. Ministria e Financave me shkresën nr. 9436/1 prot.., datë 08.07.2024 ka dërguar Udhëzimin plotësues nr. 08 datë 05.07.2024 *"Për përgatitjen e PBA 2025 - 2027"*.

Bashkia Belsh ka përgatitur fazën e parë të PBA 2025 – 2027 sipas metodologjisë së re të kodifikimit të programeve dhe bazuar në Udhëzimin e nr. 03 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*. Programimi i PBA 2025-2027 është kryer duke përfshirë transfertën e pa kushtëzuar te përgjithshme, transfertën e pa kushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore planifikimi i tyre.

PBA fillestarë 2025-2027 përmban 6 programe buxhetore

AA152 - Planifikimi, Manaxhimi dhe Administrimi ; AB152 - Rendi dhe Siguria Publike; AC152 - Manaxhimi për Zhvillimin Ekonomik dhe Mirëmbajtja e Rrugëve; AD152 - Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtja e Mjedisit; AE152 - Arsimi, Kultura dhe Sporti; AF152 - Fondi Rezerve dhe Kontigjence;

Nga auditimi u konstatua se projekti i parë i PBA 2025-2027 nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022 pika 77. *"Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm të miratuar brenda datës 5 korrik"*.

Ne fazën e pare të PBA Tavanet buxhetore janë parashikuar ne total 371,573 mijë lekë te detajuara si më poshtë vijon:

Tabela 2/1:PBA Faza e parë mijë/lekë

KODI	Emërtimi i llogarisë se shpenzimeve	PLANI 2025	Emërtimi i llogarisë se të ardhurave	PLANI 2025
	Shpenzime Personeli (600-601)	**185,380**	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	178,528,475
600	Paga, shpërblime dhe te tjera shpenzime personeli	154,422	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	89,679,947
601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	30,958	Të ardhurat e veta	101,000,000
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	**91,602**		
602	Mallra dhe shërbime te tjera	87,602		
603	Subvencionet	0		

604	Transferime korrente te brendshme	4,000		
605	Transferimet korrente jashtë	0		
606	Transferta për buxhetet familjarë dhe individët	0		
609	Rezervat	0		
651	Interesa për huamarrje te tjera te brendshme	0		
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjatë	0		
	Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)	**94,591**		
230	Shpenzime pre rritjen e aktiveve te qëndrueshme te patrupëzuara	0		
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te trupëzuara	94,591		
232	Shpenzime transferimet kapitale	0		
255	Te dala për hua-dhënie dhe nen-huadhënie te brendshme	0		
	Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232)	**0**		
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te patrupëzuara	0		
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te trupëzuara	0		
232	Shpenzime transferimet kapitale	0		
TOTALI		**371,573**		**371,573**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i të dhënave për programimin e investimeve ne Fazën e pare të PBA 2025-2025 u konstatua se për vlerën e investimeve te parashikuara ne shumen 94,591 mijë lekë janë parashikuar 5 projekte investimesh te përmbledhura si më poshtë vijon:

Tabela 2/2:Projektet e investimeve PBA faza e parë mijë /lekë

KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	Lloji I financimit	Plani 2025
1520201	Ndërtim I godinës institucionit Bashkia Belsh	Financim i Brendshëm	29,591
1520202	Rikonstruksion I disa rrugëve te brendshme te fshatrave te Bashkisë Belsh	Financim i Brendshëm	44,500
P328BL1	Orendi dhe pajisje për administratën dhe shkollat e Bashkisë Belsh	Financim i Brendshëm	2,000
P626BL4	Orendi dhe pajisje për administratën dhe shkollat e Bashkisë Belsh	Financim i Brendshëm	16,500
P912BL3	Orendi dhe pajisje për administratën dhe shkollat e Bashkisë Belsh	Financim i Brendshëm	2,000
Totali			94,591

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Tavanet përfundimtare të PBA 2024 - 2026 janë miratuar me VKB nr. 35, datë 30.08.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 959/1. prot., datë 10.09.2024 jashtë afatit te përcaktuar Udhëzimin e nr. 03 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*. PBA 2025-2027 pika 26 *"Kryetari i vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim brenda datës 15 Korrik 2024 tavanet përfundimtare në Këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik 2024"*.
Është përgatitur faza e dytë e PBA 2025 - 2027 dhe është dërguar në MF me shkresën nr. 3034 prot., datë 12.09.2024.

Bashkia Belsh ka përgatitur buxhetin sipas metodologjisë së re të kodifikimit të programeve dhe bazuar në Udhëzimin e nr. 03 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*. PBA 2025-2027 është përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar shoqëruar me shtojcat (pasqyrat anekse) dhe me relacion shpjegues, të cilët përmbajnë: rolin dhe qëllimin e PBA-së, vështrim të përgjithshëm të njësisë dhe orientimin afatgjatë të saj, të ardhurat dhe shpenzimet, planin e shpenzimeve 2025-2027, sipas programeve buxhetore, detyrimet e prapambetura, treguesit financiarë dhe rreziqet financiare e fiskale.

Tabela 2/3:PBA Faza përfundimtare mijë/lekë

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PLANI 2025	Emërtimi i llogarisë se të ardhurave	Plani 2025
	Shpenzime Personeli (600-601)	**249,355,791**	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	178,528,475
600	Paga, shpërblime dhe te tjera shpenzime personeli	212,375,471	Rritja e nivelit të pagave	37,643,109
601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	36,980,320	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	89,679,947
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651,)	**79,424,158**	Të ardhurat e veta	101,000,000
602	Mallra dhe shërbime te tjera	68,924,158		
603	Subvencionet	0		
604	Transferime korrente te brendshme	10,500,000		
605	Transferimet korrente jashtë	0		
606	Transferua për buxhetet familjarë dhe individët	0		

609	Rezervat	0		
651	Interesa për huamarrje te tjera te brendshme	0		
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjatë	0		
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	**78,071,584**		
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te patrupëzuara	0		
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te trupëzuara	78,071,584		
232	Shpenzime transferimet kapitale	0		
Totali		**406,851,531**		**406,851,531**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nga krahasimi i të dhënave ne lidhje me planifikimin ne PBA fillestare Faza I me PBA 2025-2027 përfundimtare rezulton një diference prej 35,278 mijë lekë e pasqyruar si më poshtë vijon:

Tabela 2/4: Ndryshimi midis PBA Faza përfundimtare PBA faza e parë lekë

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PBA 2025-2027 Përfundimtare	PBA 2025-2027 Fillestare	Ndryshimi
600	Paga, shpërblime dhe te tjera shpenzime personeli	212,375,471	154,422,000	57,953,471
601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	36,980,320	30,958,000	6,022,320
602	Mallra dhe shërbime te tjera	68,924,158	87,602,000	-18,677,842
604	Transferime korrente te brendshme	10,500,000	4,000,000	6,500,000
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te patrupëzuara	0		0
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te trupëzuara	78,071,584	94,591,000	-16,519,416
Totali		**406,851,531**	**371,573,000**	**35,278,531**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i të dhënave për programimin e investimeve ne Fazën e përfundimtare të PBA 2025-2025 dhe Buxheti 2025 u konstatua se për vlerën e investimeve te parashikuara ne shumen 78,071,584 lekë janë parashikuar 7 projekte investimesh te përmbledhura si më poshtë vijon:

Tabela 2/5:Planifikimi i investimeve PBA Përfundimtare /lekë

Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	Kodi	Llogaria	Statusi i Projektit	Burimi i Financimit	Kosto Totale	Plani 2025
P111BL1	Blerje automjet për shërbime te institucionit	AA152	231	I Ri	i Brendshëm	4,000,000	4,000,000
P111BL2	Rikonstruksion i godinës ekzistuese te Bashkisë Belsh	AA152	231	I Ri	i Brendshëm	6,000,000	6,000,000
P813BL2	Ndërtim i qendrës rinore Belsh	AE152	231	I Ri	i Brendshëm	20,000,000	20,000,000
P912BL4	Ndërtimi i kopshtit publik Belsh	AE152	231	I Ri	i Brendshëm	10,000,000	10,000,000
P111BL3	Blerje program (sofware) për sistemin e taksave vendore	AA152	231	I Ri	i Brendshëm	3,500,000	3,500,000
P111BL4	Furnizim vendosje mobile për zyrat e institucionit Bashkia Belsh	AA152	231	I Ri	i Brendshëm	5,000,000	5,000,000
P452BL3	Rikonstruksion i disa rrugëve te Brendshme te Bashkisë Belsh faza 3	AC152	231	I Ri	i Brendshëm	89,571,584	29,571,584
TOTALI						**138,071,584**	**78,071,584**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Për vitin 2025 ka pasur planifikim me financim te huaj për objektin *"Përmirësimi i shërbimeve të integruara të Bashkisë Belsh me turizmin e qëndrueshëm (Financim nga IADSA)"* me vlerë 9,185,633 lekë si më poshtë vijon:

Tabela 2/6:Planifikimi i investimeve te huaja/lekë

Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	Kodi	Llogaria	Statusi i Projektit	Burimi i Financimit	Kosto Totale	Plani 2025
P452BL1	Përmirësimi i shërbimeve te integruara te Bashkisë Belsh me turizmin e qëndrueshëm (Financim nga IADSA)	AC152	231	Vazhdim	i Huaj	45,928,164	9,185,633

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025

Buxheti për vitin 2025 është miratuar me VKB nr. 65, datë 27.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1420/1, datë 10.01.2025 dhe i është dërguar Degës së Thesarit Elbasan me shkresën nr. 228 prot., datë 13.01.2025.

Tabela 2/7;Buxheti 2025 /lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	178,528,475	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	89,679,947	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	101,000,000	
4	Fondi për rritjen e pagave	37,643,109	
1	Shpenzime për paga (600)		212,375,471
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		36,980,320
3	Shpenzime operative (602)		68,924,156
4	Subvencione (603)		0
5	Transferta (604+606)		10,500,000
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		78,071,584
	Total	**406,851,531**	**406,851,531**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

U konstatua se buxheti i vitit 2025 është miratuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022, pika 88. *"Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 25 dhjetor" si dhe me* Udhëzimi nr. 3 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" pika 46"Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 25 dhjetor"*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025 - 2026 dhe buxhetit vjetor rezulton se mungojnë, kërkesat shkresore nga drejtorët e drejtorive të Bashkisë Belsh në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse dhe kërkesat e sektorëve të ndryshëm që mbulojnë këto programe, dokumentacioni që evidenton punën e kryer nga Grupi Menaxhimit Strategjik dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, si dhe dëgjesa t publike nuk janë dokumentuar me procesverbalet apo relacionet e zhvillimit të takimeve për këtë qëllim në mospërputhje me Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pika 67, 71, 72, 83, 85.

Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022 *pika 130. "Të gjitha parashikimet e detajuara të shpenzimeve të Programit sipas udhëzimeve, si edhe kërkesat e detajuara shtesë dërgohen te koordinatori i Grupi Menaxhimit Strategjik-së brenda muajit prill. Plani i detajuar brenda tavanit dhe kërkesat e detajuara shtesë pasi janë dakordësuar nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve-ja firmosen nga drejtuesi i menaxhimit të Programit"*. Në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3. , datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"* pika 11 *"Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (*Ekipi i Menaxhimit të Programeve*), paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit te Koordinatori i Grupi Menaxhimit Strategjik, brenda muajit prill 2024. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore te cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet"*.

III.2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative

Buxheti për vitin 2025 është miratuar me VKB nr. 65, datë 27.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1420/1, datë 10.01.2025 dhe i është dërguar Degës së Thesarit Elbasan me shkresën nr. 228. prot., datë 13.01.2025.

Tabela 2/8;Buxheti 2025 /lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	178,528,475	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	89,679,947	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	101,000,000	
4	Fondi për rritjen e pagave	37,643,109	
1	Shpenzime për paga (600)		212,375,471
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		36,980,320
3	Shpenzime operative (602)		68,924,156
4	Subvencione (603)		0
5	Transferta (604+606)		6,500,000
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		4,000,000
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		78,071,584
	Total	**406,851,531**	**406,851,531**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

U konstatua se buxheti i vitit 2025 është miratuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022, pika 88. *"Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 25 dhjetor" si dhe me* Udhëzimi nr. 3 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" pika 46"Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 25 dhjetor".*

Me VKB nr. 09, datë 05.03.2025 është miratuar *"Mbi miratimin e shtesë së buxhetit të Bashkisë Belsh për vitin 2025"*, protokolluar me nr. 920. prot., datë 06.03.2025 është përcaktuar përdorimi e të ardhurave të trashëguara të vitit 2024 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2025 të detajuara si më poshtë:

Tabela 2/9:Shtesa e buxhetit 2025 VKB nr. 09, datë 05.03.2025/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2025	
	Të ardhurat	**Të ardhurat**	**Shpenzimet**
1	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar grandi	13,472,141	
2	Të ardhura të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale	2,893,014	
3	Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	6,623,980	
4	Të ardhura të trashëguara ë ardhurat nga taksat e tarifat vendore	9,837,248	
5	Sponsorizime		
	Shpenzimet		
1	Shpenzime për paga (600)		
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		
3	Shpenzime operative		
4	Transferta (604+606)		822,934
5	Shpenzimet kapitale (230+231)		32,003,449
	Total	**32,826,383**	**32,826,383**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Me VKB nr. 09, datë 05.03.2025 është miratuar *"Mbi miratimin e Shtesë se buxhetit te Bashkisë Belsh për vitin 2025"*, protokolluar me nr. 920 prot., datë 06.03.2025 është përcaktuar përdorimi e të ardhurave të trashëguara të vitit 2024 të Bashkisë janë planifikuar projektime dhe investime llogaria 230-231 në vlerën 32,003,447 lekë (1,113,133+30,870,314) si më poshtë vijon:

Tabela 2/10:Shtesa e investimeve sipas VKB nr. 09. 05.03.2025 /lekë

VKB nr. 09. 05.03.2025	Programi	Emërtimi i projektit	Vlera ne lekë
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Shpenzime për projektin IADSA	2,551,565
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Sistemim dhe asfaltim I disa rrugëve te brendshme te fshatrave te Bashkisë Belsh	10,883,741
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Për hartim projekti "Ndërtim I objekteve 1 familje tip ne zonat rurale ne territorin e Bashkisë Belsh"	1,133,135
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Sistemim dhe asfaltim I rrugës Belsh Stanaj	6,949,326
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Mbikëqyrje Punimesh "Sistemim dhe asfaltim I rrugëve te brendshme te fshatrave faza I"	300,953
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Mbikëqyrje për rehabilitimin dhe ngritjen e sigurisë se digës Belsh dhe pastrimin e kanalit te shkarkimit	1,059,961
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Ndërtimi I serave bujqësore me sipërfaqe 100 m2	1,860,222
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Turizëm I qëndrueshëm reduktim I mbetjeve ne Ballkanin perëndimorë bashke financim 20%	3,193,360
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Tabele për sinjalistiken rrugore	2,546,880
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Mbikëqyrje skema e ujitjes fushës cestie (degëzimi Kosovë)	78,000
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Mbikëqyrje punimesh Sistemim dhe asfaltim I rrugës Belsh Stanaj	696,150
VKB nr. 09. 05.03.2025	AC152	Mbikëqyrje Sistemim dhe asfaltim I disa rrugëve te brendshme te fshatrave te Bashkisë Belsh	750,154
TOTALI			32,003,447

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Me shkresën nr. 228. prot., datë 13.01.2025 është dërguar në thesar Buxheti për vitin 2025 me vlerë fillestare 406,851,531 lekë. Me Projekt Vendimin nr. 796. prot., datë 26.02.2025 *"Për miratimin e shtesës së buxhetit për vitin 2025"* të miratuar me VKB nr. 9 datë 05.03.2025 me nr. 920 prot., datë 06.03.2025 dhe Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 384/1 prot., datë 17.03.2025 është shtuar buxheti i vitit 2025 në vlerën 32,862,383 lekë. Me shtesën e buxhetit prej 32,862,383 lekë buxheti ka shkuar në vlerën 439,713,914 lekë (406,851,531+32,862,383). Me shkresën nr. 3921. prot., datë 10.11.2025 shtesë fondi për shpërblimin e punonjësve të MZSH (transfertën e pa kushtëzuar) shtohen shpenzimet për shpërblimet e punonjësve 1,320,000 lekë për sipas VKB nr. 49 datë 29.10.2025 konfirmuar nga Prefekti i qarkut me shkresën nr. 1191/1. prot., datë 05.11.2025

Shkresat për fondet për Bashkinë Belsh të ardhura janë si më poshtë vijon:
Shkresa nr. 17526/2 datë 23.12.2024 e Ministrisë se Financave mbi zbatimin e aktit normativ nr. 05 datë 19.12.2024 e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 4705. prot., datë 26.12.2024 *"Transfertën e pa kushtëzuar e përgjithshme"* me vlerë 12,609,885 lekë me destinacion shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
Shkresa nr. 17266. prot., datë 17.12.2024 e Ministrisë së Financave me lëndë *"Dërgohet transferta e pa kushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2025"*e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 4681 prot., datë 24.12.2024 me vlerë totale 305,851,533 lekë.

Shkresa nr. 13291/17 prot., datë 23.01.2025 e Ministrisë së Brendshme me lëndë *"Dërgohet detajimi i buxhetit për vitet 2025-2027, për shpenzimet korrente"* e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 424 prot., datë 27.01.2025 me vlerë totale 5,308,212 lekë.
Shkresë VKM nr. 127 datë 28.02.2025 *"Blerje automjet zjarrfikës"* me vlerë projekti 9,000,000 lekë dhe vlerë financimi për 2025 në vlerë 5,040,000 lekë.
Shkresë nr. 2331/26 datë 11.06.2025 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me lëndë *"Alokim fondesh për indeksimin e PAK në vendimin e gjykatës për vitet 2005-2010"* me vlerë 439,390 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 2095 prot., datë 13.06.2025.

Shkresë nr. 3822/2 datë 21.03.2025 e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me lëndë *"Alokim fondi subvencionimi i qirasë"* me vlerë 4,669,956 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 1177. prot., datë 01.04.2025.

Shkresa nr. 2885/1. prot., datë 08.04.2025 e Ministrisë së Brendshme me lëndë *" Njoftim për transferim fondi "*e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 1279. prot., datë 10.04.2025 me vlerë totale 106,000 lekë.

Shkresë nr. 5245/29 datë 30.12.2024 e Ministrisë se shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me lëndë *"Transferim fondesh për financimin e ofrimit te shërbimit te kujdesit social"* me vlerë 1,233,900 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 4782. prot., datë 31.12.2024.

Shkresë nr. 2174/1 datë 09.04.2024 e Ministrisë se Arsimit dhe Sportit me lëndë *"Njoftim për shpallje fitues të projekteve të aplikuara në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për objektet shkollore të arsimit para universitar dhe programit për sportin"* Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Kajan me vlerë projekti 27,190,441 lekë ku financimi i MAS për vitin 2025 është në vlerën 5,438,088 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 1319. prot., datë 14.04.2025.
Shkresë nr. 3664 prot., datë 02.05.2025 e KQZ me lëndë *"Dërgojmë alokim fondesh buxhetore, shpenzime korrente për kryerjen e transportit të bazës materiale KZAZ-QV-KZAZ në funksion të zgjedhjeve të 11 majit 2025"* në vlerën 79,800 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 1634. prot., datë 05.05.2025.

Shkresë nr. 4443 prot., datë 13.05.2025 e KQZ me lëndë *"Dërgojmë alokim fondesh buxhetore, shpenzime korrente për kryerjen e transportit të bazës materiale KZAZ-QV-KZAZ në funksion të zgjedhjeve të 11 majit 2025"* në vlerën 21,500 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 1770. prot., datë 15.05.2025.

Shkresë nr. 3181/1 datë 30.05.2025 e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë *"Transferim fondi për shpenzime kapitale"* Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Kajan ku financimi i MAS për vitin 2025 është në vlerën 4,622,375 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 1319 prot., datë 14.04.2025.

Shkresa nr. 3779/5 prot., datë 09.07.2025 e Ministrisë së Brendshme me lëndë *" Njoftim për detajim fondi në shpenzimet korrente në zbatim të aktit normativ nr. 6 datë 11.06.2025"* e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 2488 prot., datë 11.07.2025 me vlerë totale 910,000 lekë.
Shkresë nr. 5665. prot., datë 23.07.2025 e KQZ me lëndë *"Dërgojmë alokim fondesh buxhetore, shpenzime korrente për komisionarët ne funksion të zgjedhjeve të 11 majit 2025"* në vlerën 1,542,527 lekë protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 2677. prot., datë 25.07.2025.

Shkresa nr. 4884/8. prot., datë 14.10.2025 e Ministrisë së Punëve të Brendshme me lëndë *"Njoftim për transferim fondi"* e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 3595 prot., datë 11.10.2025 me vlerë totale 300,000 lekë.
Shkresa nr. 5546/9 prot., datë 17.11.2025 e Ministrisë së Punëve të Brendshme me lëndë *"Njoftim për ndryshimin e fondeve për shpenzime korrente në zbatim të aktit normativ nr. 10. , datë 08.10.2025"* e protokolluar në Bashkinë Belsh me nr. 4064 prot., datë 21.11.2025 me vlerë totale 1,450,000 lekë.
Nga auditimi u konstatua se totali i fondeve për vitin 2025 të ardhura për Bashkinë Belsh dhe çelura në thesar janë në vlerën 748,545,478 lekë:

Në mënyrë të përmbledhur planifikimi i fondeve dhe të ardhurave të veta është në vlerën 748,545,478 lekë dhe realizimi i tyre paraqitet në vlerën 654,444,815 lekë. Në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2/11:Fondet e ardhura për vitin 2025/lekë

Emërtimi i fondit	Planifikimi	Realizimi
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	12,730,262. 28	12,730,262. 00
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	13,472,141. 18	13,472,141. 00
Trashëguar nga transferta specifike	6,623,980. 00	6,623,980. 00
Të trashëguara nga FZHR	-	-
Plani i të ardhurave viti ushtrimor	101,000,000. 00	62,133,043. 00
Granti	178,528,475. 00	138,222,192. 00
Fondi për pagat	37,643,109. 00	37,643,109. 00
Transferta specifike	90,981,947. 00	79,382,912. 00
Totali I fondeve 1	440,979,914. 46	350,207,639. 00
Paga/sig Gjendja civile - 600+601	7,968,412. 00	7,467,726. 00
Njoftim zgjedhësit 2025 - 602	106,000. 00	70,500. 00
Fonde për adm ZAZ -602	1,911,462. 00	1,876,036. 00
Fondi emergjenca civile - 604	1,861,230. 00	-
Bonos qiraje 2025 - 606	1,069,014. 00	961,400. 00
Bonus qiraje 2025 - 606	4,849,000. 00	4,849,000. 00
Ndihma ekonomike 2025 - 606	46,713,000. 00	46,097,776. 00
PAK - 606	210,748,000. 00	210,635,537. 00
Fondi Ministrisë për qëndresën sociale - 606	1,233,900. 00	1,233,900. 00
Vendime gjygjesore Verbër - 606	440,000. 00	439,390. 00
Investim - Rik I digës - 231	25,625,546. 00	25,565,911. 00
Investim - Blere mjet zjarrfikës - 231	5,040,000. 00	5,040,000. 00
Totali I fondeve 2	307,565,564. 00	304,237,176. 00
Shuma totale 1+2	**748,545,478. 46**	**654,444,815. 00**

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Belsh

Nga auditimi i të dhënave ne lidhje me çeljen e fondeve buxhetore dhe ndryshimi sipas akteve normative u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit ka qenë në vlerën 406,852 mijë lekë me ndryshimet e pësuara arrin në vlerën 440,980 mijë lekë. Plani i rishikuar gjatë vitit është në vlerën 440,980 mijë lekë që së bashku me funksionet e deleguara plani i çelur në thesar është në vlerën 748,545 mijë lekë. Të përmbledhura sipas programeve buxhetore janë së bashku me Agjencinë e Funksioneve të pa Transferueshme si më poshtë vijon:

Tabela 2/12:Planifikimi i programeve buxhetore me ndryshime/ mijë lekë

Titulli	**Emërtimi**	**Plan Fillestar Viti 2025**	**Plani me ndryshime 2025**
AA152	Planifikim , menaxhim administrim	164,450	173,889
AB152	Rendi dhe Siguria Publike	24,146	25,448
AC152	Menaxhimi për zhvillim ekonomik dhe Mirëmbajtja e rrugëve	51,197	99,917
AD152	Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtje e Mjedisit	74,178	76,033
AE152	Arsimi, Kultura dhe Sporti	88,881	61,693
AF152	Fondi Rezerve dhe Kontigjenca	4,000	4,000
		406,852	**440,980**
04130	Kujdes Social		257,901
01170	Gjendja Civile		8,074
06190	Bonusi I qerase		5,918
10910	Emergjencat civile		32,527
10430	Nderim Brezash		1,234
01620	KZAZ		1,911
Totali i Shpenzimeve te Ministrisë			**748,545**

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Belsh

Programi buxhetor *"Planifikim, menaxhim administrim"* në planin fillestar buxhetor ka qenë në vlerën 164,450 mijë lekë me rishikimet e kryera gjatë vitit është plan i çelur në thesar është në vlerën 173,899 mijë lekë.
Programi buxhetor *"Rendi dhe Siguria Publike"* në planin fillestar buxhetor ka qenë në vlerën 24,146 mijë lekë me rishikimet e kryera gjatë vitit plan i çelur në thesar është në vlerën 25,488 mijë lekë.
Programi buxhetor *"Menaxhimi për zhvillim ekonomik dhe Mirëmbajtja e rrugëve"* në planin fillestar buxhetor ka qenë në vlerën 51,197 mijë lekë me rishikimet e kryera gjatë vitit dhe plan i çelur në thesar është në vlerën 99,917 mijë lekë.

Programi buxhetor *"Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtje e Mjedisit"* në planin fillestar buxhetor ka qenë në vlerën 74,178 mijë lekë me rishikimet e kryera gjatë vitit është plan i çelur në thesar është në vlerën 76,033 mijë lekë
Programi buxhetor *"Arsimi, Kultura dhe Sporti"* në planin fillestar buxhetor ka qenë në vlerën 88,881 mijë lekë me rishikimet e kryera gjatë vitit është plan i çelur në thesar është në vlerën 61,693 mijë lekë.
Programi buxhetor *"Fondi Rezerve dhe Kontigjenca"* në planin fillestar buxhetor ka qenë në vlerën 4,000 mijë lekë me rishikimet e kryera gjatë vitit është plan i çelur në thesar është në vlerën 4,000 mijë lekë

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit 2025
Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025 janë dërguar në thesar Dega Elbasan shkresat për ndryshimet në planin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore
Me shkresën nr. 712 prot., datë 21.02.2025 ndryshime te zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AA152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 6,000,000 lekë dhe pakësohet programi AA152 llogaria 601 *"Shpenzime paga"* 6,000,000 lekë.
Shtohet programi AD 152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 5,000,000 lekë dhe pakësohet programi AD152 llogaria *"Shpenzime paga"* 6,000,000 lekë
Shtohet programi AE 152 llogaria 606 *"Kompensim shpenzime"* 500,000 lekë dhe pakësohet programi AE 152 llogaria 604 *"Transferime"* 500,000 lekë.
Me shkresën nr. 1120. prot., datë 26.03.2025 dërgohet shtesa e buxhetit për vitin 2025 sipas Projekt Vendimin nr. 796 prot., datë 26.02.2025 *"Për miratimin e shtesës se buxhetit për vitin 2025"* te miratuar me VKB nr. 9 datë 05.03.2025 me nr. 920. prot., datë 06.03.2025 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 384/1 prot., datë 17.03.2025 është shtuar buxheti i vitit 2025 në vlerën 32,862,383 lekë.
Vlera prej 32,862,383 lekë përbehet nga të ardhurat si më poshtë vijon:
1-Grandi i trashëguar nga viti 2024 20,096,121 lekë
2-Të ardhura te çelura te pa përdorura nga viti 2024 2,893,014 lekë
3-Të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 në vlerën 9,837,248 lekë

Vlera prej 32,862,383 lekë planifikuar për shpenzimet si më poshtë vijon:
1-Trasferime dhe subvencione 822,934 lekë
2-Projektime 1,133,135 lekë
3-Investime 30,870,314 lekë llogaria 231
Me shkresën nr. 1835. prot., datë 22.05.2025 ndryshime te zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AA152 llogaria 606 *"Shpenzime për dalje ne pension"* 82,200 lekë dhe pakësohet programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 82,200 lekë.
Shtohet programi AD 152 llogaria 606 *"Shpenzime për dalje në pension"* 99,000 lekë dhe pakësohet programi AD152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 99,000 lekë
Me shkresën nr. 2278. prot., datë 26.06.2025 ndryshime të zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AD152 llogaria 606 *"Shpenzime për dalje në pension"* 40,000 lekë dhe pakësohet programi AD152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 40,000 lekë.
Me shkresën nr. 2562 prot., datë 10.07.2025 ndryshime të zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AC152 llogaria 604 *"Ndërtimi i serave bujqësore me sipërfaqe 100 m2 "* 1,860,222 lekë dhe pakësohet programi AC152 llogaria 231 *"Ndërtimi i serave bujqësore me sipërfaqe 100 m2"* 1,860,222 lekë. Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 24. , datë 03.06.2025 për transferimin e fondit për të tretë sipas kontratës me *"Islamic Relief Albania"*
Me shkresën nr. 2701 prot., datë 28.07.2025 ndryshime të zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AA152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 300,000 lekë dhe pakësohet programi AA152 llogaria 601 *"Shpenzime sigurime "* 300,000 lekë.
Shtohet programi AD152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 7,960,000 lekë dhe pakësohet programi AD152 llogaria 600 *"Shpenzime page "* 7,960,000lekë.

Shtohet programi AD152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 2,500,000 lekë dhe pakësohet programi AD152 llogaria 601 *"Shpenzime sigurime "* 2,500,000 lekë.
Shtohet programi AE152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 2,000,000 lekë dhe pakësohet programi AE152 llogaria 600 *"Shpenzime page "* 1,500,000 lekë dhe 601 *"Shpenzime sigurime "* 500,000 lekë.
Shtohet programi AE152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 1,620,000 lekë dhe pakësohet programi AE152 llogaria 600 *"Shpenzime page "* 1,620,000 lekë.
Me shkresën nr. 2928. prot., datë 18.08.2025 ndryshime te zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AD152 llogaria 606 *"Shpenzime për dalje ne pension"* 40,000 lekë dhe pakësohet programi AD152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 40,000 lekë.
Shtohet programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime për paga"* 1,300,000 lekë dhe pakësohet programi AA152 llogaria 601 *"Shpenzime sigurime "* 1,300,000 lekë.
Me shkresën nr. 3092. prot., datë 29.08.2025 ndryshime te zërave jashtë programeve buxhetore: Shtohet programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime për paga"* 8,000,000 lekë dhe pakësohet programi AE152 llogaria 231 *"Ndërtimi i qendrës rinore Belsh "* 8,000,000 lekë. Ndryshimi buxhetor është bërë me VKB nr. 36 datë 05.08.2025.
Shkresa me nr. 2968. prot., datë 20.08.2025 ndryshime buxhetore me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 36 datë 05.08.2025 të konfirmuar nga prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 895/1. Prot., datë 15.08.2025.
Shtesë programi AA152 artikulli 604 *"Subvencionim Sha Grin Belsh"* sipas VKB nr. 29 datë 14.07.2025 për vlerën 7,700,000 lekë.
Shtesë programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime për paga"* në vlerën 8,000,000 lekë, shtesë programi AD152 llogaria 231 *"Blerje peme dekorative"* 1,200,000 lekë
Shtesë programi AC152 llogaria 230 *"Projektim objekti, ndërtim dhe asfaltim i rrugëve të brendshme të Bashkisë Belsh"* në vlerën 12,006,492 lekë.
Shtesë programi AE152 llogaria 230 *"Projektim objekti, ndërtim i objektit 2 kat të qendrës rinore Belsh"* në vlerën 884,391 lekë.
Shtesë programi AE152 llogaria 230 *"Projektim objekti, ndërtim i objektit 2 kat të kopshtit Belsh"* në vlerën 772,028 lekë.
Shtesë programi AA152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* në vlerën 2,287,089 lekë. Shtesë programi AA152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* në vlerën 3,485,000 lekë. Shtesë programi AC152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* në vlerën 1,000,000 lekë.
Shtesë programi AC152 llogaria 231 *"Mbikëqyrje rikonstruksion i disa rrugëve të brendshme të fshatrave te Bashkisë Belsh faza 3"* 1,040,000 lekë.
Shtesë programi AC152 llogaria 231 *"Kolaudim rikonstruksion i disa rrugëve të brendshme të fshatrave të Bashkisë Belsh faza 3"* 120,000 lekë.
Shtesë programi AD152 llogaria 231 *"Vegla pune dhe pajisje të ndryshme për sektorin e shërbimeve pranë Bashkisë Belsh"* 600,000 lekë.
Shtesë programi AA152 llogaria 231 *"Pajisje kompjuterike printer dhe fotokopje"* 600,000 lekë. Shtesë programi AA152 llogaria 609 *"Fondi rezerve për vitin 2025"* në vlerën 300,000 lekë. Shtesë programi AD152 llogaria 231 *"Lidhje kontrate e re energjie"* 40,000 lekë. Shtesë programi AD152 llogaria 231 *"Lidhje kontratë e re uji i pijshëm "* 15,000 lekë. Ne total shtesat e programeve buxhetore sipas VKB nr. 36. , datë 05.08.2025 janë në vlerën 40,000,000 lekë dhe pakësimit 40,000,000 lekë
Pakësimit sipas shkresës me nr. 2968. prot., datë 20.08.2025 ndryshime buxhetore me Vendim te Këshillit Bashkiak nr. 36. , datë 05.08.2025 janë si më poshtë vijon:
Pakësohet programi AA152 llogaria 231 *"Rikonstruksion i godinës ekzistuese te Bashkisë Belsh"* me vlerë 6,000,000 lekë.
Pakësohet programi AA152 llogaria 231 *"Furnizim vendosje mobile për ambientet e zyrave te institucionit Bashkia Belsh "* me vlerë 2,000,000 lekë.
Pakësohet programi AC152 llogaria 230 *"Për hartim projekti ndërtimi i objekteve një familje tip ne zona rurale ne territorin e Bashkisë Belsh"* në vlerën 300,000 lekë

Pakësohet programi AE152 llogaria 231 *"Ndërtimi i qendrës rinore Belsh"* 20,000,000 lekë. Pakësohet programi AA152 llogaria 231 *"Ndërtimi i kopshtit publik Belsh"* në vlerën 10,000,000 lekë. Pakësohet programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* në vlerën 900,000 lekë. Pakësohet programi AA152 llogaria 231 *"Blerje automjet për shërbime te institucionit "* në vlerën 800,000 lekë.
Me shkresën nr. 3223. prot., datë 11.09.2025 ndryshime te zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AA152 llogaria 606 *"Shpenzime për dalje ne pension"* 140,000 lekë dhe pakësohet programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 140,000 lekë.
Me shkresën nr. 3343. prot., datë 23.09.2025 ndryshime te zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AE152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 3,000,000 lekë dhe pakësohet programi AE152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 3,000,000 lekë.
Shtohet programi AB152 llogaria 602 *"Shpenzime operative"* 800,000 lekë dhe pakësohet programi AB152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 800,000 lekë.

Me shkresën nr. 3417. prot., datë 29.09.2025 ndryshime te zërave jashtë programeve buxhetore: Shtohet programi AC152 llogaria 600 *"Shpenzime page"* 3,300,000 lekë shtohet programi AC152 llogaria 601 *"Shpenzime page"* 550,000 lekë , shtohet programi AA 152 llogaria 601 *"Shpenzime page"* 550,000 lekë dhe pakësohet programi AA152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 4,400,000 lekë miratuar me Vendim te Këshillit bashkiak nr. 43 datë 19.09.2025
Me shkresën nr. 3492. prot., datë 06.10.2025 ndryshime të zërave jashtë programeve buxhetore: Shtohet programi AA152 llogaria 606 *"Dhënie ndihme financiare"* 300,000 lekë pakësohet programi AA152 llogaria 609 *"Fondi rezervë"* 300,000 lekë. Vendimi është miratuar me VKB nr. 44. , datë 19.09.2025.
Me shkresën nr. 3555 prot., datë 13.10.2025 ndryshime të zërave brenda programeve buxhetore: Shtohet programi AB152 llogaria 606 *"Kompensim shpenzimesh "* 1,009,600 lekë dhe pakësohet programi AB152 llogaria 600 *"Shpenzime paga"* 1,009,600 lekë. Për çfarë janë këto shpenzime
Me shkresën nr. 3921. prot., datë 10.11.2025 shtesë fondi për shpërblimin e punonjësve të MZSH (transfertë e pa kushtëzuar) shtohen shpenzimet për shpërblimet e punonjësve 1,320,000 lekë për sipas VKB nr. 49. , datë 29.10.2025 konfirmuar nga Prefekti i qarkut me Shkresë nr. 1191/1. prot., datë 05.11.2025

Tabela 2/13:Planifikimi i llogarive buxhetore me ndryshime/ mijë lekë

		Plan Fillestar Viti 2025	**Plani i Periudhës/progresiv**
600	Paga	212,375	199,159
601	Sigurime Shoqërore	36,980	34,624
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	68,924	106,894
603	Subvencione		
604	Transferta Korrente të Brendshme	10,500	22,244
605	Transferta Korrente të Huaja		
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ		268,616
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	***328,779***	***631,537***
230	Kapitale të Patrupëzuara		14,446
231	Kapitale të Trupëzuara	78,072	102,562
232	Transferta Kapitale		
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**78,072**	**117,008**
Totali (korrente + kapitale)		**406,852**	**748,545**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të investimeve u konstatua se ka pasur ndryshime të shpeshta buxhetore në lidhje me investimet përkatësisht në PBA faza e parë në shumën 94,591 mijë lekë janë parashikuar 5 projekte investimesh. Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 65 datë 30.12.2024 janë planifikuar investime në vlerën 78,071,584 lekë. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 09 datë 05.03.2025 janë shtuar investimet për vitin 2025 në vlerën 32,862,383 lekë dhe sipas ndryshimeve buxhetore gjatë vitit planifikimi përfundimtar i vitit është në vlerën 114,241,847 lekë dhe realizimi në vlerën 69,167,671 lekë. Në mënyrë të përmbledhur sipas programeve buxhetore paraqiten në Aneks 2/1 dhe 2/2,

Nga auditimi i planifikimit te investimeve u konstatua se gjatë hartimit të fazave të parë të dytë dhe të tretë të PBA 2025-2027 është kryer planifikim i pa saktë i investimeve pasi planifikimi ne PBA Faza e parë është për shumën 94,591 mijë lekë janë parashikuar 5 projekte investimesh. Në fazën përfundimtare të PBA planifikimi i investimeve ka përfshirë 7 objekte investimesh me vlerë 78,072 mijë lekë nga te cilat tre objekte investimesh me vlerë 36,000 mijë që kanë qene planifikuar në PBA e fazës së parë dhe Fazës së dytë nuk janë në planin përfundimtar vjetor të buxhetit të ndryshuar si dhe nuk janë realizuar gjatë vitit 2025. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk u paraqiten dokumentacion për dëgjesa publike në lidhje me vendimmarrjen për ndryshimin e prioriteteve në planifikimin e investimeve dhe ndryshimin e investimeve gjatë procesit te hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor.

Konkluzion : Nga auditimi i planifikimit të investimeve u konstatua se gjatë hartimit të fazave të parë të dytë dhe të tretë të PBA 2025-2027 është kryer planifikim i pa saktë i investimeve pasi planifikimi ne PBA Faza e parë është për shumën 94,591 mijë lekë janë parashikuar 5 projekte investimesh. Në fazën përfundimtare të PBA planifikimi i investimeve ka përfshirë 7 objekte investimesh me vlerë 78,072 mijë lekë nga të cilat tre objekte investimesh me vlerë 36,000 mijë që kanë qenë planifikuar në PBA e fazës së parë dhe fazës së dytë nuk janë në planin përfundimtar vjetor të buxhetit të ndryshuar si dhe nuk janë realizuar gjatë vitit 2025. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk u paraqiten dokumentacion për dëgjesa publike në lidhje me vendimmarrjen për ndryshimin e prioriteteve në planifikimin e investimeve dhe ndryshimin e investimeve gjatë procesit të hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor.

Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26. 6. 2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"*, i ndryshuar Neni 26 Programi buxhetor afatmesëm pika 4. *"Tërësinë e dokumentacionit të dërguar nga njësitë e qeverisjes qendrore, sipas formateve standarde, i cili duhet, minimalisht, të përmbajë: qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre respektive"*.

Në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3. , datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" pika 16 "Kryetari i njësisë se vetëqeverisjes vendore organizon takime konsultative ne përfaqësues te komunitetit lokal gjatë fazës se përgatitjes se projekt dokumentit të PBA-se" dhe pika 30 "* Ekipi i Menaxhimit të Programeve *hartojnë DPP dhe PSHP brenda tavanit te fazës së dytë. Ne këto ndryshime përfshihet çdo udhëzim nga Këshilli pas rishikimit të PBA se fazës së parë (projekt dokumenti i PBA) si dhe germa a) Çdo rishikim të shpenzimeve te politikave ekzistuese dhe germa b) Përfshirjen e çdo politike te re te miratuar ne tërësi ose pjesërisht nga Këshilli. Pika 32 "..... Proces verbalet e takimeve se bashku me qëndrimet përkatëse te njësisë se vetëqeverisjes vendore behën pjese e dokumentit te projektit programit buxhetor afatmesëm.*

Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi
Z. A. T. Kryetari i Bashkisë
Z. A. N. Drejtor i financës dhe Buxhetit
Z. M. Ç. Koordinator i Grupi Menaxhimit Strategjik-*së*

Nga auditimi u konstatua se ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë alokuar fondet nga transfertat e pakushtëzuara, fondet nga transfertat e kushtëzuara, sektoriale, specifike etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, u konstatua se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Belsh.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua se nuk është përgatitur dhe miratuar kalendari i PBA 2025-2027, duke mos respektuar afatin e përcaktuar për përgatitjen e tije.
Nga auditimi u konstatua se hartimi i fazës së parë të PBA 2025-2027 është kryer dhe dërguar në Këshill për miratim jashtë afatit 15 mars 2024.
Nga auditimi u konstatua se projekti i parë i PBA 2025-2027 nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025 - 2026 dhe buxhetit vjetor, rezulton se mungojnë, kërkesat shkresore nga drejtorët e drejtorive të Bashkisë Belsh në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse dhe kërkesat e sektorëve të ndryshëm që mbulojnë këto programe, dokumentacioni që evidenton punën e kryer nga Grupi Menaxhimit Strategjik dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, si dhe dëgjesat publike nuk janë dokumentuar me procesverbalet apo relacionet e zhvillimit të takimeve për këtë qëllim
U konstatua se buxheti i vitit 2025 është miratuar datë 27.12.2024 jashtë afateve te përcaktuara.
Veprime në mos përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 18 i cili përcakton: "Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore miraton kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor jo më vonë se data 31 dhjetor. "
Në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" ndryshuar me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022, Kreu 3. Procedurat për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm pika 54,55,56,57,77, 88, pika 130. Në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" pika 6, pika11, pika 46, pika 67,71,72,83,85,

Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi
Z. A. T. Kryetari i Bashkisë
Z. A. N. Drejtor i financës dhe Buxhetit
Z. M. Ç. Koordinator i Grupi Menaxhimit Strategjik-së

III.2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Elbasan, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Belsh, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Belsh, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Për vitin 2025 është përgatitur vetëm raporti vjetor i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2025 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. prot. 814, datë 18.03.2026, por nuk janë hartuar raporte monitorimi periodike 4-mujore dhe nuk janë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak gjatë vitit ushtrimor 2024, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2027 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 48, pika 1 në të cilën përcaktohet: *"Nëpunësit autorizues të njësive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa here që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katër mujorë të monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrit të Financave për monitorimin e zbatimit të buxheti"*
Nga auditimi i raportit të monitorimit të buxhetit u konstatua se në raportin e monitorimit të buxhetit është pasqyruar vetëm planifikimi dhe realizimi i programeve buxhetore të Bashkisë Belsh pa përfshirë Agjencinë e Funksioneve të pa transferueshme. Pasqyrimi i realizimit të programeve buxhetore në raportin e monitorimit të Bashkisë është pa përfshirë Agjencinë e Funksioneve të pa transferueshme si më poshtë vijon:

Tabela 2/14:Planifikimi dhe realizimi i programeve buxhetore pa përfshire Agjencinë e Funksioneve të pa transferueshme/mijë lekë

Nr.	Programet për vitin 2025	Kodi i programit	Pani 2025 /000 lekë	Fakti 2025/000 lekë	% e realizimit
1	Planifikim , menaxhim administrim	AA152	138,289	120,811	87. 4%
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB152	0	0	
3	Menaxhimi për zhvillim ekonomik dhe Mirëmbajtja e Rrugëve	AC152	74,442	33,796	45. 4%
4	Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtja e Mjedisit	AD152	68,738	57,749	84. 0%
5	Arsimi, Kultura dhe Sporti	AE152	14,212	11,105	78. 0%
6	Fondi Rezerve dhe Kontigjenca	AF152	4,000	0	0. 0%
7	Kujdesi Social	4130	257,901	257,173	99. 7%
8	Gjendja civile	1170	8,074	7,538	93. 0%
9	Bonusi I qerase	6190	5,918	5,810	98. 0%
10	Emergjencat civile	10910	32,527	30,606	94. 0%
11	Nderim Brezash	10430	1,234	1,234	100. 0%
12	KZAZ	1620	1,911	1,876	98. 2%
	Totali		**607,247**	**527,699**	**86%**

Burimi: Drejtoria Financës dhe buxhetit

Nga auditimi i të dhënave të raportit të monitorimit u konstatua se të dhënat në lidhje me planifikimin dhe realizimin e objekteve të investimeve janë plotësuar në mënyrë të pasaktë pasi realizimi i investimeve i raportuar në raportin e monitorimit është 97,286 mijë lekë plan buxheti 2025 dhe realizim 97,286 mijë lekë së bashku me FZHR ndërsa shuma e tyre në mbledhjen e tabelës së raportuar rezulton 143,576 mijë planifikim dhe 143,576 realizim. Ndërsa sipas Aneksit 5 *"Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe financim të huaj"* të raportit të monitorimit është në vlerën 143,576 mijë lekë planifikim dhe 143,576 mijë lekë realizim. Pasqyrimi në raportin e monitorimit është kryer në mënyrë të pasaktë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks 2/3.
U konstatua se në tabelën e mësipërme shuma e planifikimit nuk është 97,286 mijë lekë dhe realizimi 97,286 mijë lekë por mbledhja e tyre sipas tabelës është 143,576 mijë lekë planifikim dhe 143,576 mijë lekë realizim. Vlera planifikim 143,576 mijë lekë dhe realizim 143,576 mijë lekë është paraqitur në Aneksin 5 të raportit të monitorimit si më poshtë vijon. Në mënyrë te detajuar paraqitet në Aneks 2/4.
Nga auditimi i të dhënave të raportit të monitorimit u konstatua se të dhënat në lidhje me planifikimin dhe realizimin e objekteve të investimeve janë plotësuar në mënyrë te pasaktë duke pasqyruar planifikimin dhe realizimin e treguesve për vlerën e planifikimit rrjedhimisht pasqyrim të pa saktë të planifikimit dhe realizimit të investimeve.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Belsh janë planifikuar 117,008 mijë lekë investime për vitin 2025 dhe realizuar 69,169 mijë lekë investime për vitin 2025. Në mënyrë te detajuar paraqitet ne Aneks 2/5.

Nga auditimi i dhënave të thesarit sipas printimit të llogarive ekonomike nga thesari për Bashkinë Belsh pa njësi vartësie u konstatua se në total realizimi Acrual dhe Cash nuk përputhen me njëra tjetrën pasi realizimi sipas Acrual për vitin 2025 është 527,699,880 lekë dhe realizimi Cash 527,089,980 lekë me një ndryshim vjetor prej 609,900 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks 2/6.

U konstatua se llogaria 230-231 sipas Acrual është 69,167,670 lekë ndërsa sipas Cash është 91,714,000 lekë ose 22,546,330 lekë me shumë Cash se Acrual. Në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks 2/7.
Vlerat e pasqyruara Cash në janar 2025 për llogarinë 230-231 vijnë nga të dhëna të raportuara në Acrual në fund të vitit 2024 ndërsa diferencat prej 10,800,960 lekë si pasojë e paraqitjes së urdhër shpenzimeve në fund të vitit 2025 në thesar dhe veprimet janë kryer në janar 2026. Urdhër shpenzimi është me nr. 488 datë 30.12.2025 *"Hartim projekti për "Ndërtim dhe Asfaltim I disa rrugëve te Brendshme te Bashkisë Belsh" e raportuar në Acrual në vitin 2025 dhe është raportuar Cash nga thesari në janar 2026.*
Llogaria 600 "Pagat e punonjësve" nuk ka ndryshime midis Cash dhe Acrual dhe janë të barabarta për vitin 2025 në vlerën 98,754,250 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks 2/8.
Llogaria 601 *"Sigurime shoqërore"* nuk ka ndryshime midis Cash dhe Acrual dhe janë të barabarta për vitin 2025 në vlerën 15,972,810 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks 2/9.

Llogaria 602 *"Mallra dhe shërbime"* sipas Acrual është 63,351,720 lekë dhe sipas Cash 64,807,930 lekë me një ndryshim vjetor për vlerën 1,456,210 lekë më shumë Cash se Acrual për vitin 2025. Të detajuara ndryshimet gjatë vitit paraqitet në Aneks 2/10:
Vlerat e pasqyruara Cash në janar 2025 për llogarinë 602 vijnë nga të dhëna të raportuara në Acrual në vitin 2024 për të cilat nuk disponohet ndërsa diferencat prej 4,272,070 (439,140 + 1,595,790 + 1,561,080 + 676,060) e raportuar në Acrual në vitin 2025 është raportuar Cash nga thesari në janar 2026 si pasojë e paraqitjes së urdhër shpenzimeve në fund të vitit 2025 në thesar dhe veprimet janë kryer në janar 2026 nga thesari përkatësisht (439,140+ 1,595,790+1,561,080+676,060)

Llogaria 604 *"Transferime"* sipas Acrual është 15,574,410 lekë dhe sipas Cash 15,250,520 lekë me një ndryshim vjetor për vlerën 323,890 lekë më shumë Acrual se Cash për vitin 2025. Të detajuara ndryshimet gjatë vitit paraqitet në Aneks 2/11:

Vlerat e pasqyruara për llogarinë 604 në Acrual në vitin 2025 për vlerën 323,890 lekë është raportuar Cash nga thesari në janar 2026 si pasojë e paraqitjes së urdhër shpenzimit në fund të vitit 2025 në thesar dhe veprimet janë kryer në janar 2026 nga thesari për vlerën 323,890 lekë urdhër shpenzimi nr. 505 datë 31.12.2025.

Llogaria 606 *"Transferta për buxhete familjare dhe individë"* sipas Acrual është 264,879,020 lekë dhe sipas Cash 240,590,470 me një ndryshim vjetor për vlerën 24,288,550 lekë më shumë Acrual se Cash për vitin 2025. Të detajuara ndryshimet gjatë vitit paraqitet në Aneks 2/12:

Vlerat e pasqyruara për llogarinë 606 në Acrual ne vitin 2025 për vlerën 24,288,550 lekë është raportuar Cash nga thesari në janar 2026 si pasoje e paraqitjes së urdhër shpenzimeve në fund të vitit 2025 në thesar dhe veprimet janë kryer në janar 2026 nga thesari për vlerën 24,288,550 lekë. Urdhër shpenzimet 493 datë 31.12.2025 me vlerë 17,280,000 lekë, nr. 496 datë 31.12.2025 me vlerë 6,720,000 lekë dhe nr. 494 datë 31.12.2025 me vlerë 300,000 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i dhënave të thesarit sipas printimit të llogarive ekonomike nga thesari për Bashkinë Belsh pa njësi vartësie u konstatua se në total realizimi Acrual dhe Cash nuk përputhen me njëra tjetrën pasi realizimi sipas Acrual për vitin 2025 është 527,699,880 lekë dhe realizimi Cash 527,089,980 lekë me një ndryshim vjetor prej 609,900 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të situacionit buxhetor të thesarit dhe ditarit të shpenzimeve u konstatua se ndryshimet midis të dhënave Acrual dhe Cash vijnë si pasojë e raportimeve të urdhër shpenzimeve të muajit dhjetor 2025 janë raportuar nga Bashkia Belsh të kryera për vitin 2025 ndërsa pagesa reale sipas thesarit është kryer në vitin në vazhdim 2026.
U konstatua se llogaria 230-231 sipas Acrual është 69,167,670 lekë ndërsa sipas Cash është 91,714,000 lekë ose 22,546,330 lekë me shumë Cash se Acrual për vitin 2025. Diferenca prej 22,546,330 lekësh përbehet nga 36,329,010 lekë qe vjen nga viti 2024 dhe pasqyruar Cash në Janar 2025 ndërsa minus 13,782,680 lekë nga pasqyrimi Acrual në vitin 2025 dhe Cash ne vitin 2026. (22,546,330 = 36,329,010-13,782,680)
Llogaria 602 *"Mallra dhe shërbime"* sipas Acrual është 63,351,720 lekë dhe sipas Cash 64,807,930 lekë me një ndryshim vjetor për vlerën 1,456,210 lekë më shumë Cash se Acrual për vitin 2025. Diferenca prej 1,456,210 lekësh përbehet nga 5,728,280 lekë që vjen nga viti 2024 dhe pasqyruar Cash në Janar 2025 ndërsa minus 4,272,070 lekë nga pasqyrimi Acrual në vitin 2025 dhe Cash në vitin 2026. (1,456,210 = 5,728,280 - 4,272,070)
Llogaria 604 *"Transferime"* sipas Acrual është 15,574,410 lekë dhe sipas Cash 15,250,520 lekë me një ndryshim vjetor për vlerën 323,890 lekë me shumë Acrual se Cash për vitin 2025. Vlera 323,890 lekë është pasqyruar Cash ne janar 2026.
Llogaria 606 *"Transferta për buxhete familjare dhe individë"* sipas Acrual është 264,879,020 lekë dhe sipas Cash 240,590,470 me një ndryshim vjetor për vlerën 24,288,550 lekë me shumë Acrual se Cash për vitin 2025 Vlera 24,288,550 lekë është pasqyruar Cash ne janar 2026.
Nga auditimi u konstatua se nuk është respektuar disiplina buxhetore ne lidhje me pasqyrimin buxhetor te Urdhër shpenzimeve në kohë për ekzekutim nga ana e thesarit.

Veprime në mospërputhje me ligjin me Ligjin nr. 9936, datë 26. 6. 2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 52 *"Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik. Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik. Kryerja e shpenzimeve bëhet vetëm nëse masa e shpenzimit nuk kalon fondet e angazhuara për këtë qëllim. Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës. Shpenzimet e fondeve të miratuara të Buxhetit të Shtetit dhe të buxhetit vendor realizohen deri në fund të vitit buxhetor. Shlyerja e angazhimeve, me përfundimin e afatit të parashikuar në paragrafin më lart, realizohet me fondet e miratuara për vitin buxhetor pasardhës, me përjashtim të rasteve kur shpenzimi është kryer përpara mbarimit të vitit buxhetor. Në këtë rast, pagesa kryhet brenda datës 31 janar të vitit buxhetor pasardhës. Kjo periudhë shërben për përgatitjen e dokumentacionit bazë dhe për kryerjen e pagesës"*.
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar pika 26.
Neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues Neni 12 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues Udhëzim Nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik (I azhurnuar me Udhëzimin nr. 20 data 17.11.2014, Udhëzimin nr. 1 datë 06.05.2016 dhe Udhëzimin nr. 24 datë 07.12.2016) pika 34 germa a) "germa. b) Neni 36. pika 18.*

Tabela 2/15:Planifikimi dhe realizimi i programeve buxhetore se bashku me njësite e varësisë /mijë lekë

Titulli	*Emërtimi*	*Plan Fillestar Viti 2025*	*Plani i çelur 2025*	*Fakti 2025*	*Diferenca*	*%*
AA152	*Planifikim , menaxhim administrim*	*164,450*	*173,889*	*154,891*	*- 18,998*	*89%*
AB152	*Rendi dhe Siguria Publike*	*24,146*	*25,448*	*22,750*	*- 2,698*	*89%*
AC152	*Menaxhimi për zhvillim ekonomik dhe Mirëmbajtja e rrugëve*	*51,197*	*99,917*	*58,055*	*- 41,862*	*58%*
AD152	*Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtje e Mjedisit*	*74,178*	*76,033*	*64,304*	*- 11,729*	*85%*

AE152	*Arsimi, Kultura dhe Sporti*	*88,881*	*61,693*	*50,292*	*- 11,401*	*82%*
AF152	*Fondi Rezerve dhe Kontigjenca*	*4,000*	*4,000*	*-*	*- 4,000*	
		406,852	***440,980***	***350,292***	***- 90,688***	*79%*
04130	*Kujdes Social*		*257,901*	*257,173*	*- 728*	*100%*
01170	*Gjendja Civile*		*8,074*	*7,538*	*- 536*	*93%*
06190	*Bonusi I qerase*		*5,918*	*5,810*	*- 108*	*98%*
10910	*Emergjencat civile*		*32,527*	*30,606*	*- 1,921*	*94%*
10430	*Nderim Brezash*		*1,234*	*1,234*	*-*	*100%*
01620	*KZAZ*		*1,911*	*1,876*	*- 35*	*98%*
Totali i Shpenzimeve te Ministrisë			***748,545***	***654,529***	***- 94,016***	

Burimi: Drejtoria e financës dhe buxhetit

Programi buxhetor me kod AA152 "Planifikim , menaxhim administrim" është planifikuar 173,889 mijë lekë dhe është realizuar 154,891 mijë lekë ose në masën 89%.
Programi buxhetor me kod AB152 *"Rendi dhe Siguria Publike"* është planifikuar 25,448 mijë lekë dhe është realizuar 22,750 mijë lekë ose në masën 89%.
Programi buxhetor me kod AC152 *"Menaxhimi për zhvillim ekonomik dhe Mirëmbajtja e rrugëve"* është planifikuar 99,917 mijë lekë dhe është realizuar 58,055 mijë lekë ose në masën 58%.
Programi buxhetor me kod AD152 *"Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtje e Mjedisit"* është planifikuar 76,033 mijë lekë dhe është realizuar 64,304 mijë lekë ose në masën 85%.
Programi buxhetor me kod AE152 *"Arsimi, Kultura dhe Sporti"* është planifikuar 61,693 mijë lekë dhe është realizuar 50,292 mijë lekë ose në masën 82%.
Programi buxhetor me kod AF152 *"Fondi Rezerve dhe Kontigjenca"* është planifikuar 4,000 mijë lekë dhe është realizuar zero lekë
Programi buxhetor 04130*"Kujdes Social "* është planifikuar 257,173 mijë lekë dhe është realizuar 257,173 mijë lekë ose në masën 100%.
Programi buxhetor 01170 *"Gjendja Civile"* është planifikuar 8,074 mijë lekë dhe është realizuar 7,538 mijë lekë ose në masën 93%.
Programi buxhetor 06190 *"Bonusi i qirasë"* është planifikuar 5,918 mijë lekë dhe është realizuar 5,810 mijë lekë ose në masën 98%.
Programi buxhetor 10190 *"Emergjenca civile"* është planifikuar 32,527 mijë lekë dhe është realizuar 30,606 mijë lekë ose në masën 94%.
Për vitin 2025 realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimit me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2/16:Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas llojit te shpenzimit se bashku me njësite e varësisë/lekë

		Plan Fillestar Viti 2025	**Plani i Periudhës/progresiv**	**Fakti Periudhës/progresiv**	**Diferenca**
600	Paga	155,000	199,159	189,100	10,059
601	Sigurime Shoqërore	29,000	34,624	30,836	3,788
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	85,000	106,894	82,559	24,335
603	Subvencione				
604	Transferta Korrente të Brendshme	22,000	22,244	15,574	6,670
605	Transferta Korrente të Huaja				
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	149,364	268,616	267,292	1,324
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente*	*440,364*	*631,537*	*585,361*	46,176
230	Kapitale të Patrupëzuara		14,446	11,616	2,830
231	Kapitale të Trupëzuara	78,072	102,562	57,552	45,010
232	Transferta Kapitale				
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshëm***	***78,072***	***117,008***	***69,168***	47,840
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**78,072**	**117,008**	**69,168**	**94,016**
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh. jashtë limiti)		**518,436**	**748,545**	**654,529**	**94,016**

Burimi: Drejtoria e financës dhe buxhetit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2025 rezulton se, fondet buxhetore janë realizuar 654,529 mijë lekë nga 748,545 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 87,4%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi i ulët i fondeve në:
Llogaria 600 *"Pagat e punonjësve"* është planifikuar 199,159 mijë lekë dhe është realizuar 189,100 mijë lekë ose në masën 94,9%.
Llogaria 601 *"Sigurimet shoqërore"* është planifikuar 34,624 mijë lekë dhe është realizuar 30,836 mijë lekë ose në masën 89,1%.
Llog. 602 *"Mallra dhe shërbime të Tjera"* është planifikuar 106,894 mijë lekë dhe është realizuar 82,559 mijë lekë ose në masën 77,2%.
Llogaria 604 *"Transferta Korrente të Brendshme"* është planifikuar 22,244 mijë lekë dhe është realizuar 15,574 mijë lekë ose në masën 70 %.
Llogaria 606 *"Transferta buxhete familjare e individë"* është planifikuar 268,616 mijë lekë dhe është realizuar 267,292 mijë lekë ose në masën 99,5 %.
Llogaria 230-231 *"Investime "* është planifikuar 117,008 mijë lekë dhe është realizuar 69,168 mijë lekë ose në masën 87,4 %.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës si dhe fondeve të emergjencave civile Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 4,000 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 65, datë 27.12.2023 *"Për miratimin e buxhetit vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 e Bashkisë Belsh"*, e cila është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan nr. 1420/1, datë 10.01.2025 dhe i është dërguar Degës së Thesarit Elbasan me shkresën nr. 228. prot., datë 13.01.2025 dhe nuk është përdorur.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua se është përgatitur vetëm raporti vjetor i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2025 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe ekonomisë me shkresën nr. prot. 814, datë 18.03.2026, por nuk janë hartuar raporte monitorimi periodike 4-mujore dhe nuk janë paraqitur pranë këshillit bashkiak gjatë vitit ushtrimor 2024, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2027 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 48, pika 1 në të cilën përcaktohet: *"Nëpunësit autorizues të njësive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa here që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katër mujorë të monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrit të Financave për monitorimin e zbatimit të buxheti. "*
Nga auditimi i të dhënave të raportit te monitorimit u konstatua se te dhënat ne lidhje me planifikimin dhe realizimin e objekteve te investimeve janë plotësuar në mënyrë te pasaktë pasi realizimi i investimeve i raportuar ne raportin e monitorimit është 97,286 mijë lekë plan buxheti 2025 dhe realizim 97,286 mijë lekë se bashku me FZHR ndërsa shuma e tyre ne mbledhjen e tabelës se raportuar rezulton 143,576 mijë planifikim dhe 143,576 realizim. Ndërsa sipas Aneksit 5 *"Projektet e investimeve me financim te brendshëm dhe financim te huaj"* te raportit te monitorimit është në vlerën 143,576 mijë lekë planifikim dhe 143,576 mijë lekë realizim. Pasqyrimi ne raportin e monitorimit është kryer në mënyrë te pasaktë.
Nga auditimi i situacionit buxhetor te vitit 2025 si dhe te dhënat e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Belsh për vitin 2025 janë planifikuar 117,008 mijë lekë investime dhe realizuar 69,169 mijë lekë investime.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 65, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 44, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 06.02.2012, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore"*.
Veprime këto në kundërshtim me Ligj nr. 9936, datë 26. 6. 2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 3. Pika 44, Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat*

standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore" pika 22 dhe *"Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues të njësisë së vetëqeverisjes vendore"* pika 27, 28, 29.

Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi
Z. A.T. Kryetari i Bashkisë
Z. A. N. Drejtor i financës dhe Buxhetit

III.2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Nga auditimi u konstatua se janë dërguar në Ministrinë e Financave raport për Vetëvlerësimin Financiar me nr. 167. prot., datë 05.05.2025, raport për Vetëvlerësimin Financiar me nr. 3140. prot., datë 04.09.2025 dhe raport për Vetëvlerësimin Financiar me nr. 444. prot., datë 13.02.2026.
Sipas raportit për Vetëvlerësimin Financiar me nr. 444. prot., datë 13.02.2026 detyrimet e prapambetura të Bashkisë Belsh janë në vlerën 17,288,175 lekë te ndara si më poshtë vijon:
-Vendime gjyqësore në vlerën 10,596,906 lekë; Detyrime të prapambetura për shërbime në vlerën 179,500 lekë; Detyrime të prapambetura për investime në vlerën 6,511,769 lekë. Raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike vjetore të NJQV është në vlerën 3,92%. (17,288,175/440,979,914). Detyrimet e prapambetura raportuar ne MFE paraqiten në Aneks 2/13
Për sa më sipër referuar Udhëzimi nr. 35 datë 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive Financiare për Njësite e Vetëqeverisjes vendore"* pika 13 Bashkia Belsh është në gjendje normale financiare *"Gjendje normale financiare ne kuptim të këtij udhëzimi quhet rasti kur detyrimi i prapambetur është nën nivelin 15% të shpenzimeve vjetore faktike dhe që është në një afat nën 60 dite kalendarikë (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procedimit të pagesës në degën e thesarit)"*
Me fondet e vitit buxhetor 2025 janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Për vitin 2025 janë planifikuar fonde buxhetore nga Ministritë e linjës në vlerën 32,527 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 30,696 mijë lekë ose në masën 94,3%, fonde të cilat janë alokuar për financimin e projekteve të investimit si më poshtë:
Nga Ministria e Mbrojtjes *(Agjencia e Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC):* Projekti i investimit me objekt: *"Punime për rehabilitimin dhe ngritjen e sigurisë së digës Belsh dhe pastrimin e kanalit të shkarkimit"* ka filluar në vitin 2024 me vlerë kontrate prej 29,241 mijë lekë dhe realizimi i fondeve për të është në vlerën 3,615 mijë lekë për vitin 2024. Ka mbetur pa u likuiduar për vitin 2025 vlera prej 25,626 mijë lekë e kontratës. Vlera prej 25,626 mijë lekë është likuiduar gjatë vitit 2025.
Blerje automjet zjarrfikës financuar nga Ministria e Mbrojtjes kontratë e lidhur ne vitin 2025 me numër 3109/09 me vlerë 9,393 mijë lekë nga e cila është financuar për vitin 2025 vlera 5,400 mijë lekë

III.2.2.5 Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

Nga auaditimi i të dhënave në lidhje me miratimin e buxhetit të vitit 2025 u konstatua se me Projekt vendim nr. 06. , datë 19.12.2024 me nr. 4638. prot., datë 19.12.2024 është dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak Buxheti i vitit 2025. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 65 datë 27.12.2024 të protokolluar me nr. 4751 prot., datë 30.12.2024 është miratuar Buxheti i Vitit 2025. Me shkresën nr.

1420/1 datë 10.01.2025 është konfirmuar Buxheti i vitit 2025 nga Prefekti i Qarkut Elbasan Shkresë e protokolluar në Bashkinë Belsh me Nr. 2023. prot., datë 10.01.2025.
Të ardhurat e miratuara për buxhetin e vitit 2025 janë në vlerën 406,851,531 lekë te ndara si më poshtë vijon:
1-Transerata e pa kushtëzuar për vitin 2025 Bashkia Belsh në vlerën 178,528,475 lekë
2-Të ardhurat Bashkia Belsh 2025 Plan 101,000,000 lekë
3-Fondi për rritjen e pagave 37,643,109 lekë
4- Transferta sektoriale për vitin 2025 në vlerën 89,679,947 lekë

Shpenzimet e miratuara Buxheti i vitit 2025
1-Pagat e punonjësve 212,375,471 lekë
2-Sigurime Shoqërore 36,980,320 lekë
3-Shpenzime operative 68,924,156 lekë
4-Fondi i emergjencës 4,000,000 lekë
5-Kuota për Këshillin e qarkut 1% viti 2025 në vlerën 1,000,000 lekë
6-Investime 78,071,584 lekë
7-Subvencione për SHA *"Green Belsh"*
8-Shpenzime Transporti për nxënësit me aftësi te kufizuar 500,000 lekë.

Me Projekt Vendimin nr. 796. prot., datë 26.02.2025 *"Për miratimin e shtesës së buxhetit për vitin 2025"* të miratuar me VKB nr. 9. , datë 05.03.2025 me nr. 920. prot., datë 06.03.2025 dhe Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 384/1. prot., datë 17.03.2025 është shtuar buxheti i vitit 2025 në vlerën 32,862,383 lekë.
Vlera prej 32,862,383 lekë përbëhet nga të ardhurat si më poshtë vijon:
1-Grandi i trashëguar nga viti 2024 20,096,121 lekë
2-Të ardhura të çelura te pa përdorura nga viti 2024 2,893,014 lekë
3-Të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 në vlerën 9,837,248 lekë

Vlera prej 32,862,383 lekë planifikuar për shpenzimet si më poshtë vijon:
1-Trasferime dhe subvencione 822,934 lekë
2-Projektime 1,133,135 lekë
3-Investime 30,870,314 lekë

Nga auditimi i planifikimit të të ardhurave të veta të Bashkisë Belsh për vitin 2025 u konstatua se planifikimi i të ardhurave është në vlerën 101,000,000 lekë nga të cilat Të ardhura nga Burimet e veta (Taksa dhe tarifa vendore) në vlerën 84,790,000 lekë dhe Të ardhura nga Taksat e ndara 16,210,000 lekë. Në mënyrë të përmbledhur planifikimi i të ardhurave të veta për vitin 2025 paraqitet në Aneks 2/14.
Nga auditimi i të dhënave të planifikimit buxhetor për taksat dhe tarifat vendore u konstatua se niveli i realizimit të planit të të ardhurave të veta është në masën 80% të planifikimit nga 101,000,000 lekë që është planifikimi realizimi është në masën 80,853,593 lekë. Të detajuara planifikimi dhe realizimi i Taksave dhe Tarifave Vendore paraqiten në Aneks 2/15:
Tarifa për shërbimet administrative të Bashkisë e planifikuar në vlerën 4,266,000 dhe realizuar 5,126,396 lekë përmbledh sipas disa lloje të ardhurash sipas rakordimit te të ardhurave me thesarin dhe konkretisht:
Llogaria 7035028 *"Tarife për përdorim certifikate"* në vlerën 214,203 lekë
Llogaria 7035029 *"Tarife për autorizim urbanistik"* në vlerën 25,000 lekë
Llogaria 7035032 *"Tarife për leje zhvillimi"* në vlerën 50,000 lekë
Llogaria 7035033 *"Tarife për vërtetime"* në vlerën 42,300 lekë
Llogaria 7081006 *"Taksa e akteve te pullës 5 %"* në vlerën *38,250 lekë*
Llogaria 7035040 *"Tarife për leje ndërtimi"* në vlerën 4,436,363 lekë
Llogaria 7110106 *"Tarife për leje transporti"* në vlerën 245,280 lekë

Nga auditimi u konstatua se planifikimi i të ardhurave nuk është kryer në mënyrë te detajuar për taksat dhe tarifat vendore sipas llojit të tyre si dhe realizimi i të ardhurave është në masën 80% te planifikimit duke ndikuar negativisht ne procesin e realizimit te treguesve buxhetor të shpenzimeve te planifikuara te buxhetit 2025.
Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Belsh në fillim të vitit buxhetor planifikon angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1. 3, germa *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse
"Teprica e llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" paraqitet në fund të vitit 2024 në shumën 55,486,044 lekë dhe në fund të vitit 2025 në vlerën 49,755,029 lekë ose është pakësuar gjatë vitit 2025 në vlerën 5,731,015 lekë. Për vlerën debitorë 55,486,044 lekë në fund të vitit 2024 raporti i auditimit të mëparshëm të Klsh-së *citon: "Referuar analizës së kësaj llogarie rezultoi se nuk është përfshirë vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat prej 100,319,368 lekë. Për këtë vlerë nuk ka analizë dhe mungojnë të dhënat në lidhje me shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2024. Mosparaqitja e shumës debitorë nga taksat dhe tarifat vendore sjell mos pasqyrimin në mënyrë të plotë të të drejtave të konstatuara në pasqyrat financiare"*
Nga auditimi i të dhënave në lidhje me debitorët progresive u konstatua se teprica e llogarisë *468 "Debitorë të ndryshëm"* është pasqyruar në llogarinë 468 të pasqyrës së pozicionit financiar në vlerën 49,755,029 lekë në fund të vitit 2025. Nga auditimi i dokumentimit të debitorëve progresive dhe dërgimi për kontabilizim i tyre nga Sektori i Tatim Taksave në Drejtorinë e Financës u konstatua se Sektori i Tatim Taksave nuk ka dërguar për kontabilizim vlerën prej 120,190,921 lekë të debitorëve dhe kjo vlerë rezulton e pa kontabilizuar në llogarinë *468 "Debitorë të ndryshëm"* në fund të vitit 2025. Nga ana e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore nuk janë dërguar për kontabilizim në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit vlera prej 120,190,921 lekë dhe nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat e duhura për ndjekjen e procesit te kontabilizimit të vlerës së debitorëve në shumën 120,190,921 lekë. Mos pasqyrimi i vlerës prej 120,190,921 lekë në llogarinë *468 "Debitorë të ndryshëm"* sjell të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Belsh në vlerën 120,190,921 lekë.

Konkluzion: Në tepricën e llog. 468 *"Debitorë të ndryshëm"* prej 49,755,029 lekë në fund të vitit 2025 nuk është përfshirë vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat prej 120,190,921 lekë. Nga ana e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore nuk janë dërguar për kontabilizim në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit vlera prej 120,190,921 lekë dhe nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat e duhura për ndjekjen e procesit të kontabilizimit të vlerës së debitorëve në shumën 120,190,921 lekë . Mos pasqyrimi i vlerës prej 120,190,921 lekë në llogarinë *468 "Debitorë të ndryshëm"* sjell të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Belsh në vlerën 120,190,921 lekë duke mos paraqitur në mënyrë të plotë të drejtat e konstatuara në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* Kap. III, kap. 3. 1, pika 32, pika 3. 2 *"Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve"* paragrafi *"Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve"*
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1. 3, germa *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse.

Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi

Z. A. N. Drejtor i financës dhe Buxhetit
Z. D. P. Përgjegjës Sektori i Tatim Taksave

Për sa më sipër, në lidhje me Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit pas njohjes me Projekt Raportin e Auditimit, nga ana e subjektit të audituar Bashkia Belsh nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit.

III.2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

Në zbatim të drejtimit nr. 3 të auditimit nr. 377/1 prot., datë 09.04.2026*"Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025; - Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit; - Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare; - Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar. "* të programit të auditimit u shqyrtuar dokumentacioni si më poshtë:
Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2025;
Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025;
Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2025;
Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2025;
Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2025;
Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2025;
Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2025;
Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2025.

III.2.3.1 Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018. "*
Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.
Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.
Për periudhën objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar për miratim në Degën e Thesarit Elbasan.
U konstatua se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarë të mbajtur në programin excel, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me

situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Bashkia Belsh, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.
Pasqyrat Financiare janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.
Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

Për vitin 2025 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Bashkisë Belsh pranë Degës së Thesarit Elbasan me shkresën nr. 354 Prot., datë 31.03.2026.
Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse drejtat dhe detyrimet janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimin me pasqyrat e tjera financiare.

Në kuadër të standarteve të raportimit financiar (SNK1) objektivi i pasqyrave për qëllime të përgjithshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar. Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).

III.2.3.2 Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare

Në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V *"Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore"*, i ndryshuar. Pasqyrat Financiare kanë për qëllim që të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, të sigurojnë informacion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.
Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare, në rradhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë apo institucionin raportues, nëpërmjet sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave monetare, lidhur me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë.
Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Belsh u konstatua se:
Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:
Për vitin 2025

a- Të drejtat (Aktivet) 3,597,890,674 lekë
b- Detyrimet (Pasivet) 138,410,706 lekë
c- Fondet Neto (Aktivet neto) 3,459,479,968 lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto 3,459,479,968 lekë

Të Drejtat

Të Drejtat, më datë 31 dhjetor të periudhës së auditimit pasqyrohen dhe përbëhen nga aktivet afatshkurtra në shumën 246,344,735 lekë dhe nga aktivet afatgjata në shumën 3,351,545,939 lekë dhe pasqyrohen në tabelën nr. 3/1 në aneks:

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2024 Aktivet e afatshkurtra kanë zënë 6 % të totalit të Të Drejtave në vlerë 217,450,619 lekë ndërsa Aktivet afatgjata kanë zënë 94% të totalit, në vlerë 3,459,239,345 lekë.
Gjatë vitit 2025 ky raport ka ndryshuar pak, më konkretisht aktivet e afatshkurtra kanë zënë 7% të totalit të Të Drejtave në vlerë 246,344,735 lekë ndërsa aktivet afatgjata kanë zënë 93% të totalit, në vlerë 3,351,545,939 lekë.
Ndryshimi në Aktivet afatshkurtra gjatë vitit 2025 është në rritje në vlerë me 28,894,116 lekë, në raport me peshën specifike të totalit të Të Drejtave është gjithashtu në rritje me 1%. Ndërsa ndryshimi në Aktivet afatgjata gjatë vitit 2025 ka ardhur në rënie me 1% sa i përket peshës specifike që zënë aktivet afatgjata në raport me totalin e Të Drejtave gjithashtu pakësuar në vlerë me (107,693,406) lekë si efekt i shtimit të aktiveve afatgjata dhe amortizimit të tyre.

Aktivet afatshkurtra (qarkulluese) AASH
Aktivet Afatshkurtra për vitin 2025 janë mbyllur me tepricë në shumën 3,211,086,823 lekë pasqyrohen në tabelën nr. 3/2 në aneks dhe përbëhen nga shumat e rubrikave që përfaqësojnë:
- Llogaritë e Klasës 5 *"Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"* në shumën 1,862,833,873 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 *"Gjendje inventari qarkullues"* në shumën 82,612,125 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 *"Llogari të arkëtueshme"* në shumën 1,265,640,825 lekë;

Likuiditetet përfaqësojnë para dhe vlera të ngjashme me to, përfaqësojnë çdo vlerë tjetër që për shkak të natyrës shndërrohet shpejt ose menjëherë në para.

Klasa 5 ***"Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre",*** përbëhet nga:
Gjendja e llogarive të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre sipas pasqyrës së pozicionit financiar të periudhës objekt auditimi në fund të vitit ushtrimor mbyllet me tepricë në vlerë 119,249,782 lekë. Kjo tepricë rakordon me rubrikën VI *"Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor"* të pasqyrës së fluksit monetar, kjo shumë përbëhet nga mjete monetare në arkë në shumën 2,960,000 lekë, mjete monetare në bankë në shumën 117,384 lekë si dhe Disponibilitete në thesar në shumën 116,172,398 lekë
Gjendja e llogarisë 520 "*"Disponibilitete në Thesar*" sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare pasqyrohet në vlerën 116,172,398 lekë.
Sipas dokumentacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rakordimi me degën e thesarit lidhur me llogarinë nr. 520 *"Disponibilitete në Thesar"* dhe llogarinë nr. 466 *"Mjete në ruajtje"* pasqyrohet në shumën 97,574,763 lekë. Nga auditimi u konstatua diferencë në shumën 18,597,635 lekë mes tepricës së llogarisë 520 "*Disponibilitete në Thesar*" në pasqyrat financiare (116,172,398 lekë) dhe tepricës së mjeteve monetare sipas degës së thesarit (97,574,763 lekë). Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 50 *"Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)"*. Pika 37 *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë cash, me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e*

periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët. "

Llogaria nr. 520 *"Disponibilitete në Thesar"*, në pasqyrat financiare objekt auditimi paraqitet në mënyrë analitike në tabelën nr. 3/3 në aneks:

Llogaritë e Klasës 3,
Aktivet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor.
Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Belsh në 31.12.2025, teprica e kësaj klase mbyllet në shumën 82,612,125 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël *31 "Materiale"* në shumën 7,720,849 lekë dhe llogaria *32 "Inventar i imët"* në shumën 74,891,276 lekë të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 3/4 në aneks
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjet e inventarit, konkretisht për vitin 2025-2024 ndryshimi është në shumën 10,738,447 lekë e cila përfaqëson shtesë të inventarit gjatë vitit ushtrimor dhe që kuadron me llogarinë 63 *"Ndryshimi gjendjes së inventarit"* në shumën 10,738,447 lekë në pasqyrën e performancës financiare.
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 *"Ndryshimi i gjendjeve të inventarit"* dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjeve të inventarit"*.

Llogaritë Klasës 4
Llogari të arkëtueshme përbëhet nga llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* në shumën 49,755,029 lekë, llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në shumën 40,130,013 lekë dhe llogaria 4342 "*Operacione me shtetin*" në shumën 13,377,076 lekë pasqyrohen në tabelën nr. 3/5.
- Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin(Të drejta)"* mbyllet me tepricë në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 13,377,076 lekë. Kjo tepricë përfaqëson detyrimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP si dhe detyrime të tjera. Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (Të drejta)"* ka si kundërparti llogaritë e detyrimeve 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467. Llogaritë kundërparti të llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin(Të drejta)"*. Në llogarinë 4342 janë përfshirë vetëm detyrimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP ne shumën 13,377,076. **U konstatua** se mosllogaritja e detyrimeve të tjera siç janë furnitorët për transaksionet e vitit kontabël në shumën 27,043,842 lekë është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 59 *"Në rastin e një të drejte të njësisë ndaj shtetit, regjistrimi në kontabilitet bëhet me artikullin kontabël si më poshtë: Debitohet llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"; dhe Kreditohet llogaria 7206 "Financimi i pritshëm nga buxheti". Ky rast përbën një detyrim të shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme. Për këtë arsye, ky detyrim duhet të jetë real dhe të përfaqësojë vetëm atë pjesë të konstatuar si shpenzim në vitin që raportohet, duke qenë gjithmonë brenda fondit (grantit nga buxheti) të parealizuar të vitit ushtrimor raportues. Në asnjë rast, njësia e qeverisjes së përgjithshme nuk duhet të raportojë në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, si detyrim të shtetit ndaj saj, shuma për të cilat ajo ka kryer prokurime, shpenzime apo investime, pa patur më parë fonde të siguruara nga granti buxhetor, donatorë të tjerë apo nga burimet e veta. "*
Nga auditimi u konstatua se llogaria 4342 *"Operacione me shtetin(Të drejta)"* kuadron me llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* në Pasqyrën e Performancës Financiare.

- Llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* përfaqëson detyrimet që kanë të tretët ndaj Bashkisë Belsh e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepricë në shumën 49,755,029 lekë. Kjo shumë e përfaqëson vetëm detyrimet e lëna nga auditimet e KLSH dhe nga APP

Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Tatim Taksave detyrimet në total deri në 31.12.2025 janë raportuar në shumën 120,190,921 lekë të detajuara sipas tabelën nr. 3/6 :
U konstatua se detyrimi 120,190,921 lekë nuk është i kontabilizuar në pasqyrat financiare të Bashkisë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar.

- Të tjera aktive afatshkurtra përbëhen nga llogaria 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"*. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p. sh. qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë dhe të tjera.
Në pasqyrën e pozicionit financiar kjo llogari mbyllet me tepricë në shumën 40,130,013 lekë dhe përfaqëson detyrime të Bashkisë për investime në shumën 40,130,013 lekë. Këto detyrime datojnë që nga viti 2012 detyrime në shumën 5,625,187 lekë, detyrime të vitit 2019 në shumën 1,088,930 lekë, detyrime të vitit 2020 në shumën 8,546,160 lekë, detyrime të vitit 2023 në shumën 100,000 lekë si dhe detyrime të vitit 2025 në shumën 24,769,736 lekë.
U konstatua se transaksionet e kontabilizuara në këtë llogari në shumën 40,130,013 lekë janë keq klasifikuar. Keq klasifikimi i transaksioneve për investime në shumën 40,130,013 lekë sipas periudhave kontabël nuk I janë shtuar llogarisë së aktiveve afatgjata duke I përjashtuar nga amortizimi dhe duke mos paraqitur vlerën e saktë të aktiveve afatgjata gjatë periudhave kontabël.
Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është paraqitje jo e drejtë e pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5.

1. 1. b Aktivet Afatgjata
AAGJ përbëhen vetëm nga aktivet afatgjata jomateriale në shumën 32,125,734, aktivet afatgjata materiale në shumën 3,267,914,502 lekë si dhe Investimet në shumën 51,505,703 sipas tabelës 3/7:

Aktivet afatgjata jomateriale përbëhet nga:
a- Llogaria 202 *"Studime dhe kërkime"* e cila mbyllet me tepricë në shumën 32,125,734 lekë në fund të vitit 2025 ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 22,632,036 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 202 ka pasur lëvizje të llogarisë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8 në aneks.

Norma e aplikuar nga subjekti në masën 10% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: *"Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:... Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%..... ;"*.
Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së saktë të amortizimit përllogaritet në shumën 26,874,586 lekë si mbivlerësim i pozicionit financiar. Ky mbivlerësim jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar

Aktivet afatgjata materiale pasqyrohen në tabelën nr. 3/8 në aneks përbëhen nga:
a- Llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* mbyllet me tepricë në shumën 5,263,276 lekë.

b- Llogaria 211 *"Pyje, Kullota Plantacione"* mbyllet me tepricë në shumën 4,622,160 lekë.
c- Llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* mbyllet me tepricë në shumën 580,893,427 lekë.
d- Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* mbyllet me tepricë në shumën 2,596,804,116 lekë.
e- Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje"* mbyllet me tepricë në shumën 49,815,215 lekë.
f- Llogaria 215 *"Mjete transporti"* mbyllet me tepricë në shumën 8,293,408 lekë.
g- Llogaria 218 *"Inventar ekonomik"* mbyllet me tepricë në shumën 22,222,899 lekë.

Llogaritë përbërëse të AAM analizohen si më poshtë:
-Llogaria 210 *"Toka, troje, Terrene"*, në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 5,263,276 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 llogaria 210 nuk ka ndryshuar.
-Llogaria 211 *"Pyje, kullota plantacione"*, në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 4,622,160 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 11,065,960 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 211 ka pasur ndryshime, është shtuar me 778,800 lekë dhe është pakësuar me 7,222,600 lekë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8:
-Llogaria 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"*, në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 580,893,427 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 608,319,115 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 212 ka pasur ndryshime, është shtuar me 2,990,267 lekë dhe është pakësuar/riklasifikuar me 30,415,956 lekë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8:
-Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 2,596,804,116 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 2,650,336,447 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 213 ka pasur ndryshime, është shtuar me 78,984,491 lekë dhe është pakësuar/riklasifikuar me 132,516,822 lekë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8:
-Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*, në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 49,815,215 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 44,384,732 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 214 ka pasur ndryshime, është shtuar me 8,560,017 lekë dhe është pakësuar/riklasifikuar me 3,129,534 lekë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8:
U konstatua se metoda e llogaritjes së amortizimit është me *"Vlerë të mbetur"* dhe me normë amortizimi 3%.
-Llogaria 215 *"Mjete transporti"*, në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 8,293,408 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 12,356,423 lekë. Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 215 ka pasur ndryshime, është shtuar me 11,500,800 lekë dhe është pakësuar/riklasifikuar me 15,563,815 lekë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8:
Nga auditimi u konstatua se norma e amortizimit te aplikuar është 10%, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: *"Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi..... ;"*.
Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së amortizimit klasifikohet si mbivlerësim i pozicionit financiar. Ky mbivlerësim jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar.

-Llogaria 218 *"Inventar ekonomik"* në fund të vitit 2025 pasqyrohet në vlerën neto 22,222,899 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 25,028,679 lekë. Nga auditimi i pasqyrës

"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" të vitit 2025 u konstatua se në llogarinë 218 ka pasur ndryshime, është shtuar me 2,678,400 lekë dhe është pakësuar/riklasifikuar me 5,484,179 lekë, kartela e llogarisë paraqitet në tabelën 3/8:
U konstatua se metoda e llogaritjes së amortizimit është me *"Vlerë të mbetur"* dhe me normë amortizimi 4%.
Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: *"Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi..... ;"*.
Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së amortizimit klasifikohet si mbivlerësim i pozicionit financiar. Ky mbivlerësim jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar.
Si rezultat i aplikimit të pasaktë të normave të amortizimit mbi aktivet afatgjata të Bashkisë efekti përllogaritet në shumën 16,324,104 lekë si mbivlerësim i pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, si dhe në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*. Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi hartuesi i pasqyrave financiare.

Investimet
Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësite e qeverisjes së përgjithshme, duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 "Investime", pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar.
Investimet përbëhen nga llogaria 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* në shumën 51,505,703. 00 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo llogari si kundërparti të saj ka llogaritë 105 dhe 106 dhe 115 të fondit të konsoliduar. Nga auditimi u konstatua se llogaria 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme në fondin e konsoliduar pasqyrohet në shumën 16,520,932 lekë, si dhe llogaria 115 "Nga fondet e veta të investimeve"* në fondin e konsoliduar pasqyrohet në shumën 34,984,771 lekë.
Investimet në proces pasqyrohen në tabelën 3/9

Detyrimet
Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Belsh në datën 31 dhjetor të periudhës kontabël kundrejt, punonjësve për paga, organeve tatimore për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kreditorëve për mjetet në ruajtje të cilat janë fondet e ngurtësuara lidhur me garancitë e kontratave mes subjekteve dhe Bashkisë si dhe të ardhurave për t'u regjistruar në vitet pasardhëse.
Detyrimet në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore pasqyrohen në shumën 137,852,706 lekë përbëhen vetëm nga detyrimet afatshkurtra dhe paraqiten në tabelën 3/10:
- Llogaria 401-408, *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"* përfaqëson shumën e detyrimeve që institucioni ka ndaj ofruesve të shërbimeve ose mallrave në shumën 42,464,119 lekë sipas tabelës 3/11:
Nga auditimi i furnitorëve u konstatua se detyrimet e Bashkisë ndaj furnitorë janë detyrime kryesish të muajit dhjetor 2025.
- Llogaria 42, *"Detyrime ndaj personelit"* e cila përfaqëson shumën e pagave neto të personelit të muajit dhjetor në shumën 6,676l769 lekë për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. U

konstatua se për periudhën e auditimit detyrimi për pagat neto rakordon me vlerat sipas listë pagesave E-sig025,
- Llogaria 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"* përfaqëson tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025, në shumën 1,074,283 lekë. Kjo tepricë në mbyllje të vitit ushtrimor rakordon me listë pagesën e deklaruar në organet tatimore.
- Llogaria 435, *"Sigurime shoqërore"* dhe llogaria 436 *"Sigurime shëndetësore"* përfaqësojnë vlerën e kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor për vitin 2025. Këto detyrime në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen përkatësisht në vlerat 1,981,703 dhe në vlerën 326,935 lekë. Këto teprica në mbyllje të vitit ushtrimor rakordojnë me detyrimet sipas listë pagesës së deklaruar në organet tatimore në sistemin C@ts.
- Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t'u kthehen nga kjo llogari të tretëve. Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2025 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël 35,148,588 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave për mallra dhe shërbime të cilat do tu kthehen të tretëve sipas kushteve të kontratave.
- Llogaria 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* përfaqëson detyrimet afatshkurtra të Bashkisë në shumën 983,280 lekë. Kjo llogari kreditohet për konstatimin e detyrimeve të tjera për t'u paguar, të cilat nuk rezultojnë nga marrëdhëniet tregtare, me kundërparti debitimin e llogarive përkatëse të shpenzimeve.

Fondet Neto

Nga auditimi u konstatua se Aktivet neto plotësojnë rregullin Të Drejta – Detyrime = Fondi i Konsoliduar. Fondi i Konsoliduar përbëhet nga llog 101 *"Fondi i akumuluar"* i cili për vitin 2025 mbyllet me tepricë 3,326,950,456 lekë, llogaria 85 *"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"* që përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor 2025 në shumën 74,970,795 lekë, llog 115 *"Nga Fondet e veta te investimeve"* në shumën 34,984,771 lekë e cila përfaqëson burimet e financimit të investimeve në proces nga fondet e Bashkisë, llog 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"* në shumën 16,520,932 lekë e cila përfaqëson burimet e financimit të investimeve në proces nga fondet e buxhetore të pasqyruara në tabelën 3/12:
Nga auditimi u konstatua se Fondi i Konsoliduar i cili është rezultat i llogarive sintetike të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto kuadron me Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto vetëm për totalin dhe jo për secilën llogari përbërëse të Fondit të Konsoliduar.
Nga auditimi u konstatua se totali i fondit të konsoliduar nuk është përcaktuar saktë marrë në përllogaritje çeljen në datën 31.12.2024 shtuar me totalin e shtesave të aktiveve pakësuar me kreditimet e klasës 2 u konstatua një diferencë në shumën 2,710,437 lekë më pak se vlera e pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar.

Pasqyra e Performancës

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.
Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se, konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.
Totali i të *"Ardhurave"* në Pasqyrën e Performancës Financiare është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2025 pasqyra paraqitet si më poshtë:

a- Të ardhurat (grupi A) = 662,551,607 lekë
b- Shpenzimet (grupi B) = 587,580,812 lekë
c- Rezultati i ushtrimit (llog. 85) = 74,970,795 lekë

Llogaria 85 *"Teprica ose deficiti i periudhës"* në Pasqyrën e Pozicionit Financiar rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 *"Pasqyra e Performancës Financiare"*.
Ndryshimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 në Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2024 me 31.12.2025, përkatësisht 34,571,281 minus 23,832,835 lekë u konstatua 10,738,447 lekë. Kjo vlerë u konstatua e barabartë me tepricën e llogarisë 63 *"Ndryshim i gjendjeve të inventarit"* në Pasqyrën nr. 2, *"Pasqyra performancës financiare"*.

Të ardhurat
Në kuptim të SKK1 Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e detyrimeve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike.
Të ardhurat janë flukse hyrëse parash dhe përfaqësojnë rritjet e përfitimeve ekonomike bruto gjatë ushtrimit kontabël (periudhës së raportimit). Burim kryesor për të ardhurat në sektorin publik janë nga aktiviteti buxhetor, mallrat e shërbimet (veçori për sektorin publik). Gjithashtu, burime të tjera janë interesat, dividendët, grantet. Të ardhurat rrisin përfitimet ekonomike në formën e rritjes së aktiveve dhe pakësimit të pasiveve (detyrimeve), të cilat kanë për rezultat shtimin e fondeve të veta.
Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se të ardhurat e realizuara gjatë vitit janë rezultat i të ardhurave nga taksat dhe tatimet në shumën 52,327,881lekë, të ardhurave jotatimore në shumën 16,560,702 lekë dhe granteve korrente në shumën 593,579,358 lekë, sipas të dhënave të tabela 3/13:
- Të ardhurat nga taksat dhe tatimet në shumën 52,327,881 lekë janë rezultat i të ardhurave të krijuara nga ana e Bashkisë Belsh nga tatimi mbi biznesin e vogël në shumën 146,845 lekë, tatimit mbi pasurinë në shumën 28,775,607 lekë si dhe tatimeve mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit në shumën 23,367,179 lekë.
- Të ardhurat jotatimore në shumën 16,560,702 lekë përbëhen nga të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia në shumën 908,848 lekë, të ardhura nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare në shumën 15,586,312 lekë.
- Grantet korrente përbëhen nga financimet nga buxheti konkretisht nga:
- Llogaria 7200 *"Nga buxheti për NJQP (Qendrore)"* përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 273,631,265 lekë.
- Llogaria 7201 *"Nga buxheti për NJQP (Vendore)"* përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 294,607,007lekë.
- Llogaria 7204 *"Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale"* në shumën 11,964,010 lekë.
- Llogaria 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* në shumën 13,377,076 lekë. Kjo shumë nuk rakordon me detyrimet afatshkurtra të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit objekt auditimi.

Bashkia Belsh ka gjatë vitit 2025 ka realizuar të ardhura nga grantet e buxhetit si dhe të ardhura të veta sipas transfertave buxhetore të mëposhtme:
- Nga transferta e pakushtëzuar në shumën 307,153,531 lekë
- Nga transferta e kushtëzuar në shumën 307,565,564 lekë
- Nga të ardhurat e veta në shumën 80,814,343 lekë
Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua se Të ardhurat e shfrytëzimit sipas kësaj pasqyre nuk rakordojnë me të ardhurat e shfrytëzimit sipas transfertave të fondeve buxhetore dhe të veta.
Nga auditimi u konstatua se të ardhurat vjetore nuk janë kontabilizuar saktë sepse të ardhurat e realizuara dhe të rakorduara me degën e thesarit për vitin 2025 sipas pasqyrës së transfertave buxhetore së bashku me të ardhurat e veta janë në shumën 695,533,438 ndërsa sipas pasqyrës së performancës duke përjashtuar financimin e pritshëm nga buxheti janë në shumën 649,174,531 lekë shtuar me akordimet nga fondet buxhetore për investime në shumën 40,877,411 lekë, u konstatua mos rakordim në shumën 5,481,496 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 21.02.2021 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe*

Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar pika 3. *"Ndërkohë, në lidhje me njohjen e të ardhurave në librat e tyre të brendshëm kontabël, të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë raportimit të tyre financiar do të përdorin metodën mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në kuadër të rritjes së transparencës dhe besueshmërisë së informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare"*.
Nga auditimi i fondeve të të ardhurave të dhënat vjetore për Bashkinë Belsh pasqyrohen në tabelën 3/14:

1. 2. b Shpenzimet
Shpenzimet përfaqësojnë pakësim të përfitimeve ekonomike gjatë ushtrimit kontabël, në formën e daljes apo të pakësimit të vlerave të aktiveve apo rritjen e detyrimeve. Shpenzimet janë flukse dalëse gjatë periudhës raportuese, që kanë për rezultat zvogëlimin e kapitaleve të veta (fondeve), përfaqësojnë investimin që kryen njësia e qeverisjes së përgjithshme për realizimin e synimeve të tij të funksionimit gjatë një viti ushtrimor. Ato njihen në të njëjtën periudhë ushtrimore. Shpenzimet e raportuara pasqyrohen në tabelën 3/15:

Llogaria 600 *"Pagat dhe përfitimet e punonjësve"* në shumën 98,094,254 lekë përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.
Llogaria 601 *"Kontribute të Sigurimeve"* në shumën 15,917,724 lekë përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.
Llogaria 602 *"Blerje mallra e shërbime"* në shumën 64,507,412 lekë përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve. Nga auditimi i llogarisë 602 u konstatua se nuk janë konstatuar saktë shpenzimet për mallra dhe shërbime, tepricë e cila ndikon rezultatin e periudhës kontabël, konkretisht nuk janë konstatuar shpenzime në shumën 17,576,589 lekë përllogaritur nga shpenzimet faktike nga totali i urdhër shpenzimeve për këtë kategori pakësuar me tepricën në çelje të periudhës kontabël të detyrimeve afatshkurtra dhe shtuar me tepricën në mbyllje të detyrimeve afatshkurtra. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Aneksi 1, "Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8).
Efekti në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos pasqyrimit të saktë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të shpenzimeve të periudhës për njësinë.
Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025 shpenzimet për mallra dhe shërbime janë klasifikuar sipas nën llogarive të klasës 602. Konkretisht shpenzimet për *"Materiale zyre e të përgjithshme"* pasqyrohen në shumën 4,296,760 lekë, shpenzimet për *"Materiale dhe shërbime speciale"* pasqyrohen në shumën 13,629,787 lekë, shpenzimet për *"Shërbime nga të tretë"* pasqyrohen në shumën 97,863,937 lekë, shpenzimet për *"Shpenzime transporti"* pasqyrohen në shumën 25,853,272 lekë, shpenzimet për *"Shpenzime për qiramarrje"* pasqyrohen në shumën 9,783,749 lekë, shpenzimet për *"Shpenzime për qiramarrje"* pasqyrohen në shumën 540,340 lekë, shpenzimet për *"Shpenzime për detyrime për kompensime legale"* pasqyrohen në shumën 11,092,081 lekë, shpenzimet për *"Shpenzime te tjera operative"* pasqyrohen në shumën 22,107,687 lekë.
Llogaria 604 *"Transferime korrente të brendshme"* në shumën 142,418,415 lekë përfaqëson transferimet të fondeve.
Llogaria 6061 *"Transferta të paguara nga Inst. Tjera e Org. Pusht. Vendor"* në shumën prej 264,879,023 lekë përfaqëson pagesa për qira për të pastrehët, pagesa për ndihmën ekonomike, pagesa për paaftësi dhe invaliditetin, pagesa për ndihmën ekonomike, pagesa për të prekurit nga tërmeti.

Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruar drejtë në shumën prej 10,738,447 lekë.

Në seksionin *“Shpenzime të tjera”* të cilat përfaqësojnë operacionet e korrigjimit të rezultatit dhe duhet të evidentohen në pasqyrën e shpenzimeve të funksionimit pasqyrohen teprica transaksionesh si më poshtë.
Llogaria 831 *“Caktim të ardhura të funksionit për investime”* në shumën 1,660,192 lekë, llogaria 8420 *“Derdhje të ardhura ne buxhet”* në shumën 65,542 lekë, llogaria 8421 *“Derdhje buxhet të ardhurave pa përdorur”* në shumën 38,250 lekë si dhe llogaria 8423 *“Transferime për ndryshim gjendje te inventarit (llog 63)”* në shumën (-10,738,446) lekë
Në *“Shpenzime të tjera”* në operacionet e korrigjimit të rezultatit në llogarinë 831 *“Caktim të ardhura të funksionit për investime”* kontabilizohen vetëm pjesa e investimeve e financuar nga Të ardhurat e veta që në rastin e subjektit është në shumën 8,253,774 lekë. U konstatua se diferenca në shumën 6,593,582 lekë që nuk është pasqyruar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar, Aneksi 1, "Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8). Efekti në pasqyrën e performancës financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë, të drejtë dhe të saktë të llogarive kontabël ndikon drejtpërdrejtë në rezultatin e periudhës, rezultat i cili ndikon në pozicionin financiar duke na dhënë një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *“Paraqitja e Pasqyrave Financiare”*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *“Paraqitja e Pasqyrave Financiare”*. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar pika 5

Pasqyra e flukseve monetare (cash flow)
Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme.
Nga auditimi i pjesës së parë të pasqyrës së flukseve monetare për periudhën objekt auditimi *“Veprimtaritë e shfrytëzimit”* fondet buxhetore për shpenzime korrente pasqyrohen në shumën 584,429,250 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve totali i fondeve për shpenzime të shfrytëzimit pasqyrohen në shumën 553,805,198 lekë, u konstatua një mosrakordim në shumën 30,624,053 lekë.
Arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor pasqyrohen në shumën 71,115,627 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve pasqyrohen në shumën 80,814,343 lekë, u konstatua mosrakordim në shumën 9,029,060 lekë.
Nga auditimi i Veprimtarive të investimeve u konstatua se *“Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)”* pasqyrohen në shumën 40,877,411 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve totali i fondeve të akorduara për shpenzime kapitale është 60,913,897 lekë, u konstatua mosrakordim në shumën 20,036,486 lekë.
Nga auditimi i pjesës së tretë *“Transferta e të tjera”* u konstatuan pakësim mjete monetare si transferime në buxhet të fondeve të papërdorura në shumën 3,328,388 lekë si dhe derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet në shumën 103,792 lekë, si lëvizje të brendshme në shumën 116,237,762 lekë
Me degën e thesarit është bërë rakordimi i tepricës së fund vitit për disponibilitetet në thesar në shumën 119,249,782 lekë por diferencat e konstatuara më sipër nuk japin në mënyrë të saktë lëvizjet e mjeteve monetare të Bashkisë gjatë vitit 2025. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me

Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1.
Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos rakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të fluksit monetar të subjektit.
Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *"Paraqitja E Pasqyrave Financiare"*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *"Paraqitja E Pasqyrave Financiare"*. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto
Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor të mbyllur raportues.
Nga auditimi i *"Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto"* u konstatua se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë me fondet neto në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C, tepricat e llogarive në fund të periudhës ushtrimore pasqyrohen në tabelën 3/16:
Nga auditimi u konstatua se totali fondeve neto në të dy pasqyrat rakordon edhe tepricat e llogarive të cilat ndikojnë dhe përbëjnë seksionin e tretë të pasqyrës së pozicionit financiar të cilat rrjedhin nga pasqyra e ndryshimeve në fondet neto rakordojnë dhe nuk u konstatuan diferenca mes së njëjtës llogari në të dyja pasqyrat duke bërë që të arrijmë në konkluzionin se tepricat e pasqyruara na japin një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2025.

Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit
Nga auditimi i pasqyrës se investimeve dhe burimeve të investimeve u konstatua se kjo pasqyrë statistikore është e plotësuar në mënyrë të saktë, në mënyrë që të japë një pasqyrim të plotë të të gjitha transaksioneve që kanë ndodhur gjatë vitit lidhur me burimet e financimit dhe investimet.
Të dhënat e pasqyrës së Investimeve dhe Burimeve të Financimit raportuar nga subjekti në pasqyrat financiare pasqyrohen në tabelën 3/17:

Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata
Nga auditimi i pasqyrës *"Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata"* pasqyruar në tabelën 3/18 u konstatua se për amortizimet vjetore nuk janë aplikuar normat e duhura të amortizimit sipas klasave të aktiveve. Nga përllogaritjet e amortizimeve sipas klasave të aktiveve referuar normave të parashikuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nga grupi i auditimit u konstatua mbivlerësim i vlerës neto të aktiveve në shumën 16,324,104 lekë. Ky mbivlerësim ndikon totalin e Fondit Neto.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar, pika 36.

III.2.3.3 Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:
Nga auditimi u konstatua se Bashkinë Belsh ka të dhëna mbi vlerën kontabël të aktiveve në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, neni 26 ku citohet: *"Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur.. "*

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyre i aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustifikuara, është audituar periudha 2025.
Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të paragrafit nr. 74 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar që sanksionin se: *"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës"*
Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzonit te Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik".
Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konforrn pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik". U konstatua se regjistri i aktiveve nuk është i hartuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar,

<u>Inventarizimi i vitit 2025</u>

Me Urdhrin nr. 439 dt. 20.10.2025 nr. prot 3627 datë 20.10.2025 të Kryetarit është urdhëruar kryerja e inventarizimit të aktiveve afatgjata për Bashkinë.
Në vijim me Urdhrin nr. 440 dt. 20.10.2025 nr. prot 3628 datë 20.10.2025 të Kryetarit është ngritur komisioni i inventarizimit i përberë nga E. Z., Dh. I., R. K., R. U. dhe F. B.
Mbështetur mbi Urdhrin e mësipërm është bërë inventarizimi i aseteve të Bashkisë Belsh
Nga auditimi i komisioneve të ngritura u konstatua se në komisionin e inventarizimit merr pjesë në cilësinë e anëtarit të komisioni një punonjës nga Drejtoria e Financës. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MF, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se *"Komisioni nuk duhet të ketë më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi... "* si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 22 *"veprimtaria e kontrollit"* pika 3. b *"ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin"*.
Janë hartuar kartelat e inventarit dhe janë firmosur nga personat përgjegjës dhe komisioni i inventarizimit.
Komisioni i inventarizimit nuk ka hartuar relacion dhe procesverbal mbi procesin e inventarizimit.
U konstatua se nuk është ngritur Urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të aktiveve të vlerësuara si jashtë përdorimi nga komisioni i Inventarizimit

Për sa më sipër, në lidhje me Auditimin e llogarive vjetore për vitin 2025, pas njohjes me Projekt Raportin e Auditimit, nga ana e subjektit të audituar Bashkia Belsh nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit.

III.2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në zbatim të pikës **4** të programit të auditimit: ***"Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm".***

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.
3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në:

I. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998", nenet 162-165 i ndryshuar
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC

II. Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".
-Neni 31 - Raportimi në Kuvend ku parashikohet se**:**
1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:
a) raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
c) informacion për rezultatet e auditimeve sa herë që kërkohet nga Kuvendi;
ç) raporte përfundimtare të auditimit kur çmohet e nevojshme nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit apo kur kërkohen nga Kuvendi.
2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund t'i kërkojë Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, apo ndonjë komisioni tjetër të Kuvendit, që të dëgjohet dhe të raportojë, për çështje që ai i çmon si të rëndësishme në funksion të veprimtarisë së tij.
3. Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi aktivitetet e tij brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

III. Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
-Neni 15, Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së ku parashikohet se**:** Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:
a) të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo institucioneve më të larta për shkeljet e akteve normative, me pasojë dëme materiale, dhe t'u rekomandojë atyre korrigjimin /rregullimin / ndryshimin e akteve ligjore;
b) të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo organet e kompetencës mbi parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve publike dhe t'u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të dëmshpërblehet në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji;
c) t'u rekomandojë drejtuesve të njësive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative;

j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;
k) t'u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

IV. Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
-Neni 30 -Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, ku parashikohet se**:** Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

*V. Rregulloret e Brendshme të KLSH dhe udhëzimi i Kryetarit të KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH***.**
1. Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015;
2. Rregullorja e Brendshme *"Mbi Procedurat e auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit"*, miratuar me vendimin të kryetarit të KLSH -së nr. 107, datë 08.08.2017;
3. ***"Manual*** *për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional"*, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 67, datë 23.06.2020.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, u auditua dokumentacioni si më poshtë:
- Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, 404/13 prot., datë 21.10.2025.
- Korrespondenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Belsh dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga strukturat e Bashkisë dhe raportimet në Këshill Bashkiak për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:
Në mos zbatim të nenit 15, germa *"j"*, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Bashkia Belsh ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 3940 prot., datë 10.11.2025, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka dalë me shkresën nr. 3940 prot, datë 10.11.2025.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:
Referuar shkresës nr. 3940 prot, datë 10.11.2025, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30, pika 2, *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna"*. Sipas verifikimit Bashkia Belsh nuk ka kthyer përgjigje, por nga KLSH gjithashtu është programuar auditim financiar

në Bashkin**ë** Belsh në datë 09.04.2026, ku përfshihet si drejtim auditimi zbatimi i rekomandimeve, datë e cila është brenda periudhës 6-mujore të kthimit të përgjigjes.

III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak _Belsh, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Belsh ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr. 3940 prot, datë 10.11.2025, por nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 50, pika 5, ku përcaktohet që*: "Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audituesë të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë".*

IV. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Belsh administruar në KLSH me nr. 404/13 prot., datë 21.10.2025, janë rekomanduar gjithsej:

- 29 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 5 masa shpërblim dëmi pranuar nga subjekti;
- 3 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike, pranuar nga subjekti
- 1 masa për uljen e borxhit tatimor, për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), pranuar nga subjekti
- 12 masa disiplinore për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil, pranuar nga subjekti
- 4 masa disiplinore për punonjësit e larguar, pranuar nga subjekti

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Nuk ka shkresë nga Bashkia Belsh për refuzimin e rekomandimeve, rrjedhimisht statusi i rekomandimeve është *"i pranuar"* t**ë** cilat paraqiten si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	29	29	0
Masa të ardhura të munguara	1	1	0
Masa p**ë**r eliminimin e efekteve negative n**ë** menaxhimin e t**ë** ardhurave	3	3	0
Masa shpërblim dëmi	5	5	0
Masa disiplinore	16	16	0
Totali	**54**	**54**	**0**

VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Bashkisë Belsh:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	**29**			25	4
Masa të ardhura të munguara	1			1	
Masa p**ë**r eliminimin e efekteve negative n**ë** menaxhimin e t**ë** ardhurave	**3**				3
Masa disiplinore	**16**			16	
Masa shpërblim demi	**5**			5	
Totali	**54**			**47**	**7**
Totali në %	**100%**	**0%**	**0%**	**87%**	**13%**

5. Mbi nivelin e zbatimin të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Belsh

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Belsh 54 masa, të cilat janë pranuar plotësisht.

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. 1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Belsh të marrin masa, për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit, përditësimin e Rregullores së Bashkisë, ku të përfshihen të gjitha strukturat dhe organet e institucionit, si dhe hartimin dhe miratimin e Kodit të Etikës për këtë institucion. Të hartohet dhe miratohet Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, regjistri i riskut, planet e punës për çdo sektor dhe drejtori, si dhe strategjia e menaxhimit të riskut. Të dokumentohen me anë të procesverbaleve mbledhjet periodike dhe aktiviteti i Grupi Menaxhimit Strategjik. Gjithashtu Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë dhe miratojë planin vjetor të trajnimit si dhe të realizojë trajnimin e punonjësve për fusha të ndryshme me risk brenda veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 464 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 1. 1.*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

2. 1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me një nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi, për të bërë të mundur auditimin e strukturave të vlerësuara me risk të lartë.

Menjëherë

Rekomandimi: *i pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Kryetari i Bashkisë janë marrë masa për ngritjen e njësisë së Auditit.*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

3. 1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Belsh, nëpërmjet Drejtorisë së Financës të marrin masa që hartimi i PBA dhe buxhetit vjetor të bëhet në bashkëpunim me Ekipi i Menaxhimit të Programeve, të cilët duhet hartojnë dhe të paraqesin kërkesat buxhetore me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Grupi Menaxhimit Strategjik, si dhe kryerjen e konsultimit publik nëpërmjet organizimit të dëgjesave publike me palët e interesit. Pas përgatitjes së PBA në çdo fazë në afatin e miratuar të merren masa që të paraqiten në këshillin bashkiak për miratimin e tij dhe në përfundim të bëhet publikimi i dokumentit të plotë PBA dhe buxhetit vjetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se për zbatimin e rekomandimit 3. 1 janë marrë hapa konkret që do të realizohen me realizimin e fazave të PBA.*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

4. 1. Rekomandimi: Titullari nëpërmjet Drejtorisë së Financës të marrë masa, që të përgatisë raportet e monitorimit të buxhetit të vitit ushtrimor çdo 4-mujor, sipas formateve të miratuara dhe ti paraqesë ato në Ministrinë e Financave dhe në këshillin bashkiak.
4. 2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, që detyrimet e prapambetura ti evidentojë saktë dhe të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme likuidimin e tyre dhe përllogaritjen së saktë të peshës specifike, të stokut të detyrimeve mbi shpenzimet faktike, për të menaxhuar në çdo moment situatën financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës raporti vjetor i monitorimit është hartuar.*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

5. 1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Belsh të marrë masa që në planin vjetor të të ardhurave të Bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga të gjitha taksat/tarifat e parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu të merren masa për të realizuar plotësisht arkëtimin e të ardhurave referuar në planifikimit të tyre

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 465 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 5. 1.*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

6. 1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa që në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave Vendore të marrë masa që të kontabilizojë vlerat debitore nga taksat dhe tarifat vendore, të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* dhe llogaritë e tjera të lidhura me to.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 466 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 6. 1.*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

7. 1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2025 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar në përputhje me parimet kontabël të pranuara.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 7. 1.*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

8. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë inventarin fizik projekteve të studim-projektimeve të blera gjendje e llog. 202 *"Studime dhe Kërkime"*, nëse është e mundur të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre, si vlerë e shtuar sipas llojit të aktivit të kapitalizuar, të përllogarisë amortizimin për to sipas normës dhe metodës së miratuar, duke i kryer veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse dhe të reflektohen edhe në tabelën shoqëruese përkatëse

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 468 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 8. 1.*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

9. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës për vlerat e pa analizuara apo pa emërtime të sakta të rishikojë dokumentacionin financiar të trashëguar dhe të identifikojë aktivet që përfshijnë këto vlera. Gjithashtu të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit

2025, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 9. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

10. 1. Rekomandim: Strukturat drejtuese në Bashkinë Belsh dhe Drejtoria e Financës të marrin masa që të kryejnë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësve të rrjetit shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji në *"Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime, Elbasan"* dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llog. *213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 10. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

11. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që në llogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata të aplikojë normat e amortizimit të miratuara sipas grup aktiveve përkatëse dhe me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025 të bëjë sistemimet e nevojshme për saktësimin e vlerave të aktiveve të llogarive 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* dhe 218 *"Inventar ekonomik"*.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 11. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

12. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël, për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të detyrimeve ndaj të tretëve, në llogaritë përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar, në përputhje me parimet kontabël të pranuara.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 12. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

13. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për të pasqyruar saktë shpenzimet e kryera sipas natyrës mbi bazën e rregullave kontabël të hartimit të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 13. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

14. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor të plotësojë në mënyrë të saktë pasqyrën e flukseve monetare (cash flow), duke kryer

veprime të sakta në kontabilitet, referuar akt rakordimeve me thesarin dhe klasifikimit ekonomik kontabël.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 14. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

15. 1. Rekomandim: Strukturat drejtuese në Bashkinë Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat të menjëhershme për derdhjen në bankë të shumave të pa tërhequra nga qytetarët për shpërblim lindje gjendje në arkë deri në lidhjen e një marrëveshjeje me bankat e nivelit të dytë apo me degën e postës shqiptare në Belsh për kryerjen e pagesave qytetarëve.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 15. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

16. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"*, e cila është mbivlerësuar për vlerën 4,449,380 lekë në fund të vitit 2024.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 16. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

17. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që të kryejë veprime sakta në kontabilitet, në lidhje me investimet në mënyrë që pasqyrat financiare në të gjitha formatet e vlerat e tepricave në të njëjtat llogari apo kundërparti dhe veprimet debi-kredi me to të lidhen me një logjikë kontabël për të shmangur anomalitë apo parregullsitë në klasifikimin ekonomik kontabël dhe keq interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga u konstatua se Kryetari i Bashkisë është ngritur urdhri nr. 467 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit 17. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

18. 1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Belsh, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DT. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik, duke rritur njëkohësisht sigurinë për realizimin e objektit me standarde optimale dhe brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Kryetari i Bashkisë për zbatimin e rekomandimit 18. 1 ka marrë masa për analizimin dhe adresimin e gjetjeve me qëllim përdorimin efektiv të fondeve që prokurohen*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

19. 1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Belsh, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë e mangësive të konstatuara në vlerësimin e ofertave dhe përgjegjësitë në zhvillimin e këtij procesi. Gjithashtu

KVO të marrë masa, që të shmangen parregullsi të tilla, për të përmbushur realizimin e këtij procesi në mënyrë objektive dhe transparente.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Kryetari i Bashkisë për zbatimin e rekomandimit 19. 1 ka marrë masa për analizimin dhe adresimin e gjetjeve me qëllim përdorimin efektiv të fondeve që prokurohen*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

20. 1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Belsh, të analizojë arsyet e anomalive në përllogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësitë e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Kryetari i Bashkisë për zbatimin e rekomandimit 20. 1 ka marrë masa për analizimin dhe adresimin e gjetjeve me qëllim përdorimin efektiv të fondeve që prokurohen*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

21. 1. Rekomandim: Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Belsh, të marrë masa për të plotësuar dosjet e zbatimit me dokumentacionin përkatës të konstatuar në mungesë. Gjithashtu për këto raste dhe në vijimësi, të verifikojnë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit, që do të paraqesin operatorët kontraktues dhe për çdo mungesë, të pezullohet dorëzimi i dosjes përkatëse, deri në plotësimin e saj, duke nxjerrë përgjegjësitë për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Kryetari i Bashkisë për zbatimin e rekomandimit 20. 1 ka marrë masa për analizimin dhe adresimin e gjetjeve me qëllim përdorimin efektiv të fondeve që prokurohen*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

22. 1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Belsh, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Bashkisë, të marrë masa në vijimësi, që për çdo projekt për ndërtimin e objekteve publike, para fillimit të procedurës së prokurimit, të kryhet Oponenca teknike nga institute, apo ente të tjera, të përcaktuara ligjërisht për kryerjen e këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se nuk janë marre masa për zbatimin e rekomandimit nr. 22. 1*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

23. 1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Belsh të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë, në vijimësi të përzgjedhë si pjesë e KVO punonjës, pozicioni i të cilëve të pajtohet me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin referuar përgjegjësive për çdo pozicion pune, për të garantuar mbarëvajtjen e procedurës së prokurimit. Personi përgjegjës për prokurimin të administrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku të përcaktohet me saktësi sasia e mallrave që do të prokurohet dhe të argumentohen sasitë e kërkuara nga drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se nuk janë marre masa për zbatimin e rekomandimit nr. 23. 1*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

24. 1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë, të cilat i

kanë kaluar në administrim, lidhur me gjendjen faktike dhe statusin e tyre, për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron. Gjithashtu të procedohet për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK, për të bërë të mundur minimizimin e riskut të keqpërdorimit të pasurive së institucionit.

Brenda datës 31.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 469 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 24. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

25. 1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Belsh, të marrë të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikata përdorimi:
- Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve, konkretisht: polica e sigurimit e përgjegjësisë profesionale, certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, aktet përkatëse teknike nga OSHEE dhe për menaxhimin e mbetjeve urbane, projektet për mirëmbajtjen e objekteve, etj ;
- Të respektohen afatet për shqyrtimin e aplikimeve dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse për miratimin apo refuzimin e kërkesave të paraqitura;
- Të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj, nga data e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 470 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 25. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

26. 1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Belsh, të marrë të gjitha masat për të kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në çdo rast, që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi. Informacioni i kërkuar nga DV ASHK-të, duhet të konsistojë në vënien në dispozicion nga ky institucion i dokumentacionit që përcakton statusin e pronësisë, apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 470 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 26. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

27. 1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Belsh, të marrë të gjitha masat, që përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të sigurojë respektimin e kushteve urbane për zhvillim, duke verifikuar përputhshmërinë e aplikimit me kondicionet urbane dhe të miratojë vetëm ato aplikime që i respektojnë këto kondicione.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 470 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 27. 1*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

28. 1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për të krijuar një strukturë të IMT-së funksionale, me numër inspektorësh/Kryeinspektor, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të kualifikuar, kryesisht të profilit inxhinieri, për të kryer inspektime me cilësi dhe transparencë, duke siguruar vijueshmëri dhe mbulim të plotë të gjithë territorit të Bashkisë Belsh.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. 2. Rekomandimi: Kryeinspektori dhe inspektorët e IMT-së Bashkia Belsh, të marrin masa të menjëhershme për të administruar dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës. Gjithashtu IMTV të kryejë funksionet e përcaktuara, bazuar në plane mujore e vjetore konkrete, të miratuara nga Titullari i Institucionit, si dhe të hartojë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se nuk janë marre masa për zbatimin e rekomandimit nr. 28. 1 dhe 28. 2*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. 1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **8,797,882. 54 lekë pa tvsh** nga BOE V&G, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3956/12 prot., datë 30.04.2020, me objekt: *"Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjetin shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit faza II"*, Bashkia Belsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 471 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 1. 1. Dërguar njoftimet operatorit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

2. 1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **5,707,878 lekë pa tvsh** nga BOE *"E&T, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 907/7 prot., datë 02. 06. 20, me objekt: "Furnizimi me ujë të pijshëm i Zonës së Dumresë, Bashkia Belsh, (Faza III)"*, Bashkia Belsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 471 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 2. 1. Dërguar njoftimet operatorit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

3. 1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **319,750 lekë pa tvsh** nga BOE *"N"* Sh. p. k & "I", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1847/5 Prot., datë 29.09.2022, me objekt *"Sistemim, Asfaltim i Rrugës Belsh-Stanaj"*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 471 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 3. 1. Dërguar njoftimet operatorit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

4. 1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **791,850, lekë pa tvsh** nga BOE *"N"* Sh. p. k & "I", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2903/12 Prot., datë 01.02.2023, me objekt *"Rikonstruksion i rrugëve Rrasë, Hysgjokaj, Pajalli, Beqiraj, Gradisht(Faza e parë segmenti Rrasë-Pajalli)"*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 471 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 4. 1. Dërguar njoftimet operatorit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

5. 1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **879,900 lekë pa tvsh** nga OE *"V"* SH. P. K, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 644/7 Prot., datë 05.05.2023, me objekt *"Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i rrugëve të brendshme, Bashkia Belsh"*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 471 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 5. 1. Dërguar njoftimet operatorit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. 1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa që në të ardhmen, gjatë zbatimit të punimeve, të mos miratojë ndryshime në projekt preventiv të paargumentuara teknikisht, për zëra pune të cilat nuk janë sipas natyrës së objektit që zbatohet, me qëllim shmangien e punimeve pa efiçencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit nr. 1. 1*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

2. 1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa që në të ardhmen, gjatë zbatimit të punimeve, të mos miratojë ndryshime në projekt dhe preventiv të paargumentuara teknikisht, për zëra pune të cilat nuk sjellin përmirësimin e projektit të zbatimit të objektit përkatës, me qëllim shmangien e punimeve pa efiçencë dhe pa ekonomicitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit nr. 2. 1*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

3. 1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Belsh, të marrë masa, të njoftojë kontraktorët sipas kontratave të sipërcituara, për të kryer riparimin e plotë të shtresave asfaltike të dëmtuara, duke

konfirmuar në fund të këtij procesi, rikryerjen e punimeve sipas standardeve dhe marrjen në dorëzim të tyre nga Bashkia Belsh, në të kundërt të mos certifikohet marrja në dorëzim përfundimtar.

Brenda datës 30.12.2025

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit nr. 3. 1*
Statusi i rekomandimit: Pa *Zbatuar*

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. 1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Belsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2024, në vlerën totale 100,319,368 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 472 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit nr. 1. 1*
Statusi i rekomandimit: *Në proces zbatimi*

F. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:
Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenin 15 germat (b,c,ç); nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar; nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 *"Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Belsh**, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore, si më poshtë:
a. "Vërejtje", në zbatim të germës "a" të nenit 58, për:

1. **Z. A. N,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare,
për shkeljet e konstatuara:- Hartimi i pasqyrave financiare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar
- Hartimin dhe zbatimin e buxhetit në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, i ndryshuar, pikat 20,67,71,72,76,83,85, 86,87 dhe me Udhëzimin e MF nr. 6, datë 28.02.2023 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026"* pikat 7 dhe 11. me Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"* shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"*, pikat 82-91, me Udhëzimin e MF nr. 35, datë 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore"* pika 33. *(Trajtuar në pikën 2, dhe pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2. Znj. A. L, me detyrë Përgjegjës Sektori Juridik, në cilësinë e Përgjegjësit për prokurimet,

për shkeljet e konstatuara:
- Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e Përgjegjësit për prokurimet dhe anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE. Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit përfundimtar të auditimit).*

3. Znj. SH. N, me detyrë specialist juriste, në cilësinë e anëtarit të të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 1 procedurë prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, në 2 procedura, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4. Z. S. K, me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe hartimit të specifikimeve teknike;
për shkeljet e konstatuara:
- Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe mos kryerjen e kontrollit aritmetik të vlerave për zërat e punimeve të preventivit të fondit limit, që për rrjedhojë, ka sjellë rritje të pa argumentuar të fondit limit. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të raportin përfundimtar të auditimit*).

5. Znj. D. M, me detyrë specialist juriste, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe fondit limit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Z. A. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës, në cilësinë e anëtarit të të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe anëtarit të KVO-së,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 2 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe

konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7. Z. N. R, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, si dhe anëtarit të KVO-së,

për shkeljet e konstatuara:

- Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8. Z. V. I, me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe anëtarit të KVO-së.

9. Z. E. SH, me detyrë këshilltar i Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

10. Znj. O. R, me detyrë specialist juriste, në cilësinë e anëtarit të KVO-së dhe në cilësinë e anëtarit të Nj P,

për shkeljet e konstatuara:

- Në 2 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11. Z. N. Q, me detyrë Drejtorit të Emergjencave Civile, pjesë e së cilës është IMTV, periudha 01.01.2023 deri 14.02.2024;

12. Z. F. M, në cilësinë e K/Inspektorit të IMTV Bashkia Belsh, për periudhën 09.10.2023 deri 31.12.2024;

për shkeljet e konstatuara:

- Nuk kanë hartuar dhe miratuar dokumentacionin përkatës, lidhur me funksionimin e IMTV Bashkia Belsh, pasi, mungojnë planet e punës vjetore apo mujore, të miratuara nga eprori direkt dhe nga Titullari i Institucionit, gjithashtu nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni mbi bazën e të cilit ushtron aktivitetin IMTV(proces verbal konstatimi kundërvajtje, vendim prishje objekti, vendim dënimi me gjobë, vendime pezullimi, etj).
- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me *arsimin e nevojshëm profesional* rezulton se, në IMTV Bashkia Belsh, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi u konstatua se *IMTV Bashkia Belsh, është në kushtet e mosfunksionimit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

F. 2. Për punonjësit e larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre:
1. Z. R. D, në cilësinë e ish Drejtorit të Planifikimit të Territorit.
2. Z. J. T, në cilësinë e ish Përgjegjës Sektori Juridik.
3. Znj. M. E, me detyrë ish specialiste juriste.
4. Z. P. T, me detyrë ish specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vene ne dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerre urdhrin nr. 473 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Belsh pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion u konstatua se kryetari ka nxjerrë urdhrin nr. 473 datë 10.11.2025 për zbatimin e rekomandimit*
Statusi i rekomandimit: ***Në proces zbatimi***

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
- Bashkia Belsh ka kthyer përgjigje në KLSH, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.
Strukturat drejtuese kanë vepruar dhe kanë marrë masat, por jo t**ë** mjaftueshme për zbatimin e rekomandimeve. Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi pjesërisht në masën 86 %.

Për sa më sipër, në lidhje me Auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, pas njohjes me Projekt Raportin e Auditimit, nga ana e subjektit të audituar Bashkia Belsh nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Belsh nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha drejtoritë; - Nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni dhe për

rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës; - Për vitin 2025 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Belsh, si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me ndikim të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre si dhe nuk ka hartuar plan-veprime për menaxhimin e riskut; - Mungojnë trajnimet e stafit të Bashkisë Belsh si dhe programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës. Titullari i Bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë; - Nuk është plotësuar struktura organizative e bashkisë Belsh për 6 vende pune; - Nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë; - Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës, duke sjellë si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive; - Nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës. Këto veprime janë në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, pika 1; "*Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i miratuar me Urdhër 347 të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "*Komponentët e MFK*" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 15-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1. 1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për; - Plotësimin me staf të strukturës organizative të Bashkisë Belsh, në përputhje me nevojat dhe funksionet e institucionit; - Rishikimin dhe përditësimin e rregullores së brendshme, manualeve të proceseve të punës dhe përshkrimeve të pozicioneve, në përputhje me ndryshimet strukturore, riorganizimin dhe ristrukturimin e institucionit; - Hartimin e një plani vjetor trajnimi për stafin, bazuar në nevojat e identifikuara për zhvillimin e kapaciteteve profesionale; - Hartimin dhe miratimin e strategjisë dhe regjistrit të riskut, duke përfshirë të gjitha strukturat e Bashkisë, si dhe vendosjen e një sistemi për monitorimin dhe raportimin periodik të risqeve me ndikim të lartë. Gjithashtu, të hartohet dhe miratohet plani i veprimit për menaxhimin e riskut; - Hartimin dhe miratimin e hartave dhe manualeve të proceseve të punës, me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive dhe shmangien e mbivendosjeve ndërmjet strukturave; - Hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës së Bashkisë Belsh, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollit të tyre.

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nga auditimi i strukturës organizative dhe dokumentacionit përkatës të Bashkisë Belsh, rezultoi se nuk është krijuar dhe nuk ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, si dhe nuk është ushtruar veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në institucion. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nuk u evidentua asnjë procedurë e ndërmarrë nga Bashkia Belsh për krijimin dhe funksionalizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe për rekrutimin e punonjësve përkatës. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", dhe Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", si dhe kuadrin nënligjor në fuqi për organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Si pasojë, mungesa e funksionimit të Auditimit të Brendshëm ka kufizuar një nga komponentët e rëndësishëm të sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë, duke mos siguruar vlerësimin e pavarur dhe objektiv të sistemeve të kontrollit, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1. faqe 15-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. 1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh dhe menaxhimi i lartë të ndërmarrin masat e nevojshme për ngritjen dhe funksionalizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, duke filluar procedurat përkatëse për rekrutimin e stafit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

2. 2. Rekomandimi Në funksion të sigurimit të mbulimit të nevojave për auditim të brendshëm deri në krijimin dhe funksionalizimin e plotë të kësaj njësie, menaxhimi i lartë i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, të vlerësojë mundësinë e lidhjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi me njësinë e auditimit të brendshëm të një prej bashkive të afërta, duke marrë në konsideratë edhe praktikat e ndjekura nga bashki të tjera.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk është përgatitur dhe miratuar kalendari i PBA 2025-2027, duke mos respektuar afatin e përcaktuar për përgatitjen e tij. Hartimi i fazës së parë të PBA 2025-2027 është kryer dhe dërguar në Këshill për miratim jashtë afatit 15 mars 2024. Projekti i parë i PBA 2025-2027 nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025 - 2026 dhe buxhetit vjetor, rezulton se mungojnë, kërkesat shkresore nga drejtorët e drejtorive të Bashkisë Belsh në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse dhe kërkesat e sektorëve të ndryshëm që mbulojnë këto programe, dokumentacioni që evidenton punën e kryer nga Grupi Menaxhimit Strategjik dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, si dhe dëgjesa publike nuk janë dokumentuar me procesverbalet apo relacionet e zhvillimit të takimeve për këtë qëllim. U konstatua se buxheti i vitit 2025 është miratuar datë 27.12.2024 jashtë afateve të përcaktuara. Planifikimit i investimeve gjatë hartimit të fazave të parë të dytë dhe të tretë të PBA 2025-2027 nuk është kryer saktë pasi planifikimi në PBA faza e parë është për shumën 94,591 mijë lekë janë parashikuar 5 projekte investimesh. Në fazën përfundimtare të PBA planifikimi i investimeve ka përfshirë 7 objekte investimesh me vlerë 78,072 mijë lekë nga te cilat tre objekte investimesh me vlerë 36,000 mijë që kanë qene planifikuar ne PBA e fazës së parë dhe fazës së dytë nuk janë në planin përfundimtar vjetor të buxhetit të ndryshuar si dhe nuk janë realizuar gjatë vitit 2025. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk u paraqitën dokumentacion për dëgjesa publike në lidhje me vendimmarrjen për ndryshimin e prioriteteve në planifikimin e investimeve dhe ndryshimin e investimeve gjatë procesit të hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor. Veprime në mos përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pika 18. Në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* ndryshuar Kreu *3.* pika 54, 55, 56, 57, 77, 88,130. Në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"* pika 6, pika11, pika 46, pikat 67, 71, 72, 83, 85.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2 faqe 30-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. 1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa për miratimin dhe dërgimin në kohë në Këshillin Bashkiak të Kalendarit të PBA-së, vlerësimit dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave, Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor, si dhe për publikimin në faqen zyrtare të Bashkisë të PBA-së 2028–2030 dhe Buxhetit Vjetor

Gjatë hartimit të PBA 2028-2030

3. 2. Rekomandimi : Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ekipit të Menaxhimit të Programeve të marrin masa për të paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Koordinatori i Grupi Menaxhimit Strategjik, si dhe të merren masa për planifikimin e saktë të buxhetit sipas dëgjesave publike të mbajtura për ketë qëllim.

Gjatë hartimit të PBA 2028-2030

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025 rezultoi se, fondet buxhetore janë realizuar 654,529 mijë lekë nga 748,545 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 87,4%. Nga auditimi i procedurës së raportimit

të buxhetit u konstatua se është përgatitur vetëm raporti vjetor i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2025 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 814 prot. datë 18.03.2026, por nuk janë hartuar raporte monitorimi periodike 4-mujore dhe nuk janë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak gjatë vitit ushtrimor 2025. Nga auditimi i të dhënave të raportit të monitorimit u konstatua se të dhënat në lidhje me planifikimin dhe realizimin e objekteve të investimeve janë plotësuar në mënyrë të pasaktë pasi realizimi i investimeve i raportuar në raportin e monitorimit është 97,286 mijë lekë plan buxheti 2025 dhe realizim 97,286 mijë lekë së bashku me FZHR ndërsa shuma e tyre në mbledhjen e tabelës së raportuar rezulton 143,576 mijë planifikim dhe 143,576 mijë lekë realizim. Sipas Aneksit 5 *"Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe financim të huaj"* të raportit të monitorimit investimet janë në vlerën 143,576 mijë lekë planifikim dhe 143,576 mijë lekë realizim. Pasqyrimi në raportin e monitorimit është kryer në mënyrë të pasaktë pasi nga auditimi i situacionit buxhetor të vitit 2025 si dhe të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Belsh për vitin 2025 janë planifikuar 117,008 mijë lekë investime dhe realizuar 69,169 mijë lekë investime. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 3 pika 44 neni 65, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 44, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 06.02.2012, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore"*. Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, pikat 22, 27, 28, 29.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2 faqe 30-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. 1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa të sigurojë përgatitjen dhe paraqitjen në afatet ligjore të raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të buxhetit, si dhe të vendosin kontrolle të dokumentuara për rakordimin e të dhënave të raportuara me evidencat financiare dhe buxhetore të Bashkisë. Në veçanti, të sigurohet që të dhënat për planifikimin, ndryshimet dhe realizimin e investimeve, përfshirë projektet e financuara nga FZHR, të jenë të sakta, të plota dhe të rakorduara me dokumentacionin financiar përpara raportimit.

Në mbyllje të buxhetit të vitit 2026 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të planifikimit buxhetor për taksat dhe tarifat vendore u konstatua që niveli i realizimit të planit të të ardhurave të veta është në masën 80% të planifikimit nga 101,000,000 lekë që është planifikimi, realizimi është në masën 80,853,593 lekë, duke ndikuar negativisht në procesin e realizimit të treguesve buxhetor të shpenzimeve të planifikuara të buxhetit 2025. Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se Bashkia Belsh planifikon angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Nga auditimi u konstatua se planifikimi i të ardhurave nuk është kryer në mënyrë të detajuar për taksat dhe tarifat vendore sipas llojit të tyre Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1. 3, germa *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2 faqe 30-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. 1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Bashkisë Belsh në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave të marrë masa të hartojë paketën fiskale të pagesave të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me llojet e taksave dhe tarifave vendore për të cilat realizon të ardhura që paguhen nëpërmjet kodeve përkatëse të të ardhurave që paguhen në degën e thesarit, si dhe të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 520 *"Disponibilitete në Thesar",* u konstatua se gjendja sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare pasqyrohet në shumën 116,172,398 lekë. Sipas dokumentacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rakordimi me degën e thesarit lidhur me llogarinë nr. 520 *"Disponibilitete në Thesar"* dhe llogarinë nr. 466 *"Mjete në ruajtje"* pasqyrohet në shumën 97,574,763 lekë, me një diferencë në shumën 18,597,635 lekë mes tepricës së llogarisë 520 "*Disponibilitete në Thesar*" në pasqyrat financiare (116,172,398 lekë) dhe tepricës së mjeteve monetare sipas degës së thesarit (97,574,763 lekë). Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 50 pika 37
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për rakordimin me Degën e Thesarit lidhur me likuiditetin dhe për identifikimin e sistemimin e veprimeve kontabël që kanë sjellë mosrakordimin, duke siguruar që këto veprime të kryhen në fillim të periudhës kontabël.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", u konstatua se nuk janë kontabilizuar në këtë llogari detyrime afatshkurtra ndaj furnitorëve, në shumën 27,043,842 lekë, të lidhura me transaksionet e vitit kontabël 2025 për të cilat kërkohet financim për likuidimin e tyre, në mënyrë që të mos shtohen detyrimet e prapambetura për mungese planifikimi fondesh. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 59.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për evidentimin, rakordimin dhe kontabilizimin e detyrimeve afatshkurtra ndaj furnitorëve, në shumën 27,043,842 lekë, të lidhura me transaksionet e vitit 2025, duke siguruar që detyrimet të pasqyrohen saktë dhe në periudhën kontabël përkatëse.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" rezultoi se në këtë llogari janë pasqyruar detyrime për investime të viteve të ndryshme, konkretisht: investime kapitale të vitit 2012 në shumën 5,625,187 lekë, të vitit 2019 në shumën 1,088,930 lekë, të vitit 2020 në shumën 8,546,160 lekë, të vitit 2023 në shumën 100,000 lekë dhe të vitit 2025 në shumën 24,769,736 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se këto vlera janë keq klasifikuar në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", megjithëse investimet kanë plotësuar kushtet për t'u kapitalizuar në llogaritë e klasës 2 "Aktive afatgjata". Ky keq klasifikim ka sjellë mos kapitalizimin e aktiveve dhe përjashtimin e tyre nga procesi i amortizimit gjatë periudhave kontabël përkatëse, duke ndikuar në paraqitjen e saktë dhe të drejtë të vlerës së aktiveve afatgjata në pasqyrat financiare. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e saktë të transaksioneve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave dhe teknikave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar dhe pasqyrës së rezultatit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se totali i fondit të konsoliduar pasqyruar në pozicionin financiar në shumën 3,459,479,969 lekë nuk është përcaktuar saktë, duke u pasqyruar më pak në shumën 2,710,435 lekë. Diferencë e konstatuar çelja e fondit të konsoliduar në datën 31.12.2024 në shumën 3,531,086,390 lekë shtuar me totalin e shtesave të aktiveve gjatë vitit ushtrimor në shumën 147,693,114 lekë, pakësuar me kreditimet e klasës 2 në shumën 216,589,100 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për evidentimin e diferencës së konstatuar dhe kontabilizimin e saj në shtesë të fondit të konsoliduar. Në vijim të bëhet kontabilizimi i saktë i transaksioneve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave dhe teknikave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar dhe pasqyrës së rezultatit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se të ardhurat vjetore nuk janë kontabilizuar saktë, duke rezultuar të mbivlerësuara në shumën 14,554,991 lekë. Të ardhurat e realizuara dhe të rakorduara me degën e thesarit sipas pasqyrës së transfertave buxhetore së bashku me të ardhurat e veta, duke përjashtuar financimet për shpenzime kapitale janë në shumën 634,619,541 lekë, ndërsa sipas pasqyrës së performancës duke përjashtuar financimin e pritshëm nga buxheti janë në shumën 649,174,531 lekë. Veprime në kundërshtim Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e saktë të transaksioneve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave dhe teknikave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të të ardhurave në pasqyrën e performancës për përcaktimin e saktë të rezultatit të periudhës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se shpenzimet për mallra dhe shërbime nuk janë paraqitur saktë, duke rezultuar në një nënvlerësim të tyre në shumën 17,576,589 lekë, e cila ndikon në rezultatin e periudhës kontabël. Kjo diferencë është përllogaritur duke marrë në konsideratë totalin e urdhër-shpenzimeve për kategorinë "Mallra dhe shërbime" në shumën 82,084,001 lekë, pakësuar me tepricën në çelje të periudhës kontabël të detyrimeve afatshkurtra në shumën 24,715,118 lekë dhe shtuar me tepricën në mbyllje të periudhës kontabël të detyrimeve afatshkurtra në shumën 43,447,399 lekë. Në pasqyrën e performancës shpenzimet për mallra dhe shërbime janë pasqyruar në shumën 64,507,412 lekë, ndërsa shpenzimet e konstatuara sipas të dhënave faktike rezultojnë 83,239,693 lekë, duke evidentuar një diferencë prej 17,576,589 lekë. Për rrjedhojë, shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe, si pasojë, rezultati i periudhës kontabël, janë paraqitur jo saktë në pasqyrën e performancës. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Aneksi 1,
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për konstatimin dhe kontabilizimin e saktë

të të gjitha transaksioneve të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet, duke i rakorduar ato përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se në *"Shpenzime të tjera"* në operacionet e korrigjimit të rezultatit në teprica e llogarisë 831 *"Caktim të ardhura të funksionit për investime"* është kontabilizuar shuma 1,660,192 lekë. Nga verifikimi dhe rakordimi me Degën e Thesarit rezultoi se, për efekt të korrigjimit të rezultatit, në këtë llogari duhej të kontabilizohej pjesa e investimeve të financuara nga të ardhurat e veta në shumën 8,253,774 lekë. Për rrjedhojë, diferenca prej 6,593,582 lekë nuk është kontabilizuar në llogarinë 831, duke ndikuar në pasqyrimin e rezultatit të periudhës kontabël, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Aneksi 1,
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve të cilat kanë ndikim apo rregullojnë rezultatin e periudhës përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës së Flukseve Monetare dhe rakordimi i të dhënave të saj me Pasqyrën e Transfertave të Fondeve, u konstatuan diferenca, konkretisht:
Në pjesën e parë të Pasqyrës së Flukseve Monetare, *"Veprimtaritë e shfrytëzimit"***,** fondet buxhetore të përdorura për shpenzime korrente janë paraqitur në shumën 584,429,250 lekë**,** ndërkohë që, sipas Pasqyrës së Transfertave të Fondeve, totali i fondeve për shpenzime të veprimtarisë së shfrytëzimit rezultoi 553,805,198 lekë**.** Nga krahasimi i këtyre të dhënave rezultoi një diferencë prej 30,624,052 lekë. Gjithashtu, në Pasqyrën e Flukseve Monetare, arkëtimet dhe të hyrat gjatë vitit ushtrimor janë paraqitur në shumën 71,785,283 lekë, ndërkohë që, sipas Pasqyrës së Transfertave të Fondeve, ato rezultojnë në shumën 80,814,343 lekë, duke evidentuar një diferencë prej 9,029,060 lekë. Nga auditimi i Veprimtarive të investimeve u konstatua se *"Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)"* pasqyrohen në shumën 40,877,411 lekë ndërsa sipas pasqyrës së transfertave të fondeve totali i fondeve të akorduara për shpenzime kapitale është 60,913,897 lekë, u konstatua mos rakordim në shumën 20,036,486 lekë. Diferencat e mësipërme nuk janë rakorduar dhe nuk rezultoi të jetë dokumentuar shpjegimi përkatës për ndryshimet ndërmjet të dhënave të paraqitura në dy pasqyrat. Kjo situatë cënon saktësinë, rakordimin dhe besueshmërinë e informacionit financiar të paraqitur në Pasqyrën e Flukseve Monetare. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1. Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos rakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të fluksit monetar të subjektit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve që lidhen më mjetet monetare në mënyrë të saktë, duke i rakorduar ato me pasqyrat e tjera pjesë të pasqyrave financiare vjetore, si dhe me raportet nga dega e thesarit përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së fluksit monetar, pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës "*Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata*" u konstatua mbivlerësim i vlerës neto të aktiveve në shumën 16,324,104 lekë, si rezultat i mos aplikimit të saktë të normave të amortizimit gjatë periudhës kontabël konkretisht; në llogarinë 202 *"Studime dhe kërkime"* norma amortizimit është aplikuar në masën 10%; në llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* norma amortizimit është aplikuar në masën 3%; në llogarinë 215 *"Mjete transporti"* norma amortizimit është aplikuar në masën 10%; në llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"* norma amortizimit është aplikuar në masën 4%; veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, pika 36.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14. 1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për përllogaritjet e sakta dhe kontabilizimin e saktë të shpenzimeve të amortizimit për aktivet afatgjata, sipas kërkesave dhe teknikave kontabël, me qëllim pasqyrimin e saktë të pozicionit financiar.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve u konstatua se në përbërjen e Komisionit të Inventarizimit është përfshirë, në cilësinë e anëtarit, një punonjës i Drejtorisë së Financës. Gjithashtu, Komisioni i Inventarizimit nuk ka hartuar relacionin dhe procesverbalin për përfundimin e procesit të inventarizimit. Këto veprime/mosveprime janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30 të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, pika 82, si dhe me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, datë 15.10.2015, neni 22, pika 3, shkronja "b".
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15. 1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për forcimin e kontrolleve të brendshme në procesin e inventarizimit të aktiveve, duke siguruar ndarjen e përgjegjësive dhe shmangien e përfshirjes së të njëjtit punonjës në procese të papajtueshme, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Gjithashtu, të merren masa për përfundimin dhe dokumentimin e plotë të procesit të inventarizimit, nëpërmjet hartimit të relacionit dhe procesverbalit përkatës, si dhe të ndiqen procedurat për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nga KLSH-ja dërguar me shkresën e KLSH-së, 404/13 prot., datë 21.10.2025 rezultoi se, nga Bashkia Belsh është respektuar afati 20 ditor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se rekomandimet janë pranuar në masën 100% dhe janë në proces zbatimi në masën 19%, e konkretisht:
- Nga 29 masa organizative, pranuar nga subjekti; 4 masa janë të pazbatuara, 25 masa janë në proces zbatimi.
- 5 masa shpërblim dëmi pranuar nga subjekti; 5 masa janë në proces zbatimi
- 3 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike, pranuar nga subjekti; 3 masa pa zbatuar
- 1 masa për uljen e borxhit tatimor, për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), pranuar nga subjekti; 1 masë në proces zbatimi
- 12 masa disiplinore për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil, pranuar nga subjekti; 12 masa në proces zbatimi
- 4 masa disiplinore për punonjësit e larguar, pranuar nga subjekti; 4 masa në proces zbatimi

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 71-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16. 1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative

1. 1. Rekomandimi: *Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Belsh të marrin masa, për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit, përditësimin e Rregullores së Bashkisë, ku të përfshihen të gjitha strukturat dhe organet e institucionit, si dhe hartimin dhe miratimin e Kodit të Etikës për këtë institucion. Të hartohet dhe miratohet Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, regjistri i riskut, planet e punës për çdo sektor dhe drejtori, si dhe strategjia e menaxhimit të riskut. Të dokumentohen me anë të procesverbaleve mbledhjet periodike dhe aktiviteti i* Grupi Menaxhimit Strategjik. *Gjithashtu Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë dhe miratojë planin vjetor të trajnimit si dhe të realizojë trajnimin e punonjësve për fusha të ndryshme me risk brenda veprimtarisë së institucionit.*

2. 1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me një nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi, për të bërë të mundur auditimin e strukturave të vlerësuara me risk të lartë.*

3. 1. Rekomandimi*: Strukturat drejtuese të Bashkisë Belsh, nëpërmjet Drejtorisë së Financës të marrin masa që hartimi i PBA dhe buxhetit vjetor të bëhet në bashkëpunim me* Ekipi i Menaxhimit të Programeve*, të cilët duhet hartojnë dhe të paraqesin kërkesat buxhetore me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të* Grupi Menaxhimit Strategjik*, si dhe kryerjen e konsultimit publik nëpërmjet organizimit të dëgjesave publike me palët e interesit. Pas përgatitjes së PBA në çdo fazë në afatin e miratuar të merren masa që të paraqiten në këshillin bashkiak për miratimin e tij dhe në përfundim të bëhet publikimi i dokumentit të plotë PBA dhe buxhetit vjetor.*

4. 1. Rekomandimi: *Titullari nëpërmjet Drejtorisë së Financës të marrë masa, që të përgatisë raportet e monitorimit të buxhetit të vitit ushtrimor çdo 4-mujor, sipas formateve të miratuara dhe ti paraqesë ato në Ministrinë e Financave dhe në këshillin bashkiak.*

4. 2. Rekomandimi*: Drejtoria e Financës të marrë masa, që detyrimet e prapambetura ti evidentojë saktë dhe të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme likuidimin e tyre dhe përllogaritjen së saktë të peshës specifike, të stokut të detyrimeve mbi shpenzimet faktike, për të menaxhuar në çdo moment situatën financiare të*

5. 1. Rekomandimi: *Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Belsh të marrë masa që në planin vjetor të të ardhurave të Bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga të gjitha taksat/tarifat e parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu të merren masa për të realizuar plotësisht arkëtimin e të ardhurave referuar në planifikimit të tyre*

6. 1. Rekomandimi*: Sektori i Financës të marrë masa që në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave Vendore të marrë masa që të kontabilizojë vlerat debitore nga taksat dhe tarifat vendore, të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogaritë e tjera të lidhura me to.*

7. 1. Rekomandimi*: Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2025 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar në përputhje me parimet kontabël të pranuara.*

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

8. 1. Rekomandim: *Drejtoria e Financës të kryejë inventarin fizik projekteve të studim-projektimeve të blera gjendje e llog. 202 "Studime dhe Kërkime", nëse është e mundur të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre, si vlerë e shtuar sipas llojit të aktivit të kapitalizuar, të përllogarisë amortizimin për to sipas normës dhe metodës së miratuar, duke i kryer veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse dhe të reflektohen edhe në tabelën shoqëruese përkatëse*

***9. 1. Rekomandim**: Drejtoria e Financës për vlerat e pa analizuara apo pa emërtime të sakta të rishikojë dokumentacionin financiar të trashëguar dhe të identifikojë aktivet që përfshijnë këto vlera. Gjithashtu të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.*

***10. 1. Rekomandim**: Strukturat drejtuese në Bashkinë Belsh dhe Drejtoria e Financës të marrin masa që të kryejnë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësve të rrjetit shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji në "Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime, Elbasan" dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llog. 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore".*

***11. 1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës të marrë masa që në llogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata të aplikojë normat e amortizimit të miratuara sipas grup aktiveve përkatëse dhe me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025 të bëjë sistemimet e nevojshme për saktësimin e vlerave të aktiveve të llogarive 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe 218 "Inventar ekonomik".*

***12. 1. Rekomandim**: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël, për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të detyrimeve ndaj të tretëve, në llogaritë përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar, në përputhje me parimet kontabël të pranuara.*

***13. 1. Rekomandim**: Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për të pasqyruar saktë shpenzimet e kryera sipas natyrës mbi bazën e rregullave kontabël të hartimit të pasqyrave financiare.*

***14. 1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor të plotësojë në mënyrë të saktë pasqyrën e flukseve monetare (cash flow), duke kryer veprime të sakta në kontabilitet, referuar akt rakordimeve me thesarin dhe klasifikimit ekonomik kontabël.*

***15. 1. Rekomandim**: Strukturat drejtuese në Bashkinë Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat të menjëhershme për derdhjen në bankë të shumave të pa tërhequra nga qytetarët për shpërblim lindje gjendje në arkë deri në lidhjen e një marrëveshjeje me bankat e nivelit të dytë apo me degën e postës shqiptare në Belsh për kryerjen e pagesave qytetarëve.*

***16. 1. Rekomandim**: Drejtoria e Financës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar", e cila është mbivlerësuar për vlerën 4,449,380 lekë në fund të vitit 2024.*

***17. 1. Rekomandim**: Drejtoria e Financës të marrë masa që të kryejë veprime sakta në kontabilitet, në lidhje me investimet në mënyrë që pasqyrat financiare në të gjitha formatet e vlerat e tepricave në të njëjtat llogari apo kundërparti dhe veprimet debi-kredi me to të lidhen me një logjikë kontabël për të shmangur anomalitë apo parregullsitë në klasifikimin ekonomik kontabël dhe keq interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.*

***18. 1. Rekomandim**: Titullari i AK Bashkia Belsh, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DT. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik, duke rritur njëkohësisht sigurinë për realizimin e objektit me standarte optimale dhe brenda afateve të përcaktuara.*

***19. 1. Rekomandim**: Titullari i AK Bashkia Belsh, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë e mangësive të konstatuara në vlerësimin e ofertave dhe përgjegjësitë në zhvillimin e këtij procesi. Gjithashtu KVO të marrë masa, që të shmangen parregullsi të tilla, për të përmbushur realizimin e këtij procesi në mënyrë objektive dhe transparente.*

***20. 1. Rekomandim:** Titullari i AK Bashkia Belsh, të analizojë arsyet e anomalive në përllogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësitë e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë.*

21. 1. Rekomandim*: Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Belsh, të marrë masa për të plotësuar dosjet e zbatimit me dokumentacionin përkatës të konstatuar në mungesë. Gjithashtu për këto raste dhe në vijimësi, të verifikojnë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit, që do të paraqesin operatorët kontraktues dhe për çdo mungesë, të pezullohet dorëzimi i dosjes përkatëse, deri në plotësimin e saj, duke nxjerrë përgjegjësitë për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit.*

22. 1. Rekomandim*: Titullari i AK Bashkia Belsh, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Bashkisë, të marrë masa në vijimësi, që për çdo projekt për ndërtimin e objekteve publike, para fillimit të procedurës së prokurimit, të kryhet Oponenca teknike nga institute, apo ente të tjera, të përcaktuara ligjërisht për kryerjen e këtij procesi.*

23. 1. Rekomandim*: Titullari i AK Bashkia Belsh të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë, në vijimësi të përzgjedhë si pjesë e KVO punonjës, pozicioni i të cilëve të pajtohet me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin referuar përgjegjësive për çdo pozicion pune, për të garantuar mbarëvajtjen e procedurës së prokurimit. Personi përgjegjës për prokurimin të administrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku të përcaktohet me saktësi sasia e mallrave që do të prokurohet dhe të argumentohen sasitë e kërkuara nga drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë.*

24. 1. Rekomandim*: Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë, të cilat i kanë kaluar në administrim, lidhur me gjendjen faktike dhe statusin e tyre, për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron. Gjithashtu të procedohet për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK, për të bërë të mundur minimizimin e riskut të keqpërdorimit të pasurive së institucionit.*

25. 1. Rekomandim*: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Belsh, të marrë të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikata përdorimi: - Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve, konkretisht: polica e sigurimit e përgjegjësisë profesionale, certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, aktet përkatëse teknike nga OSHEE dhe për menaxhimin e mbetjeve urbane, projektet për mirëmbajtjen e objekteve, etj; - Të respektohen afatet për shqyrtimin e aplikimeve dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse për miratimin apo refuzimin e kërkesave të paraqitura; - Të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj, nga data e aplikimit.*

26. 1 Rekomandimi*: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Belsh, të marrë të gjitha masat për të kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në çdo rast, që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi. Informacioni i kërkuar nga DV ASHK-të, duhet të konsistojë në vënien në dispozicion nga ky institucion i dokumentacionit që përcakton statusin e pronësisë, apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit.*

27. 1. Rekomandimi*: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Belsh, të marrë të gjitha masat, që përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të sigurojë respektimin e kushteve urbane për zhvillim, duke verifikuar përputhshmërinë e aplikimit me kondicionet urbane dhe të miratojë vetëm ato aplikime që i respektojnë këto kondicione.*

28. 1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për të krijuar një strukturë të IMT-së funksionale, me numër inspektorësh/Kryeinspektor, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të kualifikuar, kryesisht të profilit inxhinieri, për të kryer inspektime me cilësi dhe transparencë, duke siguruar vijueshmëri dhe mbulim të plotë të gjithë territorit të Bashkisë Belsh.*

28. 2. Rekomandimi: *Kryeinspektori dhe inspektorët e IMT-së Bashkia Belsh, të marrin masa të menjëhershme për të administruar dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës. Gjithashtu IMTV të kryejë funksionet e përcaktuara, bazuar në plane mujore e vjetore konkrete, të miratuara nga Titullari i Institucionit, si dhe të hartojë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë.*

B. Masa për shpërblim dëmi

1. 1 Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 8,797,882. 54 lekë pa tvsh nga BOE V&G, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3956/12 prot., datë 30.04.2020, me objekt: "Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjetin shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit faza II", Bashkia Belsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

2. 1 Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 5,707,878 lekë pa tvsh nga BOE "E&T, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 907/7 prot., datë 02. 06. 20, me objekt: "Furnizimi me ujë të pijshëm i Zonës së Dumresë, Bashkia Belsh, (Faza III)", Bashkia Belsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

3. 1. Rekomandimi*: Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 319,750 lekë (pa tvsh) nga BOE "N" Sh. p. k & "I", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1847/5 Prot., datë 29.09.2022, me objekt "Sistemim, Asfaltim i Rrugës Belsh-Stanaj", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.*

4. 1. Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 791,850, lekë (pa tvsh) nga BOE "N" Sh. p. k & "I", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2903/12 Prot., datë 01.02.2023, me objekt "Rikonstruksion i rrugëve Rrasë, Hysgjokaj, Pajalli, Beqiraj, Gradisht(Faza e parë segmenti Rrasë-Pajalli)", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.*

5. 1. Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Belsh, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 879,900 lekë (pa tvsh) nga OE "V" SH. P. K, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 644/7 Prot., datë 05.05.2023, me objekt "Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i rrugëve të brendshme, Bashkia Belsh", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.*

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike

1. 1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa që në të ardhmen, gjatë zbatimit të punimeve, të mos miratojë ndryshime në projekt preventiv të paargumentuara teknikisht, për zëra pune të cilat nuk janë sipas natyrës së objektit që zbatohet, me qëllim shmangien e punimeve pa efiçencë.*

2. 1. Rekomandimi*: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa që në të ardhmen, gjatë zbatimit të punimeve, të mos miratojë ndryshime në projekt dhe preventiv të paargumentuara teknikisht, për zëra pune të cilat nuk sjellin përmirësimin e projektit të zbatimit të objektit përkatës, me qëllim shmangien e punimeve pa efiçencë dhe pa ekonomicitet.*

3. 1. Rekomandimi: *Titullari i AK Bashkia Belsh, të marrë masa, të njoftojë kontraktorët sipas kontratave të sipërcituara, për të kryer riparimin e plotë të shtresave asfaltike të dëmtuara, duke konfirmuar në fund të këtij procesi, rikryerjen e punimeve sipas standardeve dhe marrjen në dorëzim të tyre nga Bashkia Belsh, në të kundërt të mos certifikohet marrja në dorëzim përfundimtar.*

D. Masa për uljen e borxhit tatimor, për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)

1. 1. Rekomandim: *Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Belsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2024, në vlerën totale 100,319,368 lekë.*

F. Masa disiplinore

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 15 germat (b,c,ç); nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Belsh, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore, si më poshtë:

a. ***"Vërejtje",*** *në zbatim të germës "a" të nenit 58, për:*

1. Z. A. N, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, për shkeljet e konstatuara:- Hartimi i pasqyrave financiare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. - Hartimin dhe zbatimin e buxhetit në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1 dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, pikat 20,67,71,72,76,83,85, 86,87 dhe me Udhëzimin e MF nr. 6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026" pikat 7 dhe 11. me Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91, me Udhëzimin e MF nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" pika 33.

2. Znj. A. L, me detyrë Përgjegjës Sektori Juridik, në cilësinë e Përgjegjësit për prokurimet, për shkeljet e konstatuara: - Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e Përgjegjësit për prokurimet dhe anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE. Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

3. Znj. SH. N, me detyrë specialist juriste, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara: - Në 1 procedurë prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, në 2 procedura, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

4. Z. S. K, me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe hartimit të specifikimeve teknike; për shkeljet e konstatuara: - Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe mos kryerjen e kontrollit aritmetik të vlerave për zërat e punimeve të preventivit të fondit

limit, që për rrjedhojë, ka sjellë rritje të pa argumentuar të fondit limit. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

5. Znj. D. M, me detyrë specialist juriste, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe fondit limit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara: - Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

6. Z. A. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara: - Në 2 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

7. Z. N. R, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, si dhe anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara: - Në 3 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

8. Z. V. I, me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Nj P dhe anëtarit të KVO-së.

9. Z. E. SH, me detyrë këshilltar i Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

10. Znj. O. R, me detyrë specialist juriste, në cilësinë e anëtarit të KVO-së dhe në cilësinë e anëtarit të Nj P, për shkeljet e konstatuara: - Në 2 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese. Veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

11. Z. N. Q, me detyrë Drejtorit të Emergjencave Civile, pjesë e së cilës është IMTV, periudha 01.01.2023 deri 14.02.2024;

12. Z. F. M, në cilësinë e K/Inspektorit të IMTV Bashkia Belsh, për periudhën 09.10.2023 deri 31.12.2024; për shkeljet e konstatuara:
- Nuk kanë hartuar dhe miratuar dokumentacionin përkatës, lidhur me funksionimin e IMTV Bashkia Belsh, pasi, mungojnë planet e punës vjetore apo mujore, të miratuara nga eprori direkt dhe nga Titullari i Institucionit, gjithashtu nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni mbi bazën e të cilit ushtron aktivitetin IMTV(proces verbal konstatimi kundërvajtje, vendim prishje objekti, vendim dënimi me gjobë, vendime pezullimi, etj).
- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se, në IMTV Bashkia Belsh, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi u konstatua se IMTV Bashkia Belsh, është në kushtet e mosfunksionimit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i evidencave kontabël dhe analitike të strukturave përgjegjëse të Bashkisë Belsh, u konstatua se në fund të vitit ushtrimor 2025, detyrimet totale të subjekteve dhe individëve ndaj Bashkisë rezultojnë në vlerën 169,945,950 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara, ndërsa në pasqyrat financiare në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" janë pasqyruar debitorë në shumën 49,755,029 lekë. Si rezultat i mungesës së rakordimit të plotë ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe strukturave përgjegjëse për administrimin e të ardhurave, rezultoi një diferencë prej 120,190,921 lekë, e cila nuk është evidentuar dhe kontabilizuar në pasqyrat financiare të Bashkisë për vitin 2025, e cila përfaqëson detyrime të lindura dhe të evidentuara nga strukturat administrative, të cilat duhet të ishin reflektuar si të drejta të arkëtueshme të Bashkisë e cila përbëhet nga detyrime të kategorisë familjarë për taksat dhe tarifat vendore dhe taksën e tokës si dhe detyrime të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve. Mos reflektimi i kësaj vlere në kontabilitet ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme në shumën 120,190,921 lekë, duke mos paraqitur në mënyrë të plotë gjendjen reale të të drejtave financiare të Bashkisë në fund të vitit 2025 dhe duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të performancës financiare dhe potencialit të të ardhurave vendore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë të drejtave shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.
Ndërsa për aktivitetin e vitit 2025, detyrimet debitorë janë shtuar për vlerën 33,310,500 lekë.
Nga strukturat e Bashkisë Fier, nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat për uljen e vlerës së debitorëve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Kreu XI "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22 si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksi nr. 1, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të informacionit financiar në pasqyrat vjetore, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1. 3, germa *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-54 dhe në pikën 2.3, faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe strukturat e tjera përgjegjëse, të marrë masa për; - ngritjen e një procedure të detyrueshme rakordimi periodik dhe vjetor ndërmjet evidencave administrative dhe kontabilitetit për të gjitha kategoritë e detyrimeve;
- evidentimin dhe dokumentimin e plotë të debitorëve dhe detyrimeve të krijuara deri në fund të çdo viti ushtrimor; - marrjen e masave administrative dhe ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara në shumën totale 169,945,950 lekë, me qëllim rritjen e të ardhurave vendore dhe përmirësimin e performancës financiare të Bashkisë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"*, mbyllur me tepricë në shumën 49,755,029 lekë u konstatua se ajo përfaqëson vetëm detyrimet e lëna nga auditimet e KLSH dhe nga APP. Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Tatim Taksave deri në datën 31.12.2025 u konstatuan detyrime në shumën 120,190,921 lekë nga subjektet familjarë dhe bizneset. Ky detyrim rezultoi i pa kontabilizuara në pasqyrat financiare të Bashkisë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1, të drejtat dhe detyrimet.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3 faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2. 1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese kontabël për reflektimin në pasqyrat financiare të vitit kontabël 2026 të shumës 120,190,921 lekë, e cila përfaqëson detyrime të evidentuara nga strukturat përgjegjëse, por të pa mbartura në kontabilitetin e Bashkisë. Kontabilizimi të kryhet mbi bazën e dokumentacionit justifikues dhe rakordimeve përfundimtare ndërmjet strukturave përgjegjëse, duke siguruar që në pasqyrat financiare të paraqitet vlera reale e llogarive të arkëtueshme.

Gjatë vitit 2026

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Belsh, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore në Shërbimin Civil", i ndryshuar, si më poshtë:

a. "Vërejtje" në zbatim të germës "a" të nenit 58, për 4 punonjës;
1. Z. A. N. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, hartuesit të pasqyrave financiare dhe koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut
Për mangësi në identifikimin dhe vlerësimin i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së. Veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.
Për mangësi në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 9,

datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, UMFE nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022, "Procedurat për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm", Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar", Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".
Për mangësitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2025. Veprime në kundërshtim Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar

2. Znj. Sh. K., përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore Bashkia Belsh.
Për mangësi në identifikimin dhe vlerësimin i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së. Veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016

3. Z. M. Ç. në cilësinë e Koordinatorit të Grupit të Menaxhimit Strategjik
Për mangësi në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 (PBA 2025-2027) dhe programimi i buxhetit vjetor 2025, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"

4. Z. D. P. Përgjegjës Sektori i Tatim Taksave
Për mangësi në parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe evidentimin e detyrimeve të pa arkëtuara progresive. Veprime në kundërshtim Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar.

C.2 PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT